



Sotir Andoni

DASMË

E

ÇUDITËSHME

Tregime

85H-32
11. 69.

SOTIR ANDONI

Shansha Shukeli
VL e^V.

DASMË E QUDITËSHME

Tregime

94.



N. SH. BOTIMEV ~~E~~ «NAIM FRASHERI»
TIRANE, 1963

DASME E CUDITESHE

Yerusalem



IN SAN FRANCISCO - CALIFORNIA
PRINTED IN U.S.A.

Zëri i mëmëdheut

Natë.

Kolonja është në gjumë, veç Osumi buçet me të madhe e zjarret nér male skuqin anë e mb' anë. Edhe çeta e komitave fle majë Radomit, por komandar Çerçizi është zgjuar e mban roje, mendja e tij bredh poshtë e lart Shqipërisë, ballin e ka të rughur, por një shpresë e gjallë lëvrin në zemrën e tij. I duket se hallkat e zinxhirave kanë zënë të çapëlehen. Ndër këmbë të tia është shtritur i vëllai, Bajua, duket sikur fle, se sytë i ka të myllur, por mendja e tij rend larg nëpër botë. Ai shtyn një derë të vogël hekuri dhe hyn në një shtëpi të Sofjes, takon shokë e miq, bisedojnë kokë më kokë, që aty shkon në Bukuresht te Nikolla Naçua, takon Spiro Balkamenin, ik që aty e shkon në Stamboll, bredh nëpér dyer të mëdha shqiptarësh, zihet, shahet, takon Ferid Pashën «Ndihmë, o pasha, — i thotë, — ndihmë o vezir pér mëmëdhenë, pér Shqipërinë, edhe ti shqiptar je».

«Ta di cilin damar kam shqiptar, — ja kthen ai, — ta di cilin, e pres që tashti.»

Ik Bajua nga Stambolli e mbrin në Romë, në Vienë, në Kajro, kapërxen detin e madh e shkon në Boston. Hyn në një tabakhanë të madhe. Medoemës, ata që regjin lëkurë me gëlgjere, ata që po dërsijnë në punën më të rendë, janë shqiptarë. Aty Bajua piqet me Nolin, me Pecin bisedon me ta dhe ja, sërisht është në majë të Radomit.

Agimi ka ardhur, dita u çel fare. Kapedan Çerçizit i vjen keq të zgjojë komitat se janë të lodhur.

Kolonja është zgjuar qëkuri. Tufat muarën pllajat, bujxit arat, druvaret pyllin, Osumi buçet llagëmeve. Një sërë arabash zhurmojnë fort nga xhadeja ndënë Shtikë. Nga Kullat e Qarit nxijnë topat e turkut. Kapedani kthen dylbinë nga ana e Dangëllisë, Përmetit, shikon korijet e Frashërit. Medet! Oxhaku i ndritur është rrëzuar. Naimi që duhej sot është bërë dhé, veç hieja e tij rend majave të Shqipërisë, zëri i tij ushton me të madhe, i émbël dhe i butë, trimëror dhe zulmëmadh!

— Xhonturqit, o vëlla, duan të na ngopin me lugë të zbrazur . . .

— Kjo dredhi duket hapur.

— Të lëshojmë kushtrimin e madh, erdhi koha të ngrihen burra e gra, të gjallë e të vdekur.

— Veç me dyfek nuk i dilet, u dashka edhe politika, shtatë hile një trimëri. Të tjerët luftojnë më pak portërrasin më shumë, me ne ngjet e kundërtat.

— Ndaj e kemi pisk?

— Por do ta ngrejmë zérin më shumë paskëtaj, ta marrë vesh gjithë Evropa, bota e tërë. Do t'i shkruaj një letër Ismail Qemalit në Stamboll, do t'ja shkoqit punët një përnjë, por na duhet një trim që të shpjerë kartën.

— Dërgojmë Skënderin.

— Naimbaron punë?

— Djal' i ri Skënderi, trim sa të thuash, turçen e thanfare, i zgjuar si kolonjar.

— Bajua nxjerr divitin nga çanta e zë të shkruajë. Cercizi, është kërrusur, mbi Skëndon që fle si një shqerrë e butë:

— Do të të nis larg, o bir. Zoti goftë me ty, ndofta sot Shqipëria është në udhëkryq, ku ta dish, ndofta është e thënë që historia jonë të çelë fletë të re ndënë çapin tënd. Po të mërgoj, o bir, po të ve në rrugë të rrezikut, po kërkoj nga ty më shumë nga sa duhet, në rrugë të panjohura, nér vendë të papara, po të ndaj nga shokët, më ther në zemër, o trim i ri, o bilbil i çetës, o gazi i ynë po... po... Skënder o bir, (ai e tundi nga supat) Skënder, o djalë, zgjohu, ngrehu!

Djali përshkundi kryet e çeli sytë, fytyra e tij me pamje fëmijore me vetullat ngritur sikur pyet:

— Urdhër kapet!

Ai brofi në këmbë aq shpejt sa dheu u tund ndënë pllazet e tija:

— Urdhër, Kapedan!

— ... letra nuk është shumë e gjatë, më shumë do t'i flaq me gojë, shqipo ke në Stamboll të mirë e të liq, do ta ruash kur të dalë nga Mexhlizi; shkoi pranë dhe zer e këndo: «mbi male, mbi Samarinë» pesë mexhide do të jap për rrugës.

— Mjaftojnë vetëm dy, kapet, Shqipëria është e varfër.

— Udhë është e gjatë, duhet nxituar, duhen harxhe.

— Unë rroj edhe me fletë, kapet s'më ha malli, ditën do bares, natën do fle duke rendur...

— Hajt të paça trimërinë!

* * *

Fluturon një djalë petrit në rrugën e gjerë të Dedeagaçit. La prapa Kosturin, Vedenën, Nogozhdin e ja, është në portat e Selanikut. Por fati i lik nuk e ndihu. Sa hyri në qytet krisën koburet. Një arbëresh speciot brezëshuar ja preu kokën me tagan mytesarifit që desh t'i marrë varkën. Zhurmë e rrëmujë, armët kërcasin, por trimitet nuk i gjënden gjurmat. Bëhet shtetrethim. Prej qyteti nuk lenë të dalë njëri. Skënderi mbet në rrugë të madhe. Këmbët i dhembin, është pa të njojur, pa një grosh në xhep. Në Paterahan ku bien shqiptarët sheh tre burra të zënë krah për krahu. Medoemos shqiptarëve u shtohet dashuria në dhe të huaj. U flet, i përgjigjen. U hap zemrën, e ndihin.

— Bimbash Hodo Beu më duket se është shqiptar nga Rehova e Kolonjës, — i thotë njëri, — veten nuk e bën të tillë, por do të jetë i rrëmbyer (1) që i vogël, por

1) Turqit e kishin zakon të rrëmbejnë fëmij të krishterë.

mua më ngjet... më duket si kolonjar, rri në kafenenë buzë detit nga Beaskuleja shko andej pyet; po desh ai hap rrugë edhe natën.

Eshtë vjeshtë, pazari eshtë mbushur plot mall, peshq të mëdhenj të varur në çengela, vargje me duhan, pиргje me domate, mijë kosha me rrush, në skelë shkar-kojnë grurë nga «Haxhi Dauti» (1) e ngarkojnë varele me vaj. Me të lexuar emrin e vaporit, Skënderi vu buzën në gaz. Iu kujtua një kallzim i Bajos: E dërguan «Haxhi Dautin» në Maltë. U nis e si trapiti katër muaj nëpër Mesdhe, pa mbaruar punë, kapedani u kthyte me gjithë vapor në Stamboll e raportoi: «Hiç bir jerde Malta joktur! (Maltë s'gjendet kurkund.)

Ky vapor do të shkojë në Stamboll, por ka roje të shumta nëpër hyrjet. Edhe pazari eshtë plot zaptije e halldupë. Rrugëve arapë të zinj, në breg një kurbat mban për hallke një ari e thérret në disa gjuhë, edhe në shqip: «Kush heq nga përdhesi, shëron ariu pesë grosh saa.

Kafeneja e detit eshtë e madhe dhe e unjtë. Facën e ka plot xame të vegjël në formë hoji. Skënderi hyn pa droje, atje mban erë qepë, piper e bornut. Sa vë këmbën brënda, në një çast derdhet vështrimi i tij si akrep nér të katër qoshet. Salla e kafenesë eshtë plot. Taktuket e tavllës kërcasin me inat. Kundrejt, sazexhinjtë kurdisin veglat. I pari i tyre jep e merr me shokët e tij. Janë larg e su vjen zëri, por djaloshit ja thotë zemra se vetëm shqipot kanë ato lëvizje në të folur. Aty përzjehen gjithë gjuhët e Ballkanit dhe Mesdheut. Një ermen bullafiq, me mustaqet ngritura si dy hënëza turku, llërë përveshur, me podhë të bardhë, pjek kërnace e qebape aty mënjanë, niér muret kuadro me pictura: Një bakall «i veresies» rreh kokën me grushte, një «i peshinit» këmbë mbi këmbë, qesh. Më tej Gjenovefa përqafohet me të shoqin.

Kryesazehiu e pret mirë Skënderë.

— Tungjatjeta, vëlla!

— Tungjat e me nder, nga vjen zotrote?

1) Vapor turk i asaj kohe.

— Jam kolonjar, vij nga Shqipëria, zotrote nga të kemi?

— Më quajnë Harito, përmetar me gjithë shokë.

Skënderi u jep dorën të gjithëve. Fytyra e Haritos është bardhë e kuq si një çyrek i pjekur mirë. Sytë i ka mavi të ëmbël e ballin të madh me një të skuqur në mes. Fshin me shami violinë dhe i jep harkut një çamçakëz:

— Bimbashi? Ka ndonjë muaj që vjen përditë këtu, ja sikur ka ardhur po shqipëtar s'e di të jetë, e kam mik të mirë është edhe dorëlëshuar po shqiptar s'e di...

Tashti sazet ja kanë marrë një këngë bullgarë. Dy shule me këmishë të bardha nxjerrë mbi shallvaret rrinë atje pranë me një mexhite në dorë. Duan të hedhin valle por sikur s'ua mban. Një grumbull njerëz po hyjnë nga dera:

«Oj... Ky do të jetë. Ç'deli burri qënka qerratai. Rrobot kaqi, mbathur çizme, fytyrë e rreshkur, por i mbajtur mirë. Në brez koburen, gishtat plot unaza, qostek ari mbi gjoks, edhe nishane.» I dha vaktin Haritos, porositi një nargjile e me lëvizje të shkathët u ul kundrejt sazeve. Përmetari ndeshi vështrimin e Skënderit dhe i lojti syrin niëpër harkun e violisë. Komiti i ri ishte sa i grisur, veç kurmi i tij i derdhur shquante që atje tej. Fytyra e tij e ëmbël dhe trimërore, sytë e ndezur, faqet prush, dhëmbët stërhall, djalë mali. Nuk bëri temenanë anadollake po vu dorën në zemër si shqiptar dhe iu qas bimbashit.

— Selam Aleqym!

— Aleqym selam! — mezi u gjegj zabiti. Djaloshi ja nisi me turçen:

— Një punë jo e rëndomtë më bën t'u drejtohem efendi, kam nevojë të ngutur të nisem pér në Stamboll.

— Nuk e di shtetrrethimin ti?

— Si urdhëron, bimbash, por duhet medoemos.

— Unë jam bimbash që të mbroj ligjet e jo t'i shkel. Largoju! Ai thithi margjilenë e balli i tij i rudhur nuk qas fjalë tjetër.

— Duhet medoemos, bimbash unë jam shqiptar!

— E se je arnaut, çfarë pastaj?

— Për mëmëdhenë, o Hodo Rehova!

— Hëëë?! Si e the atë fjalë? — Një grahamë e ash-për i dolli nga fytì, surrati i tij pasqyronte trazinë. Djali sikur e shpoi mu në hie.

— Zëri i atdheut, bimbash, atdheu yt dhe i imi, e di gjëmën e Shqipërisë? E kemi nënë e na ka bij, do ta ngrejmë mëmëdhenë ashtu si qe ndën Skëndërbenë.

— Ç'je ti, more?

— Turçen nuk ta ka mësuar nëna, bimbash, edhe unë të vjedhur e kam, unë jam komit nga Shqipëria e më ke vëlla, vete në Stamboll për Shqipërinë.

— Aha... tashti të njofta. Mos loj vendit, pis ar-naut, je hapsanik, qysh tashti, nuk dua të prish qetësinë e kafenesë, po mos loj sa të vijnë zaptijet, ulu të them, mos lëviz!

Djali e pa drejt në sy, pa që bimbashi vu dorën mbi koburen, por u bind. Violia e Haritos sikur vajton, no-fullat e tij i ka kapur ethja. Djalit po i dridhej zemra. Ndënë anterinë ka revolën, po këtë kërkon ta lozë në fund. Në fund fare. I bëhet sikur dora e butë e Çercizit i përkëdhel supin dhe i flet ngadalë në vesh: «Mengdale, biro kur e sheh vdekjen me sy tregohu që nuk ja ke frikën.»

— Edhe turk të jesh s'duhet të më presësh kështu në besë, unë ardha t'u hapa vetë.

— Mos folë, hesht!

— I pabesë, vërtet turk je, apo ke shitur edhe shpir-tin? Këto ja tha shqip dhe mori përgjigje një vështrim të ash-për. Sazet muarnë një mane të vjetër, sikur delte kënga nga fundi i një pusi, sikur atje mjaullinin maçokët:

Çanakala içinde

Vordullar beni.

Pipa e nargjilesë dridhet në dorën e bimbashit, sytë e tij janë bërë gjak. Tashti sazet kanë marrë një këngë

dasme shqipe. Fytyrën e sëndisur të Skenderit sikur e le-dhatoi flladi i Radomit.

«Eh, Harito, Harito, sa i mirë më je, por unë do ta tund këtë kafene prej greku, do ta dërmoj këtë bimbash turku, do t'u kall plumb në bark zaptijeve por... do të vdes duke dëgjuar këngët e atdheut. Papritur një mistri shkau në dysheme, edhe një plumb, edhe një torbë. Katar djem të rinj me shami ndër duar po hedhin valle. Skënderi i njozu pa i njozur. Ishin Bexhaniotë:

N' atë shesh n' atë mejdan
Dolli dhëndëri asllan
Shikoni g'fustane mban
Të gjatë me klapodan
Permelenë gjith me ar
Sumbullat margaritar!

E, sa qenë shqipo n'atë sallë u kujtuan medoemos se në dasmat shqiptare derdhet oriz e sheqer, mbi duvak dëborë, u kujtuan për plloskat me verë e borzilok, u kujtuan për fustanellat me njëqind pala, u kujtuan për një shesh fshati shqiptar shtruar me rrasha ku trimat kércejnë me vrull e hov rinie.

Tashti në kefene kanë lënë pijen e mbajnë sehir. Edhe nga banaku zgjasin kryet. Kënga e dytë ndjek të parën. E sa u nis, Skënderi këçente mes sazeve. Bimbashi bëri ta ndalojë por vështrimi mirëdashës i Haritos e qëndroi. Zëri i komitit është i shkrifur dhe i émbël, pizga e gënetës po përpëlitet, telat e jongareve desh bëhen copë e trokë, harku i violisë fluturon:

Në dasmë ne der' e madhe
Vijnë çupat valle valle
Vjen xha Gania me fustane
Me thik e me tallagane
Me një çupë kaçurrele...

Sytë e të gjithëve janë ngulur mbi fytyrën e djaloshit shqiptar. Këtë ai më shumë e ndjen se e fsheh, fajet i janë bërë prush e qejfi mal, zëri i tij ka ngritur

peshë zérat e gjindjes. Dezhaniotët sikur janë marrosur, vallja e tyre të rrëmben, gjaku të vërshon ndër deje, e të bën të flakësh tej drojen e pleqerinë, të hidhesh në mes të tyre e të shfresh dufin dhe gazin. Balli i Haritos u mbush me mexhite, dhe një çifut mjekërxip e shkuli qesen e ja ngjiti Skënderit një mahmudie në ballë.

— **Udri bre arnaut!** — bërtiti një bullgar i madh.

— **Iso, bre, more ton qerata aravanitis, tin oreo glendi!**

— **Afërim bre arnaut!**

Çifuti përpoqi duart e diç ngatërrroi në gjuhën e tij. Kërnacet e ermenit po digjen, po ai s'e ka mendjen aty, tavllat e zaret janë lënë mënjanë.

Ho! Ho! Dasmë shqipëtare!

Dhe save u rreh zemër e këtillë, u kujtohen çupat tona kur shpien në çezmë një pëllumbeshë të bardhë, u kujtohet një kaleshe vetull-nepërkatë kur lyen portën me mjalte, u kujtohen koburet në erë kur vijnë deshinxjtë ëdarovë, u kujtohet (e me qfarë dhëmbje) një brengë e djalerisë fshehur si shpuzë mu në thelb të zemrës.

Tashti balli i bimbashit éshtë përzierë me furtunën. Sytë e tij vështrojnë në hava, larg, tutje, në pafundësi. E thellë-thellë në mendjen e tij buçet Osumi, ushton Gramozi, blegërijnë manarët. Pllazi i tij i djathtë rreh bashkë me këngën. Nër duar po dridhet pipa e nargjile-së; po tringëllinjë këmborë në stanet e Milecit e në Vëllamarë, po gumëzhijnë burimet te qafa e Kazanit tufa bilbilash po këndoju nër kaçubat e trëndafilave ndënë Borovë, zërin e tyre e rrëmben jehona e ja lëshon pyllit. Dasmë shqipëtare!

Malli i zemrës po ulërin në shpirtin e zjosur të bimbashit. Tashti i bëhet se éshtë fëmijë i zbathur e kërcicjet rrë. I bëhet se éshtë në një shesh fshati shqiptar, si dikur, e mban sehir i ndejtur këmbëkryq. Dora e butë e një nëne shqiptare i përkëdhel flokun. I duket se ja edhe tashti, si dikur, fustanellat e bardha i fluturojnë mbi fytyrë, i rrabin ballin, era e tyre e deh. Ai kërkon t'i kapë ato pala të bardha, t'i puthë, të fërkojë fytyrën, të

fshijë zemrën e vet, ndërgjegjen, syrin e përlotur; buza i dridhet, qerpikët i fluturojnë bashkë me harkun e Haritos, kënga e komitit ja përvëloj zemrën:

— Oh unë... o i ziu unë!

Djaloshi shqiptar mbaroi këngën po sazet s'e kanë mbaruar, as edhe valltarët. Skënderi pa ballin e bimbashit, hetoi këmbën e tij që rrihte bashkë me këngën, deshi t'i kapte edhe vështrimin, por nuk ja gjeti gjékundi, ai i kishte ikur lart, shumë larg. Iu afrua javash e, duke ja qëlluar majën e çizmes me thembrën e vet, sikur desh t'ja mbërthejë, i pëshpëriti:

— Të zura, të kapa, o i mjerë, të zura, o fatzi. Shqiptar me gjithë opinga!

Bimbashi kish varur krahët i dërmuar dhe i humbur:

— Më zure vëllaçko, më zure...

Pipa e gjatë e nargjilesë ishte shtritur përtokë si një gjarpër.

Portokallet

Ishim duke hyrë në qytet kur autobuzi ynë, papritur e pakujtar, frenoi në vend. Udhëtarët u shkulën nga fronat të trembur e vetë, që isha në krye, desh i hip shoferit në shpinë. Por ky çeli derën me vrull dhenërsa hidhej, jashtë, i dridhej bulçia e majtë. Si zbriti, vuri duart n'ije dhe me fytyrë të ngrysur shihte njeriuun me kazmë në dorë që desh e shtypi. Ky i fundit, nga sulmi i kanosjeve, u ndal si një makinë që i këputet zemëreku, uli kryet dhe heshti.

— Jo jo, nuk të shtypja, — foli shoferi, — të pashë, të njoha dhe kaq, bjeri kazmës qen!

Të gjithë vështruam njëri tjetrin në sy e ngritëm supat. Autobuzi u vu sërisht në rrugë, flokët e shoferit qenë ngritur përpjetë, por me gjith këtë ai u foli miqësisht dy tre fëmijëve që i prenë rrugën dhe fare në fund, kur autobuzi qëndroi në agjensi, shoferi lëshoi një psherëtimë sikur desh të fshijë me të ndonjë kujtim të largët e të zymtë:

— Të më falni udhëtarë, njerëz prej gjaku jemi dhe...

Kureshtjen time unë e kënaqa ditën kur shoferi, Vangjel Veriga, kishte pushimin:

«Eshtë një histori e dhimbëshme, më tha, sapo u shtruam në bisedë. — Sigurisht ti je djale i ri dhe nuk di gjë nga ajo kohë kur unë isha çirak, ndihmës, qen dhe baltë... Pardje ti nuk e njohe njeriuun me kazmë, por ai më njoihu mua. Ai ka qënë ustai im në vjetet e para kur unë dolla në jetë për të mbajtur shtëpinë me bukë. Më kishte çirak në «hambarin» e vet, më dërgonte ku kish-

te punë, më kishte mësuar të fshehtat si të sillem me kli-entat e tij. Bie fjala, i vinin tre katër miq në dyqan, unë shkoja në kafenenë përtej e porositja me një mënyrë pak të çuditëshme: «katër kafe të mira e një për ustanë»; kjo desh të thoshte: katër kafe dosido e një prej kafeje të mirë. Dija si duhej përcjellë ky e si ai tjetri, cilin e desh ustai e cilin jo. Nuk do të tregoj si më mbante pas në pazar me shportë e thes në dorë. gjëra të vogla ato. Po le t'i biem shkurt: Ai qe hambarxhi. Po dale se ti mbase nuk e di ç'do me thënë... Hambarxhi quhej një pasanik që grumbullonte bereget e çfardo malli tjeter. E vendoste në depot e veta dhe pastaj priste shkurtin, kur shtrënjohej, e ca më shumë i lutej zotit të bëhej ndonjë zi buke dhe të mblidhët lëkurët... Zoti Nikoll, i tillë qe. Nga fytyra ka qënë burrë i pashëm, me sy gjith të qeshur, me gaz në buzë e uzurë në majë të gjuhës.

Ka qënë dimër, prag i Kërsħendellave, tregu qe zbruzur nga portokajtë dhe ustai nuk kishte asnje kokërr në depo. Thërriti shoferin e tij Mihan dhe kerkoi të bë-heshin gati për udhë: U nisëm me Shevroletin e tij për në Sarandë. Ustai, Miha dhe unë, si ndihmës. Që këtu ngarkuam fasule. Shpina ime i vendosi një për një thasët në karrocerinë e kamionit dhe u nisëm. Ishte shënëndre i vitit 1943, kohë lufte. Sa arritëm në Sarandë, shitëm mallin shpejt e shpejt dhe ngarkuam portokaj. I mbuluam mirë me mushama dhe u nisëm pas mesnate. Ustai bënte hesap që nga mbrëmja e ditës së ardhëshme të mbërrinim në qytet.

— Shkelja gazin, Miha — urdhëroi ustai dhe Miha ja shkeli gjer në fund.

Qe ftohtë atij dimri; xhamat anës na u veshën me okitë që sapo muarmë përpjétën Mužinës kurse xhami përpara vishej me avull ndërsa fshirëset vej e vinin si fhesa të vogla dhe e fshinin. Sido kudo afshi i nxeh të i motorit nuk qaste akullin atje. Por u duk se kjo ishte veç e përkohëshme se sapo kaluam Gjirokastrën e i hymë grykës se Këlcyrës ndroi gjendja. Xhamet e anës u veshën me akull, ndërsa xhami përparë zu okitë. Pa

ndaluar makinën, delja vetë nga kabina në parafango. Gryeja ciflat e akullta me ksistér e sérish futesha bren-da. Anë e mb'anë frynte. Suferima vërvitej në quell, ulerinte pas xhadesë sa na duhej të qëndronim herë pas here sepse, sado të forta që ishin dritat, nuk shquanim dot përpara. Ustanë e mbanim në mes të kabinës, ai kishte mbështjellë këmbët me kuvertë deveje, mbante pallto stofe të trashë, dorëza lëkure, galloshe të holla mbi këpucë e një shishe konjak në dorë. Ngrinte pijen herë pas here e mua më xixéllonin sytë pas «Barbaresos» që shkëlqente nga ndriçimi i yjeve të artë mbi etiketë. Një herë të vetme ja zgjati edhe Mihas, po kur prisja të më jeposte edhe mua, ai hodhi një vështrim të urrejtur mbi buzët e mia e foli: —

— Mblidhu ore, se na nguce...

Unë bëja çmos të strukeshha fort mos zija shumë vend dhe i kaloja çastet e mia nënë peshën e një frike të patreguar. Çdo njeri që hasnim rrugës më kallte lemerinë. Ndonjë udhëtar e ngrinte dorën, si pëershëndetje, e mua më zinte tmeri: «Bobo — mendoza — ky po na kërkon vend në makinë.» Se e kisha pësuar edhe herë të tjera; le të qe dimër a verë, ustai të zbriste nga kabina përpesë lek të shkreta. Kur qe puna përfitim ai shiste dhe të jémën.

Dita na u hap dhe gjer në Përmet nuk na ndodhi gjë. Zbritëm këtu dhe u futëm në një kafene. Ustai shkoi të ngrohet pas banakut kurse ne me Mihan muar-më nga një çaj. Pas xhamit dukeshin fëmijë me çomage nér duar e qese në shpinë, nér duar mbanin gështenja të ngrohta e kolendra; kaloi një grup duke kënduar «Lindjen e Krishtit», një gegë shiste hallvë kockë, një tjetër me një ibrik të bardhë shiste kupa me salep të nxehjtë. Topa pupagjeli me sheqer ishin vendosur në një vetrinë karshi. Më kishte kapur malli i zakonit të «kollendrave» dhe shihja si i shastisur përjashta kur Miha më foli: — S'i kemi punët mirë.

— Pse o Miha?

— S'e shikon? Ai po bën pazar me një udhëtar. —

Kur ngrita sytë andej pashë ustanë me gisht të ngritur lart:

— Një, i thoshte, një napolon kartë gjer në Korçë...
Mua më kapi tmeri.

— Mos u tremb — më dha zemër Miha — do t'i flas unë.

Nuk kaloi ndonjë çerek ore dhe ustai dolli këtej. Pas i vinte udhëtarë me valixhen në dorë, i veshur dhe i mbajtur mirë. Dukej se do të qe nga tregëtar e përpjetë.

— Ndize motorin, shofer, urdhëroi ustai, kemi edhe një «posaxher». Ti Vangjel hidhu lart...

Unë mbeta. Miha e hoq mënjanë.

— Të bëj rixha o usta, po gjynah për ndihmësin, eshtë ftohtë, qahmet, nuk qëndrohet jashtë.

— Hajde, hajde, se e di unë atë punë, ti shih timonë aty. Vangjeli eshtë djalë, euh, kur isha djalë unë...

Atëherë guxova edhe vetë.

— Djalë vërtët usta, por njeri jam, nuk e shihni si ulerin veriu!

Ai ktheu shpinën e nuk foli fare. Vetë u bëra përtë lidhur bûzën, Nofullat nisen të më dridhen dhe sytë m'u mbushën me lot. «Duro o i biri i fukarajt — i fola vetes, duro e mbaj veten, ke njerëz në shtëpi, prindëri përtë pleqëruar, motra përtë pajuar... dhe ju nofulla mos u dridhni tashti, prisni, kini kohë.»

Mbeta si gur varri te rrrota e parë. Miha më dha dorëzat e tij e futi një bidon me ujë pranë vëtes. Pastaj më foli ngadale:

— Bëhu burrë, do ta qëndroj makinën dendur rrugës që të ngrohesh pas motorit.

Sa zura të hip në karroceri më foli ustai:

— Shiko mos rrish mbi mallin, unju mbi fuçinë e benzинës.

Dhe fuçia ishte mu në fund të karrocerisë nga krahu i majtë, që veç së ftohtës do më troshaniseshin edhe zorrët. Po këtë kush e qante!

Në një të përpjetë, filluan edhe ethet e mia. Më

Ishte i kotë mundimi pér të ndaluar nofullat mos shkallimohen. Veç mbaja gjuhën kutullaç nga frika se mos mbetesha edhe pa të. Trupi m'u bë dru, këmbët nuk i ndjeja dhe vetë dridhesha. Nga gryka zunë më delnin ca rënime që ngjanin me agullimet e ujqëve në kollozhek. Po ç'mund të bëja tjetër, veçse të duroja? Pas ndonjë ore Miha më foli:

— Si dukesh Vangjel?

Ja ktheva përgjigjen me një krahasim që nuk shkrumët në kartë. Falesha që mos shpohej ndonjë gomë. Dhe pér fat nuk u shpua. Më dukej se makinës, hekurit, iu dhimbsa unë, po ustait jo. Ai pér një napolon kartë më la të ngordh. Pak më tej Miha frenoi.

— O Vangjel, më thirri, zbrit se na u zu tubi i karburantit. Këtë e kuptova menjëherë. Ish puna që të ngrohesha unë.

Çelmë kapakun e motorit.

— Si dukesh? — foli shoferi ngadale.

— Keq o Miha, keq... dhe lotët ma prenë zërin.

Mos qaj, — më tha, — mos e lësho veten, nuk dua të qash në syt e tij, të merr pér ters dhe të pushon nga puna. Do lëshoj ujën e nxehjtë të radiatorit. . . (aty pér aty ktheu mendje) jo, jo se mos qullesh e bëhesh më keq, por ver duart afër motorit. Ja, atje mbi atë tubë bëj, më sikur ndreqim diçka.

Nëpër të çarat e mbulesës hodha një sy nga kabina Dukej se atje muhabeti kishte shkuar thellë.

— Dollën miq, që u daltë shpirti nga hunda.

'Unë ngrohja duart, kurse ai nxori vidhat e kabileton e një kopertoni të brendëshëm.

— Do ta mbushim me ujë të nxehjtë nga radiatori, veç ta marrësh zvarë, mos e shohë ai.

Unë hapa çelsin e radiatorit e ai zbriti, mbushi llastikën me ujë të nxehjtë. Pastaj e zvarrisi prapa e më shkeli syrin nëpër kandelat.

— Gati usta! E ndreqëm!

Sërisht u vumë në rrugë. Këmbët i ndjeva më mirë,

por kjo ishte një ndihmë sa bujare aq edhe jetëshkurtër. Pas ndonjë çerek ore llastika u ftoh krejt. Ngrica, era, suferima, cikërimat e dëborës më vërsuleshin nga të gjitha anët e unë nuk kisha të mbrohem veçse një gjysëm kapoti të vjetër që kundërmonte naft e vaj. Mendova të ha një portokall. Ngrita një kind të mushamasë dhe mora një kokërr. I hoqa lëkurën me dhëmbë se gishtat nuk më punonin. Po nuk qe e mundur ta haja, portokalli qe i ftohtë dhe m'u duk i hidhur si helm. Jo sikur do ta haja po sikur do më hante. Shihja malet anësh, pishat e rënduara me borë, ndonjë ujk që rendte si i marrë nëpër akuj, ortekë bore që rrëzoheshin nga majat. Diku larg e larg dëgjova të shtëna armësh e mendoja:

«Ku jeni o shokët e mi, ku jeni, o partizanë, a nuk delni këtu në mes të kësaj batërdie e t'ja shtrojmë me portokaj, t'i kallim zjarrin makinës dhe të ikim larg, tutje nëpër foletë tuaja!... Ejani, unë u dua sot këtu, të shihni hambarxhinë si e ka lënë cirakun të vdesë nga e ftohta, eja të shihni një shëmbull të gjallë se si vuani e heq fukaraj, ejani...»

Asnjë përgjigje për mendimet e mia. Veç era ulërinte dhe motori grindej duke tërhequr me mundim brrën e rëndë. Zinxhirat e rrotave të pasme tringëllinin pas akujve dhe tymi mavi i motorit zhdukej sapo delte. Sa, vinte ndjehesha më keq. Pëqiri po më ftohej, ky ishte fundi im; ma kishte mësuar im gjysh prej kohësh. Ai kishte qënë qiraxhi në kohë të Turqisë: Po t'u ftoh vetja, më thoshte, vajte, mbarove, ke vdekur, pra bëj çare me kohë.

Por diçka duhej të bëja. I duhej gjetur një rrugë së keqes, një çare, një mënyrë. Kam vënë re në jetë, se kurdoherë që i kam thirrur nevojës, kjo më ka mësuar. Nga maja e përpjetës që po zbrisnim bashë një kalorës. Një i dytë po e hiqte kalin e një njeri i tretë po e mban te për krahu kalorësin. «Ky do të jetë i sëmurë, mendova, dhe i sëmurë rëndë sa që e kanë shpënë tek mjeku në këtë cikmë. Sa u ndeshëm përballë me ta, unë u bëra



shenjë, dhe u, flakërriva pesë portokaj ndër këmbë. Kali qëndroi, e ai që e tërhiqte u turr pas kokrrave pastaj ngriti duart e më përshëndeti. Edhe i sëmuri me fytyrë mbuluar me shall të zi, u kthye nga unë e më përshëndeti. Kjo më gëzoi e sikur më ngrohu. Se si thotë fjala: Bëj të mirën e hidhe në det.

Tashti që hodha çapin e parë, duhej të hidhja edhe të dytin edhe të tretin...

Po kàlonim në Tri Urat. Grykat ushëtinin nga era dhe thëllimi priste si brisk. Asnjeri nuk dukej kurkund. Por kùr sheh lumin e madh që gurgullon zhurmëmadh nëpër akuj, të ngjallen kaq dëshira, kaq mendime... Se lumi është i madh, i gjatë që këtu e gjer në det. Dhe gjer në det anësh tij ka njerëz, ka fëmijë që koloviten me slita në akull, që e kapërxejnë me ura e lesa. Na, o lumë, merr portokaj, nanurisi mbi valët e tua e shpjperi tutje, larg; t'i marrin fëmija ndër duar, të qeshin, të gëzohet për Kërshëndella.

Hakmarrje! Hakmarrje! — sa e ëmbël që je!

Më muarën zjarr krahët nga hovi i hedhjeve dhe sikur nuk e ndjeja më të ftohtën e parë. Kaluam Leskovikun, Sotirën, fushëzën e saj të vogël dhe maqina filloj të zbrësë nëpër Gërmjenj. Kalamanët e shkollës, si e kanë zakon u turrën pas saj. Unë s'e bëra të gjatë... Fillova t'i qëlloj me portokalle. Një, pesë, dhjetë, njëqind. Fëmija sikur u tèrbuan nga gëzimi i rendnin si të marrë duke u rrëzuar nëpër dëborë. Motori ulërinte, automobili vërvitej përpara e fëmijët fishkëllonin duke treguar në pëllëmbë portokajtë e verdhë. Një çamarrok i vogël po rendte akoma pa pasur gjë ndër duar. Rrëmbeva pesë kokrra e ja hodha. Turma ulërinte nga gazi e mësonjësi i çuditur dolli ne qoshja e shkollës e tundte dorën me gaz në fytyrë. Për çudi, e ndjenja veten fare mirë. Gëzimi i të tjerëve ta ngroh zemrën, por edhe gjithë ato lëvizje të shpejta duke hedhur portokaj... të merr trupi zjarr. Mendova një çast: Kjo që bëj është vjedhje, flakërrij mallin e botës, bëj mëkat. Por një zë tjetër sikur më foli në vesh:

«Mirë se ti hyn në hakun e tjetrit, po ai tjetri atje brenda ç'bën? Atë, si thotë fjala, as pleshti nuk e kafshon prej një humbje të tillë, kurse duke të lënë ty këtu... po ta merr shpirtin, po të mbyt, mor hajvan. E përsë? Për një napolon kartë.» Po sikur të më pikasë? Do kërkojë shpagim. Po çfarë t'i jap unë? Krahët e mi! E mirë, ai i ka se i ka. Ku të dalë pra. O burra! Afër Shalësit një tufë çunash po nxirrin dushk të thatë nga lisnikët. Në fillim ata u trembën, pandehën se i qëllaja me gurë. Pastaj u mblozhën dhe zunë shiheshin sy ndër sy. E kuptoja që nisën të brohorasin, të cirren, të thérresin, po nga zhurma e fortë e motorit nuk dëgjoja gjë vëçse shihja gojët e tyre që gati çaploheshin. Ata vraponin, unë i qëllaja gjersa krahët m'u lodhën e gjaku më vërvshontë me forcë. Trupin e ndjeja valë dhe zemrën e kisha gjithë gаз.

«Ai qen mendon se unë do të ngordh këtu. Ku ta dish? Ai mbase nuk mendon fare përmua. Ose mendon si përmendonjë qen. Por, jo, jo, unë nuk ngordh, jo, unë do rroj, unë jam djalë i ri, shokët e mi luftojnë malevë. Ah sikur një nga këta portokaj, një i vogël fare, një mandarinë fundja, një e tillë të bëhej bombë, t'ja vërvitja sipër ustajt, ta bëja copë copë e të merrja malin përpjetë. Po sikur të rrëmbej manivellën, t'ja fut mu në kokë, t'ja dërmoj kafkën e të kërcas malit!»

Hakmarrje! Hakmarrje — sa e embël që je!

«Po, ç'del nga një vrasje e tillë? Asgjë. Në u shoftë ky hambarxhi, ka të tjerë. A prishet godina po i hoqë një gur? Jo. Duhen hequr gjithë gurët që të shembet kjo godinë e vjetër. Dhe vetëm kështu ngrihet pastaj godina e re. Po dale, ku i kam dëgjuar këto fjalë?

Çudi! Unë që kam kurajo edhe ta vras, qëpari mendova se është mëkatë që flak portokajtë. Ha, ha, sa budalla që isha!

Ndjenja të çuditëshme po më lëvrinin përbrenda, por kryesorja që se ndjehesha mirë.

Dëgjova zërin e shoferit që më pyeti?

— Ej, Vangjel, si ndjehesh?

— Mirë Miha, jam fare mirë.

Diç bisedonin brenda e m'u duk sikur shoferi më fliste akoma. Pa i fola:

— Mos the gjë Miha?

Ai zgjati kokën nëpër dritaren e kabinës:

— Jo, jo, ustai flet, thotë se Vangjeli është djalë i fortë, durojn shumë, i zjen gjaku... dëgjon?

— Ashtu vërtet, gjaku më zjen, po, po.

Në Korçë arritëm më të mugëtirë. Përpara se të filloja nga shkarkimi, ustai i hodhi një sy mallit.

— Të shohim një herë, mos kanë ngrirë rrugës, po ti, mor malukat, — m'u shkreh mua, — sa copë farma-kose?

— Të betohem usta, as edhe një. Dhe nuk gënjeja.

Por sa çeli mbulesën ai mbet në vend. I gjithë fundi i karrocerisë ishte bosh.

.....

— ... do të m'i paguash gjer në santimin e fundit. Dy muaj rrrogë i ke brenda, e sapo të mbarosh çdëmtimin, të mos t'i shoh më sytë. Në hambaret do mos shkelësh më, hajdut i keq, merr samarë e Hodos dhe qëndro ti në vend të hamallit, Hodua në vendin tënd.

Asaj nate nuk më zuri gjumi. Në mëngjes dolla që të takoj Gaqo Vidhën. Ky ishte hidraulik, dhe më afronte për bisëdë gjithnjë. E gjeta në oficinën e Vasellit duke ndrekur një tubë. Ja tregova gjithë ngjarjen. — Po ç'ke ndër mend të bësh? — më pyeti ai. Ju përgjigja menjëherë: — Kam vendosur t'i kthej portokajtë në bomba.

Ai lëshoi matravidhën, e më pa në sy.

— S'ke frikë nga gjith kjo e ftohtë?

— Jo, o Gaqo, unë jam i fortë, duroj shumë, unë u ngroha duke flakëritur portokaj... kurse po të hedhësh bomba...

Atij i qeshi nuri e më ra në sup.

— Vec kam një hall, — i shtova, — si do t'i bëhet çareja familjes.

— Për të mendojmë ne, nuk je ti i pari. Nisu!

Të nesërmen po ngjitesha përpjetë malit të Mborjes me një copë kartë në gji. Nëpër shkëmbenjtë e avushës thepa thepa, ulërinte veriu. Bota ish bërë kallkan, kurse mua më dukej sikur shihja përpara kalamaj me portokaj nér duar, tek cirreshin e këndonin në një valle gazmore.

Partizani i vjetër

Partizani i vjetër
Partizani i vjetër
Partizani i vjetër

Dasmë e çuditëshme

(Tregim i një partizani)

Edhe në gjumë e ndjeja që reshja s'kishte pushuar. Kaq ditë që shiu na kalbi mish edhe këmishë. Sapo u zgjova, sytë e mbyllur m'i vriste drita, ndaj nuk i çela. Duhej të qe mesditë. Që natës më pat marrë gjumi pa ngrënë e pa pirë, e bile pa terur rrobat e lagëta. Në një çlodhje të tillë më ishte dukur sikur gjymtyrët m'i përkiste një dorë e butë që m'i përkëdhelte, m'i fërkonte dalngadalë ndërsa unë n'ëndër shihja sinira me bukëvale, kroje me ujë jar, tek haja e pija si i babëzitur e s'kisha të nginjur.

Sa bëra të çel sy menjëherë u prapsa. Një zë i hollë vajze filloj të flasë. «Ç'të jetë kjo? Mos akoma jam n'ëndër!»

Ndër ato malësi t'egëra s'kisha parë kurrë një fytyrë femre. As plakë e as të re. Po kjo, kush do të jetë? Mbi ballë ndjeja tehun e një plafi që më mbulonte trupin. E zvarosa ballin një grimë tatëpjetë dhe çela pak njërin sy. Nëpër thekët e murme pashë... Shpejt e mbylla qepallën por m'u hap dëshira t'i çel të dy dy sytë e të hidhem përpjetë.

«More, po ku qënka rritur kjo guguçe! Me sy me fytyrë, me flokë me trup, nuri vetë. Kullumbri nga sytë, vishnjë nga buzët dhe leshrat i ndrinin si zift i vakur.»

Ajo nuk qe partizane nga shoqet tonë. Ajo ishte çupë e shtëpisë, që fliste shkoqur me tre shokët e mi.

Menjëherë u kujtova se ne patëm ardhur këtu për

një punë të çuditëshme. As për luftë e as për punët e saja, po për dasmë! Në vend të pogacëve patëm sjellë dyfegje, një vend të dëshinjve përsëri dyfegje e në vënd të darovës dyfegje të tjerë. Se për këtë dasmë në mes të luftës, veg të tillë duheshin.

Por tashti më vinte zor t'i hapja qepallat. Pak më vonë dëgjova që rrahnë shkallët e shtëpisë nga çape burtrash. Ja edhe një këngë që andej:

«Nëna imë dhe babaj
Me lot po më qajnë...»

Nëpër ato hyrje e përshëndetje u ngrita edhe vetë. Si e desh mirësjellja, së pari i zgjata dorën një gruaje që rrinte mbi sëndyk. Ajo mbante një farë peshtemalli me vija si pregaç (1) e një palë tumane të kuqe mbi këmbët e zbatura.

Vajza, që rrinte më tëhu, më dha dorën më me dëshirë, me bryl të thyer e ngazëllim, sikur të njiheshim prej kohe.

— Unë jam Sherka — tha ajo, gjith këta burra jeni lodhur për mua... bo, bo...

Cudi me këto vajzat e mbyllura! Kur i mendon i merr për qënje gjysëm t'egëra.

Qerimi, si njeri i shtëpisë, më rrinte kundrejt e dridhëte cigaren:

— Mos fol ashtu çupeëë. Ne ardhëm këtu për ty dhe për atë baba trim që pate, për atë babë që na e la guriin e mullirit më qafë.

Kishte ndodhur asaj malësie të largët, thellë atij fshati të humbur, që Sherka, vajzë e rritur tashti (vajzë për «më kalë» si thotë fjala) kishte dy vjet që priste krushqit e këta nuk kishin ndër mend të vinë. Fort i mjuar, i ati i Sherkës kishte bërë ç'i pat ardhur për dore, por më kot. Shtegtimi i largët dy ditë udhë, ishte pëngësë atyre ditëve të vështira, kur karvanet e dasmorëve

1) Pregaq = përparëse.

jo veç një herë ishin bërë shenjë e topave. Kalorësit dasmorë i dukeshin të huajt si çeta me kryengritës. Ca kohë më parë ishte vrarë në luftë i ati i Sherkës dhe kur vdekja i kishte dhënë dy tre çaste jetë, ai kishte lënë fjalën e fundit: «Dheu do mos më tretë pa u martuar çupa këtu e gjashtë muaj...»

Gjashtë muajt po kalonin e krushku i madh kish dërguar fjalë:

«Të huajtë s'na lenë të bëjmë këmbë nga fshati. Por në paçi besë e trimëri na sillni nusen juve, se do shkoj zemërdjegur nga pleqëria ashtu si i ndjeri nga plumbi.»

— Si e ka emrin dhëndëri, o Qerim, — pyeta shokun.

— Hilmi. Thonë se është djalë i mirë po njeri nga ne nuk e ka parë. Babaj i teqesë e vendosi këtë punë.

— A jeni gati, o shokë?

Kështu foli komandanti ynë që sapo vuri këmbë në kthinë. Ishte kjo një pyetje e bërë sa pér të shkuar radhën, se komiti (si e kanë thënë vetë pleqtë) është gati kurdoherë. As këpucë pér të mbathur, as gunë pér të veshur, e as gjerdhan pér të ngjeshur. Ne flinim rëndom si ishim, pa trazuar fare pajimin e partizanit. Gjumë komiti. U dha ndonjë shenjë? O burrë përjashta se ai matanë s'ka ardhur as pér një copë bukë e as pér ndonjë qese duhan. Ai vjen pér kokë dhe koka duhet ruajtur duke i mbajtur sytë katër e pushkën në dorë.

U nisëm drekëherë. Ca lot u derdhën më të dalë nga fshati. Ato që derdhët nëna domosdo ishin lot të dëlirë, sa pér ato të Sherkës unë s'mund të ve dorën në zjarr. Se, kush u martua e s'u gëzua?

Krushq të çuditshëm ne! Me armët peshë, bomba në brez, me pararojë e praparojë e mbi të gjithë pa raki, si s'mbahet mend ndonjëherë atyre maleve.

E shtruam rrugën ndër këmbë me Sherkën në mes. Ish koh' e keqe, me të sajat. Se atij dimri moti i lik mbajti gjatë. Qimtoj gjithë Marsit, fryjti Prillit, sa dëbora u bë akull e njerëz që meren me punët e motit (të tillë ka plot ndër ne) e thoshin se «plakat» harruan të

zgjohen me Prillin pa e lanë inatîn pér ditêt e para të Majit. Po, sidokudo, toka e mbajti besën, se dielli herë pas here ja bënte me sy që tej reve dhe ajo u lëshoi lëngun bimëve dhe e veshi botën me flet e lule, me bisqë e bar të njomë. Koha ishte e murme, pus nga mjergulia, por gjethi i ahishteve sikur ta çlodhët syrin.

Të mërzit edhe balta, qielli i vrejtur, mjergulla që të lyen me noti, përrrenjtë e turbulltë me ujë në ngjyrë të kuqe, të verdhë, zhul e llum. Një rrufe ja dha me krismë të thatë. Kur ngritëm kryet, një lisnik po digjej e aq e errët ishte bota sa flakët dukeshin të kuqe.

— Po gjemon, dështoi dëmri, — foli një nga shokët.

— Ah, po jo, mor, i paudhi as dështoi as ka ndër mend të hiqet, po me këtë mot, prite kur të nxjerrë kopile me gjithë opinga.

Gjithë gjithë jemi tridhjetë shpirt. Komandanti shkon në krye, pas pararojës, e herë pas herë gojë më gojë vijnë njoftime «U dëgjua një krismë pushke, mund të jetë edhe çifte gjahtori. Mbani armët peshë se gojë njeriu fishkëlloi përpara. Do dredhojmë nga e djathha, se përpara kemi fshat e lehin qentë.»

Sherka është gjithnjë në mes të kollonës, para saj ecën Qerimi. Druaj se i thura — xha — se gjem belanë. Mbi gjerdhan në xhep të jekut; i zbardh një kuti duhan. Mua më nxit gjithnjë dëshira t'i jem pranë njeriut që ka gaz në zemër, pra i shkoja vajzës pas. Ajo e ndjente vështrimin tim e khente kryet më shihte.

— Ama u ngope me gjumë, — më foli diku.

— Isha i lodhur nga udha.

Këto qenë sa pér të çelur fjalë, se më tej biseda rodhi vetiu.

— A ke qënë në Drizar? — më pyeti ajo.

— Kam qënë posa, fshat i mirë, prapa mal, përpara fushë, livadhe plot e vrështa sa të duash.

E mërrja me mend se Sherka nuk më pyeste as pér rrush e as pér ujra, ajo desh të dijë në e njihja Hilmi Feçin nga Drizari. Atë Hilmi, që ishte burri i saj i panjohur, atë Hilmi që sot po priste nusen në shtëpi.

— Edhe njerëz të mirë kam njohur në Drizar, mikpritës të mëdhenj, njëri syresh (besa emrin s'ja di) na gatoi oshmaren veç me gjalpë e djathë dele, po sa përemra... nuk mbaj mend.

Ajo lëshoi një nënëqeshje si shenjë se kuptoi, e së-rish bëri përpara. Unë i shkoja pas, pa edhe se mund të qe mëkat, mundohesha t'i shquaj vijat e trupit nënë atë fustan fanellate qepur gjërë e mos më keq. Se, mirë besa, nderi e ato fjalët e bukura mbi partizanin krenar, por në fund të fundit unë isha djalë dhe djaleria or tun-gjatjeta... Hej! ç'më hante koka...

Afér mbrëmjes, mjergulla u shpërnda në një grykë nga lindja dhe diku u duk ylberi. Vajza ngriti dorën andej dhe foli:

— Thonë se po të kalojë një çupë përmbi ylberin bëhet djalë... Sa mirë të isha djalë.

Më duhej diç t'i përgjigjesha po më mbet këpuca në baltë e zu këceja rreth me këmbën e zbathur ngritur lart.

Kaluan orë, ardhi nata e zezë si mellani; nuk merr dot me mend nga lind e perëndon. Lagështin e mjergullës e ndjen tek pushka që pikon gjithnjë. Dhe të vjen mirë t'i lagësh duart orë e çast se po i le të teren të duket sikur të zenë rëzhdë.

Papritur diç xixëllon përpara, dhe nuk e di se çfarë është: cigare e ndezur në ndonjë pusi, apo mënjanohet mjergulla e duket një kandile, apo mënjanohet reja e duket ylli, apo ndofta, ndofta kthen kryet Sherka e i xixëllojnë sytë.

Larg e larg qentë lehin, fshatrat flejnë futur nënë mafatin e natës dhe ne ecim e ecim gjithnjë, të ngarkuar me armë, të kredhur në mendime.

S'qënka lehtë të shkosh në dasmë në kohë lufte.

Sa zor do ta ketë pararoja. Ajo çan rrugën e padukur, këmbët shkelin bosh, ballet përpigen në drunj, zbrit e ngjit, zvarrë e me zor, as e marr dot me mend ku shkel e ku je.

Kur u gdhi vështruam njëri tjetrin. Ishim tërë baltë por rrugën nuk e lamë.

— Pa shiko ka mbirë misri, — flet Qerimi.

— Ç'e do, është kërthi sivjet.

Dy tre shokë këndojnë.

«Nëna ime dhe babaj — Me lot po më qajnë — Të enjten e madhe më marrin»

Diku këllëfi i mjergullës u çart, sikur u gris një kind i saj mbi ara. U dukën plepa përfund livadhesh. Fletët e tyre trokëllisin e shushurijnë. Shihet një gomar ngarkuar me pula, disa njerëz pas tij, qënkanc më armë... oj!

Një — fësht — pa fishkëllimë më shkoi te veshi. Barkas përtokë si shakull. Shtërngovë trupin dhe prita «përgjigje» nga lëkura. Nuk më dhëmbi. Pra s'ma kishin shpuar. Matanë urdhëra, nisën shkëmbime armësh. Edhe të shara domosdo.

— Ramë në pritë?

— Jo, jo, ramë në gjermanë plaçkaxhinj. S'e sheh gomarin me pula!

Dhe gomari i qetë ha lulegjemi në ledh e tund veshët i mërzitur nga të shtenat.

— Plaçkaxhinj vendës dhe të huajt Luftojnë, përkokën dhe për plaçkën, dhe janë shumë, mbapse njëqind e ca...

— O burra mbi tâ!

U sulëm përpara. As të shkon ndër mend se ka baltë, as që e ndjen se bie llohë. Por, që lufton në syt e një çupe të bukur, këtë e ndjen. Dhe të vjen turp që fare padashur, pa ditur, kafshon dhé.

— Ç'është ky paçariz?

Një tanks me armë u grind mes hendeqesh. Plumbat e tij nuk ngrejnë duman por hyjnë në baltë si thika në gjalpë. Fllup! Fllup!

U gjendëm në një korije dushku nga ku sapo kishin dalë. Se lufta s'është as dasmë as lojë cingëlthi. Lufta është dyndje, ethe, zvarrisje.

— Sherka, more, Sherka!

— Ja komandant, ja.

— Nëmërohuni.

Zënë e pyesim njëri tjetrin.

— Mungon një shok.

— Po kush?

— Seiti... te një shtyllë telefoni shoku komandant e fsheha vetë ndënë tufa shavari, s'mori vesh gjë, m'umi krahu — më tha, dhe vetëm aq.

Pritëm sa ra nata. E gjetëm edhe Seitin e vrarë. Dasmë e çuditëshme!

Mezi çelmë varr në shurigë të kuqe. Varrosim një shok dhe shkojmë në dasmë. Sherka mer pushkën e të vrarit dhe ze e qan:

— Ta dija kështu, rrija ku qeshë, unë martohemi, djali për dhëndër bie e vritet.

— Në luftë s'ka kuje — flet Qerimi. — Përndryshe, gjithë këto vjete duhet të cirrnim gjokset. Ai ra dëshmor i atdheut dhe i gazit. Se për këto gaze e dasma lutfotjmë, që të këndojmë e të martohemi ashtu si na e do zemra.

Sherka mundohet të heshtë e kafshon gishtat. Sytë e saj ngjyrë kullumbrie duken më të mëdhenj.

— Dasmë domosdo, se na duhen djem, ca bien të tjerë rriten, kështu e ka lufta.

Përsëri në rrugë me pararojë e praparojë, me armët peshë, me mendime të përzjera, të habitëshme që hipin kaliqafë njëra tjetrën e ngatërrohen. Dasmë e çuditëshme. Nisesh për punë gazi e të vrasin shokun mb'udhë!

Errësira na mbështjell më fort. Më duket sikur na gjëlltiti një gojë e padukur e ne rendim nëpër dhëmbët e grykët e saj. Po pararoja le të gjejë rrugën, komandanti le të nuhasë, le të bëjë çaré ai, unë hedh këmbët dhemendohem. As që marr vesh që udhëtoj. Në Drizar mbrijmë në agim, mbase më parë. Kanë dërguar fjalë e na presin. Sapo të afrohemi shtëpia do mbajë erë mish të pjekur, dardha turshi, simite të ngrohta. Ne u shpiem nusen dhe jemi krushq. Krushq të çuditshëm.

Sherka rend pérpara meje. E marr me mend se tash-ti ecën me krye të varur. Diku u pérpoqëm dhe ndjeva flokët e saj mbi ballin tim. Qeshëm ngadale n'errësirë si pér të kérkuar ndjesë e përsëri në udhë.

— Mös të vrava?

— Vetëm pak:

— Kurban motra, sa më dhimbiseni, u nisët pér mua një çetë e tërë, një shok e lat mb'udhë.

Flet Qerimi:

— Se vritemi pa duhen dasmat. Që të lindin djem. Dëgjon, o Sherkë, dua'm djem, ti do rritësh plot të tillë, djem pér burra e pér pushkë. Po... pa daleni...

Ai na preu rrugën e na vu duart mbi shpatulla:

— Oj? Ç'bën kështu?

U bëmë tre si perusti dhe ai shkuli qesen.

— Daleni, të ze një zjarr, po xixat mos duken, strukuni, qasuni!

Një tresh n'errësirë.

Nisemi të tre, nisen edhe mendimet e mia:

«Do arrijmë në Drizdar, Hilmiu në krye të odës, djalë i ri, fshatar, veshur me shajak, festen e bardhi kapitur mbi sy, i shkathët si dre, i pashëm si rrusp. Vëlla Hilmi! E pate fat këtë thëllëzë mal, u trashëgofshi, një herë e me jetë, po... kije kujdes. Ai nënëqesh por më sheh krenar, sikur don të thotë «mös n'a shit mend». Hilmiu rri në krye të odës e na sheh shtrembër. Hë, or qen, ne u vramë pér ty e ti na shikon vëngër?»

Ec, dhe merrem me Hilminë. Dhe më duket i huaj, i pështirë, dinak. Dhëndër i quditshëm.

Nisa ta urrej Hilminë. E urrej pa e njohur. Po përse, o partizan? Ty, që ke dalë të vraç urrejtjen të hipit mëria në mes të rrugës?

Përsëri u pérpoqa pas Sherkës. Qeshi e tha se edhe ajo që përpjekur pas Qerimit. Pra kish qëndruar kollona. Unë shkova pështymën.

Ardhi fjala gojë më gojë: — Jemi në të hyrë të Drizarit, presim të kthehet pararoja.

— Ejani.

Kam përpara një grumbull si lëmsh. N'errësirë fillojë të çdrindet (1) lëmshi. Po si duket Sherka nuk dëgjoi e unë sérish u përpoqa me të. Që të nisej i vura duart mbi supet e saj e bëra ta shtyj.

— Mos më shty, — tha ngadale — mos, mos, — kam frikë, frikë!

— Ti ke frikë? Këtë nuk e vura re atje ku kërciti.

— Atje ishtë ndryshe, vëllaçko, vëllaçko, kam frikë.

Vërtet ardhia era e mishit të pjekur dhe e bukës me qiqra. Po edhe një bletë do ta kishin prishur. Po dritë nuk dukej gjëkundi. Veç në një prag furre ndrinte një kup me shpuzë.

Dasmë e çuditëshme.

Sa hymë në oborr Sherkën nuk e pashë më. E muarën gratë më tha mendja. Dritaret e odave qenë zënë me rogoza, me levenxe, me bruca, që të mos delte drita. Nuk vura re në kishte llampë, se zjarri në vatër qe i madh e bubullonte. Dy kthina u mbushën plot me partizanë. Zhë e mban erë kozinë e djegur. Avullojnë rrobat tonë. Mjergull brenda e mjergull jashtë.

Krushku plak qenka vërtet me një këmbë në varr. Ngjatjeton e na hedh cigare në prehër. Një si shoku i tij ndan rakinë.

— Po dhëndëri ku është?

— Po, ja... ky është Hilmiu!

«Bo, bo! Dhëndëri?!»

Ndofta syt e mi u bënë si gryka cifuni (2).

«Po ky na qenka gërxho, plak dhe i shtrembët, mustaqet gjer ne veshi, i zi si katallan, i trashë si derr.»

— Ky është Hilmiu?

Heshtje prej varri.

— Po flisni, o djem, flisni, o shokë.

— Jemi në zi, na u vra një shok.

Zjarri bubullon, pa zë e kërcet. Unë mbaj kokën përdhe e mendjen e kam ujem. Çfarë duhet vallë që të pri-

1) Çdrindet = çmbështillet.

2) Cifun = gryka ku dalin ujrat e kades.

shet kjo dasmë? Mos vallë duhet shumë? Po zemra ime do pëlcasë se do pëlcasë, mbase duhet kjo, mbase vërtet. E shkul dhe e var në peronë.

Rreth e qark zën e pëshpërisin vesh më vesh. Edhe unë flas me të parin tonë por veç më sy.

— O i-zoti i shtëpisë; do nisemi!

Dhe komandanti futi saatin në xhep.

— Unë kam qef të rrini, o miq...

Një kujë në çardhak. Çapet, dum dum!

Sherka u dha në prag, pas i vjen Hilmiu, një grua-je i duket veç supi. Vajza hyn e shikon zjarrin, férkon témthat, na vështron të gjithve një nga një, qëndroi te unë e bëri të thërrasë. Po zë nuk i dolli. Faqet iu bënë limon e u drodh me gjithësej. Mbuloi fytyrën me pëllë-imbë por këtë radhë zéri i dolli i ngjirur:

— Jooo!

— Na ndje, o i zoti i shtëpisë, por ne do flasim veç me këtë çupë.

Dhe folëm shkurt. Ata folën me gojë, unë veç me sy.

Punë e çuditëshme.

— Do nisemi, o plak, se kjo punë e pat!

— Aaa?

— Vajzës nuk i pëlqen.

— Pse? Duhet t'i pëlqente asaj?

— Po kujt tjetër?

— Neve, domosdo. Është dhënë fjala, ky është zakoni.

Plaku shkon rruazat dhe dejet e zverkut i duken si gjalme të mavinj. Hyn edhe Hilmiu në mes:

— Po shkelni shumë vëngër o miq, zakoni i shqipëtarit!

— Ky zakon, or tungjatjeta, mban erë myk, zakon i egër, ndaj kemi dalë malit ne, ta shëmbim edhe këtë.

— Ju mund ta shëmbni nesër po sot, këtu në shtëpinë time...

Qerimi foli në fund:

— De, more, de, dashke mish pas porosie zotrote.

Na thanë bilbil e na dolle buf. Dhe bufi plak dashka dëllendyshen e njomë; jo besa se të mpihen dhëmbët.

— Edhe ti, o plak?

—Plaku i sat éme. Unë kam shokë djemtë, e kam djem sa të duash, hiqut tej!

U vumë në rrugë. Sherkës iu lodh njëri sup pa e hodhi armën në supin tjetër. Qerimi na preu rrugën e nă vu duart mbi supe.

— Daleni, qëndroni, do zemë edhe një zjarr.

U' bēmē tresh n'errēsirē.

— Strukuni se lloha na lag eshkën.

Masati qëllon, xixat ndizen me mijë, miliona e përhikënditen rrëth le rrëth.

—THE END—

1976-77

19. *Leucosia* *leucostoma* *leucostoma* *leucostoma* *leucostoma*

219 143 500 500 500 500

Digitized by Google

REFERENCES

ANSWER TO THE QUESTIONS

10. *Environ Biol Fish* 11: 105-112, 1986. © 1986 Martinus Nijhoff Publishing.

1968-1970
1970-1972
1972-1974
1974-1976
1976-1978
1978-1980
1980-1982
1982-1984
1984-1986
1986-1988
1988-1990
1990-1992
1992-1994
1994-1996
1996-1998
1998-2000
2000-2002
2002-2004
2004-2006
2006-2008
2008-2010
2010-2012
2012-2014
2014-2016
2016-2018
2018-2020
2020-2022
2022-2024
2024-2026
2026-2028
2028-2030
2030-2032
2032-2034
2034-2036
2036-2038
2038-2040
2040-2042
2042-2044
2044-2046
2046-2048
2048-2050
2050-2052
2052-2054
2054-2056
2056-2058
2058-2060
2060-2062
2062-2064
2064-2066
2066-2068
2068-2070
2070-2072
2072-2074
2074-2076
2076-2078
2078-2080
2080-2082
2082-2084
2084-2086
2086-2088
2088-2090
2090-2092
2092-2094
2094-2096
2096-2098
2098-20100

REFERENCES AND NOTES

For more information about the study, contact Dr. Michael J. Hwang at (319) 356-4550 or email at mjhwang@uiowa.edu.

1. The first step in the process of creating a new product is to identify a market need or opportunity.

Kokëkrisuri

Mali ngríhej si një pirg madhështor dhe fare në krye maja, prerë si me thikë, ish pllajë e gjerë sa tre lëmenj bashkë. Pishat e larta ishin moshuar aq fòrt sa qenë vaisur, sikur u faleshin burimeve fshehur ndënë kaçubat. Në shesh drita zbriste që lart ngá kurora e kreshtave me halthè e në piskun e vapës dukej sikur qe një mëngjez i vagëlluar.

Dhe në këtë majë mali, thellë Gramozit, atij moti e asaj dite, krikëllinin degët, ushtonte pylli e gerat qime ndritur vështronin me habi gjindjen që heshtëte.

N'atë shesh po gjykohej një partizan. Shokët e tij në një rrëth krejt të plotë, hedhur duart mbi supat e njëri-tjetrit, kishin rrudhur ballin, vajzat mbanin sytë përdhë, kurse djaloshi fajtor që nga buzët e kuqe përzinte me gjuhë fijet e ashpra të mustakut.

Qëndronte kryelartë në mes të rrëthit kundrejt gjyqtarëve të malit.

Ish një punë femre në këtë mes, një punë e papëlqyer e atyre viteve të ashpra. Se asaj kohe ish faj i madh të lektiseshe me vajzat. I egër ish kanuni dhe ca më i egër dënimini. Këtë e dinte mirë partizani që gjykohej. Dikur ish i parë ndër shokë ai, trimérinë e tij e njihnin miq e armiq, shokë e fshatarë; se kush i bëri teslim milicët e Urës? Kush kapi për gryke mitrolozin e bersalierit? Kush i vu zjarr kazermës së alpinëve? Kush e kaptonte vaun me një të hedhur?

Ish Gjik Vërrija ai.

Por ja tashti trimi i dëgjuar po gjykohej.

— Partizan Gjik Vërria, a ke dalë malit vullnetar?

- Po, vullnetar.
- A e ke bërë betimin e partizanit?
- E kam bërë.
- A e ke ditur kanunin e malit?
- E kam ditur.
- E ç't'u desh ty çupa e botës në mes të zjarrit?

Prandaj dolle malit ti; të puthesh çupat?

- Po unë e dua, shoku komandar, do ta marr grua, ç'do të thuash ti?

— Edhe në kemi gra, por i lamë në shtëpi, nuk ësh-të koha e grave dhe e çupave. Turp, o Gjikë, turp!

Komandanti gjyqtar bisedon vesh më vesh me dy shokët që ka anash e pastaj, si për të marrë një aprosim mundohet të këndoje sytë e partizanëve. Dhe sa sillet vështrimi i tij, radha valavitëse e fytyrave kundrejt, si të ish e lidhur me ndonjë legëtyrë, ulet drejt tokës për-t'u ngritur sérish sapo të kalojë ai shikim.

Tashti gjindja duket sikur nuk merr frymë fare. Dë-nimi do të ish zipas kanunit, i egër dhe i ashpër, gjyq partizan ai, shkoje për dhjamë qeni.

Dhe ja, nië këtë çast, partizani plak Kaso Rrapi hoi-dhi dy çape pára e kërkoi fjalën:

— Diç kam për të thënë, shoku Mihal, për thinjat e bardha e shpinën time të kërrusur, lutem dëgjomëni. I rëndë është fajti i këtij djali, dënimin e marrim me mend të gjithë, por vendimi i mirë duhet t'i unjet mendjes më të mirë. Vëllaj i Gjik Vërrisë s'ka mbushur motin që kur ra në sheshin e burrave; të mendojmë se një portë e mbyllim fare e për gjithnjë. Ç'fitoi nënëzeza prej kësaj lufte? Dy djem të humbur, njeri me nder, tjetri me turp. Shto edhe një vajzë të llafosur, barabar e vrarë, dhe ja se ku na bëhen trë. Por turpi në dorë të trimit kthehet në nder, ta marrë për fare çupën, ta shpjerë Vitën në shtëpi tek e ëma dhe mbaroi. Unë flas me dorë në ze-mër dhe kaq pata.

— Mirë e ke, o Kaso Rrapi, — ja ktheu komandanti, — por armiku atë do, të çthürët besa jonë.

— Duhet mëshiruar djali!

— Më mëshirë nuk shikohet në luftë.

— Unë kështu jam i mëndjes, fundja prisnim sa të kthehej komisari.

— Ulu ti në vend të tij dhe eja të gjykojmë.

An' e mb'anë heshtje, dëgjohen gerat tek brejnë zhuk, ndihet gurgullima e burimeve, krikëllima e minjollave.

Pastaj gjyqtarët bisedojnë midis tyre: Njëri shkroi vendimin, dy të tjeter vunë firmat. Komandanti u quamë këmbë dhe lexoi:

«Gjik Vërria, fajtor dhe shkelës i kanunit partizan, dënoshet më dëbimin e tij nga radhët e luftëtarëve, të lëshojë pushkën në vend dhe t'ikë».

Për një çast djaloshit sikur iu errësua bota, iu drodh nofulla e poshtëme dhe kafshoi buzët me dhëmbë. Pastaj me kryet lart bëri të çajë rrëthim e shokëve. Po, sa ish më të dalë, i foli sërisht komandanti:

— Lësho pushkën, pastaj largohu!

Ai ktheu kryet dhe e pa drejt në sy. Një qip i buzëve iu drodh dëhe bebet e syje sikur i nxorën xixa:

— Këtë, (ai rrahu kondakun me grusht), e ka marrë kjo kockë me gjak, edhe revolen që ke në brez ta kam falur unë, komandar Mihali, veri gishtin kokës se, për atë diell që ndrit atje, bëhet gjak këtu, në shesh. Shpirtin e jap, po pushkën e nderin tim as e ndaj, as e jap!

Shokët përreth muarën me mend sherrin që do të pëlciste pa hynë në mes dhe nëpër rrëmujë, sharje dhë rrahje gjoksesh i hodhën zjarrit ujë.

Gjik Vërria i përzënë nga shokët me damarin e ballit mavjosur dhe këcyer, iku larg pyjeve të Moravës, duke çarë shtigjet buzëçarë dhe i pikëlluar. Ai sjell ndër mend ngjarjet që e sollën gjer këtu:

«Pranverës që shkoi, hardhitë e krasitura sapo kishin filluar fë pikonin lëng. Në fushë të Selës, një vashë e bardhë po shartonte një qershi të kuqe. Më tej, bajmja sapo kiske veshur roben e saj prej trëndafil mali. Gjikë Vërria me pushkën në krah dhe yllin në ballë ka-

lon aty. Sa tē shkathëta iu dukën duart e vajzës, edhe tē shpejta, me llërë tē plota. Ai hodhi syt nē ledh: aty kish vlastarë me sytha, një jargavan, dyllë blete, një brisk tē hollë, më lart duar tē bardha e gaz nē buzë.

— Puna e mbarë o çup' e mirë!

— Mirseardhe, o trim!

— A s'u gjend një dorë djali pér këtë punë?

— Nuk kemi burra nē shtëpi, jam jetime, rroj vëtëm me time gjyshe.

— Po asnë mik nuk pate?

Ajo e vështroi egër. Zëri i saj sikur u bë me inat:

— A e di se ç'bën ti? A e heq atë festë tē bardhë se do ndjellësh ndonjë plumb ballit.

— Po ti qënke noprane, moj çup' e mirë!

— Çfarë tē hedhësh, atë do presësh.

Tashti janë tē dy pranë e pranë dhe ai kërkon t'ja shohë edhe një herë syt' e grizhtë, po fill n'atë çast dy lule bajame ranë mbi qepallat e saj. Dhe qerpikët i rrähën shpejt e shpejt dhe ai s'e gjeti dot me mend: ku humbën dy lulet e bajames? Nga shkajtën, nëpér gushën e saj?

— A s'm'i mban ca kalemat e shartit sa t'i shterngoj.

Tashti duart i kanë përzjerë pas bisqeve. Dhe ndjejnë tē dy një shqetësim tē ëmbël. Pa lidh e zgjidh nyjen, lidh e zgjidh shartin, sikur duan tē shartojnë edhe duart e veta. Më shumë jo. Ky ishte veç fillimi. Po kush ndez zjarrin e fillon me një xixë, se flaka vjen më tej.

Ja kështu mori fill puna që erdh e u trash sa u bë ujem e tevaturë.

* * *

Duke u ngjitur Moravës, ai mbrijti te Guri i Capit. Shkëmb i madh ai, shkëmb legjendash dhe përrallash, fole shqipesh, strofkë hajdutësh. Nuk i ra ndër mend djaloshit, as tē hajë e as tē pijë. S'i shkoi mendja atij as pér çlodhje e as pér ujë. Mendja e tij e turbulluar brendë posht e lart honeve, grykave; po i treteshin ëndërat e tij pér jetë e trimëri. Po ja përpinte kobi mendimet pér tē

ardhmen. Tufani po ja shthurte shpresat pér Vitën si ariu gjerdhet.

«Po tashti ku të shkoj unë? Si do vejë filli im? Të vete e të zbras vrerin te Vita? Jo! Hë pér hë, nuk shkoj atje. Do t'i ve zemrës gur pér ca kohë. Po asaj nuk i ndahem kurrë. Ndofta nuk bëra mirë që e nisa atë punë me vajzën, po tashti sa i hyra asaj rruge, nuk e lë kurressi. Unë atë e dua, ajo pér mua éshtë gjithçka, do ta dua gjithnjë shumë e më shumë dhe gjall' e shëndoshë do ta marr pér grua. Po. Do ta marr. Luftën nuk do ta lë, e dua popullin tim, jam i ri, i fortë, mua më takon të luftoj pér njerëzit e mi... Po si do luftoj unë? I vetëm? Kaçak? Shokët më përzunë. Jo shokët, ndofta ata nuk ka-në faj, më përzuri besa që shkela, por shokët më duan mua, e pashë këtë në syt' e tyre».

Ngadale gdihet. Maja e shkëmbit rri e vrejtur, gërxhet të imprehtë dhe kryeneçë duken si të mërzitur me mikun e ri, duken sikur munxosin qiellin. E ndofta se qielli nuk duroi dot atë krenari, ja se ku çeli grykat e përrrenje, ulëriti pllajave, hapi gjiret e mjergullës e ja se ku dërgoi re të zeza togje-togje, e më ta rrethoi Gurin e Capit me taborë të mürmë. Pastaj u lëshuan gërshta zjarri me térsëllëmë duke gjëmuar e bubulluar. Ashtu filloj reshja. Më kot u mundua Gjika të mbrohet pas gurreve. Shiu ishte kaq i vrullshëm sa kaçakut të ri iu njo-mën edhe sqetullat.

Kjo qe dita e parë pér të ikurin nga shokët. Ai mbet majë malit, fill i vetëm, shok veten dhe maliherin, dyl-binë e qafës e thikën pas pulpës, kollanet tej e ndanë gjoksit dhe kokën lart, ai Gjikë, pér një çupë të bukur, pér një kokë të krisur, pér një zemëratë e kanun të shkelur.

* * *

Pas disa ditësh, nëpër fushë u hapën fjalë:

«Gjik Vërria u hoq mënjanë me çetë më vete, Gjika u bë komandar, Gjika trim mbi trima!»

Këto fjalë i dëgjoi edhe komandant Mihali. I shkoi mendja për keq e zu mendonte:

«Kushedi ç'rrugë merr ai kokëshkëmb!»

Pa dërgoi shokë ta gjejnë. U nisën tre vetë. Në krye Ndoni i Ciles. Rrahën plajat, brodhën gérxheve, kérkuau zabeleve dhe ja, majë një shkëmbi hasin kaçakun Gjikë. Në fillim i folën ngadale, me fjalë e me të urtë:

— Ke fjalë nga komandant Mihali, eja nér shokët e tu, eja, unj kokën e kérko të falur...»

Po Gjika éshtë kokëshkëmb gjithnjë:

— Falë me shëndet komandantit, të shohë punën e tij dhe mos ngatérrohet me mua se nuk ja do shëndeti. Sa për ju, mos hidhni as edhe një çap përpara në u dhemb xhani. Ty, ore Andon, të them, se kam ngrënë bukë në shtëpinë tënde. Në ardhsha, vij si trim, por kokën se unj as sot e as mot!

Dhe Gjik Vërria mbet aty në majë të malit.

Fle vetëm në mes të pyllit, në një vetëmi të mërzitur, ka turp t'u dalë përpara druvarëve, ka turp të zbrese në fshatin e tij, druhet të takojë njeri, zemra e yshtë zgresë te Vita, por mendja e ndalon. Edhe në gjumë ai ndjen peshën e rëndë që i varet mbi gjoks. se ëndërat i ka ujem, me zjarr e gjak, me lumenj të turbull e me tym.

Dëndur i del gjumi. Agimi i duket i mjergulluar. kreshtat e lisave ushëtijnë ndënë yjet e zbehta, arusha e madhe éshtë ulur tatëpjetë, ndihen ujrat e burimeve, dëllénjave këcejnë lepujt, përpjetë rropaten derrat e egër. Fletët e dushkut zënë e pikojnë bulëza vese. Atij i mphen ijet dhe i dridhen nofullat.

Atëhere rrëmben pushkën dhe zbret tatëpietë përluftë e trimëri. Një natë i vu zjarr një ure në xhadé, një natë tjetër u fut tinëz në qytet, shkoi në një depo t'ar-mikut, rrëmbeu dinamit dhe pastaj i kalli pishën. Heraherës e ndjekin, diku e qëllojnë, por ai u shpëton se bashkë me guximin di edhe të ruhet. Këpucë nuk mban më, ka sajuar opinga kau të lehta me opute të gjata, ja hoq pushkës rripin si komitat 'dhe e mban gjith në dorë.

Pastaj e mori malli për Vitën. E vendosi të zgresë tek

ajo medoemos. Kaptoi majën e Moravës dhe mbrëmja e zu në mullinxjett e Bodit, në mes tē korijeve. Priti sa u largua mullixhiu në katund dhe u fut në mulli. Kish vendosur tē flinte aty gjer në mesnatë e pastaj tē zbriste në fshat. Hodhi një tezgë dërrase mbi trarët, shtroi ca the-krishte dhe u shtri tē flejë. Ujrat që ktheheshin nga pengorja gumëzhinin me potere. Pérreth erë myk e bar tē thatë, erë miell e aromë pishe. Në një kohë një zhurmë e shkoqur, dikush hyri nga dritarja, këceu tē patozi, gulçoi me tē fortë e shkoi i hoq llozin portës. Kanata u çel, gërviti një herë dhe sérish u pérplas në vend. An' e mb'anë errësirë. Gjik Vërria kapi armën dhe hodhi sytë pérposh. S'dukej asgjë. Një erë e rëndë kündërmoi, i ardhuri nga jáshtë po trazonte potin, qëllonte koshin, shtynte gurin, sikur mërmëronte diçka, gulçonte e sikur brente me limë ndonjë dërrasë. Herë-herë regëtinin dy si kokërdhokë me bebe në formë gruri. Kjo vijoi ndonjë copë herë, ndofta edhe më shumë. Partizanit zu i punonte mendja poshtë lart. E ç'djall bën ky njeri n'erësirë? Të jetë ndonjë lugat? Magjistar?

Por dalngadale hëna u ngrit mbi vetullën e malit, kaptoi tumbën e ahere ja se ku nëpër tē çarat e portës lëshoi rreze tē verdha drite. Tashti Gjik Vërria pa çiltazi një ari tē madh që kish shtyrë gurin e lëpinte me gjuhë miellin e mbetur. Partizani ktheu poshtë tytën e pushkës e mendoi ta mbajë arinë më një tē qëlluar, por n'atë çast fryu era, ahet i gelën shteg hënës e ai vuri re se pranë ariut tē madh ishte edhe një i vogël.

Partizanit iu drodh dora. «Jo, jo. Nuk bën ta vras, éshtë mëkatë tē shtiesh mbi gjën e gjallë, kur kérkon ushqim pér pjellën e 'vet».

Po kur arušha u largua djaloshi 'ra' në mendime: Arušhën e malit e kurseva, nuk më bëri zemra ta vras, po gjermanët pérse i vrasim!? Ata janë njerëz, a nuk kanë edhe ata fëmijë? E, megjithatë ne i qëllojmë. Por ndryshimi éshtë i madh, gjermanët erdhën tē paftuar në tokën tonë, erdhën e i vuñë zjarr vendit, po na dje-gin, po na rrënoinjë. Arušha e mjerë nuk nget njeri. Ajo

vjen e shtyn gurin e mullirit të gjejë një dorë miell për këlyshin e saj. Kafshë e egër, por e dhëmshur».

Nëpër terr Gjik Vërria mori vragat e fushës dhe sosi në Seltë. Kaptoi një gardh, hoq një lesë, shtyu një van-dak dhe trokiti ngadale në dritare. Trokit e mendo, trokit e mbaj zemrën me dorë. Pastaj gërviti një derë, fërfelloi një robë, era e dhomës finjë e ftua i ra në fytyrë, dhe ja një hie aty:

— Vita! Jam unë, Vita!

Hekurat e dritares janë të fortë, edhe të ftohtë, janë edhe të dendur, por djaloshi atje e puth me duf vaj-zën tij, e puth me gjithë shpirt, si trimi i përrallave të bukurën e dheut.

— Të dua, Gjikë, edhe unë të dua, s'kam njeri tjetër veç teje e gjyshes, mos mendo keq për mua, por, të keqen, pajtohu me shokët, më vjen turp kur të thërrësim kaçak, shokët të duan, kthehu ndër ta.

— Mos folë ashtu, Vitë, edhe unë i dua shokët, edhe ata më duan, por atje duhet ulur kryet, duhet vënë dora në zemër, dora në zemër dhe mjekra në gjoks, duhet shtritur zverku me sytë përdhë. Por këto unë nuk i bëj dot. Nuk i bëj sepse nuk të vodha ty, unë të dua, ti më do dhe mbaroi.

Partizani sërisht u ngjit në limeret e tia. Ditën e shkon në pyll, natën tatëpjetë fushës. Ndonjëherë takon shokë n'errësirë, u dëgjon edhe zérat, edhe i njeh, por ai hiqet mënjanë. Dëgjon batarë që shkëmbehen, merr me mend ku bëhet luftë, zvarriset anash hendeqeve dhe u del pas shpine trupave t'armikut, zbraz krëhërët e tij gjersa malisherit të nxehur s'i punon llozi. Pastaj përgjon thirrjet dhe parullat, dhe sërisht, me dinamit në torbë e qefin në kokë, bredh urave të xhadesë, kazermave t'armikut, gjithnjë trim i mirë; i bën hesapet hollë, thur gracka më nge.

Dhe burimet e malit ja tregojnë mjekrën gjith e më të dëndur, gjith e më të gjatë.

Te Vita ze merr bukë për ditë të tëra, përtyp fistika ahu e pishe, mbledh luleshtrydhe, qershi e radhiqe.

Ata patën lënë fjalë të takohen të djelën në luadhet e Seltës. Ai kish zbritur atje qysh në mëngjes, por vajza shkoi vonë, afër drekës, me shkak se sillte direkë për shtratin e pjergullës.

Është korrik. Në fushë qershítë janë pjekur me kohë, por këtu në mal gjelbërimi është si në prandverë. Duket sikur sivjet natyra pat kaq shumë lëng të gjelbër, kaq shumë... sa po e derdh edhe në qiell. Kështu i dukej Gjik Vërrisë, se duke pritur e pat marrë gjumi ndënnë lajthishte e degët e rënduara nga kokrrat i qenë unjur mbi fytyrë. E duke iu mbyllur sytë ngadale iu bë n'ëndër sikur bota kish marrë ngjyrë të blerët, sikur hëna ish jeshile edhe ajo, sikur tej e ndanët qiellit ngjyra e barit kish ngjer yjtë dhe retë, pemët dhe arat, ujrat dhe maklet. Dhe nëpër qiellin e errët dhe të gjelbër ngarendëte Vita me leshrat lëshuar mbi supat e bardhë.

— Mos më nga se s'të ka hie! — ngulte këmbë vajza, në vij këtu, vij se të dua përvjetë, të qe për të puthur e ndezur gjakun, nuk vija fare. Të keqen, Gjikë, pajtohu më shokët. U bënë tre muaj që je ndarë syresh!»

Një vetull e Vitës rri më lart mbi ballin e saj të repte. Por trimi hesht dhe mendohet:

— Afroma mëngën të ta qëp, — i thotë ajo, dhe i rrëmbejn krahun e tij të fortë. Ai diç i flet me romuze, por ajo duke kafshuar buzët e saj e shpon me gjëlpërë në mollëzën e dorës. Një bulëzë gjaku mbiu atje. Vita u përkul dhe nisi ta thithë atë gjak.

— Ç'bën kështu?

— Zakon shqiptar, po të pijmë gjak, nuk ndahemi kurrë.

Një mollëkuqe fluturoi mbi krye e shkoi zu vend në gushën e çupës. Atje i unji krahët e saj të ndriçëm e mbi pushin e kuq ai nëmëroi pikëzat e zeza, por mollëkuqja zu zbriste, e djali që desh ta kapë ngjati dorën.

— Mos! u kërcënuar çupa, (vështrimi i saj u errësua.)
Mos!

Sa tē forta ishin duart e trimit, por mē i fortē ish vështrimi i vajzës!

Meqë vonohen nē pyll, ai do t'i gatisë dy vlastarët Vajza vështroi dy minjolla ahu, njëra pranë tjetrës.

— Ja këto, Gjikë, preji këto.

— Jo! Ato janë dysh, kushedi si e kanë punën, shih si u janë përzjerë deg' e fletë, rrënëjë e vlastarë.

Vajza nënëqeshi dhe pështeti kryet mbi gjoksin e djalit. Ai ja mori kokën ndër duar dhe ajo e pushtoi si dredhëza lisin.

Tashti Gjikë Vërria qëllon me sëpatë. Por tek ulet e çohet sopata, duket kurmi i tij prej trimi, forca e tij prej burri. Asaj i lëshojnë sytë xixa e dhëmbët e saj tē bardhë i ndritin si lilëza fildishi.

* * *

Një ditë nē një rrah me shkurre, Gjikë Vërria takoi pojakun e Seltës. Qëndroi nē fjalë me tē, e ky, me dorë nē zemër, duke i kërkuar ndjesë, i thotë:

— Kabull fjalën, o trim i mirë, por amaneti qoftë i mikut, qoftë i hasmit, duhet thënë, se dheu nuk e tret. Më zu Laze Vrata, komandant i Ballit nē pazar e mangarkoi amanetin nē qafë, si gur mulliri. Të dërgon falë me shëndet nga ana e tij dhe e Ballit e tē lutet tē bësh kabull tē zbresësh nē qytet. Para sa tē duhen, grada sa keqejf; sa pér nusen merre, se gjermani tē bëhet kumbarë.

Gjikë Vërria desh t'i kthente fjalë, por pati frikë se do t'i merrte gjuha flagë, i erdh rëndë pér thinjat e plakut e nuk dha përgjigje. Vështroi thellë nga pylli e hoqi pér andej.

Dhe Laze Vrata dorë hoqi, por gojën s'e mbylli. Pa ngrihet e flet ditën e pazarit:

«Ndër partizanët u shthur gardhi, një trim i tyre u bë kaçak, rrëmbeu me dhunë çupën e botës e rron me putanën nē majë tē malit, prisni kur tē lëshojë këlyshë.

Këto fjalë i shkuani nē vesh edhe Gjikës nē majë tē Moravës.

Dhe ja tashti, Gjikë Vërria, partizan i dëgjuar, ai që iku nga shokët mu në mes të ditës zgypte rrugës së madhe të qytetit. Një çudi të tillë nuk e besonte njeri asaj kohë të mjegulluar, kur vrasjet ishin bukë e ditës.

Pa flasin fusharakët posht' e lart: Zbret të dorëzohet te gjermani trimi Gjikë, nuk duroi dot kapedani kaçak; e bëri si gruaja e ligë Gjikë Vërria, nga inati i së vjehrës, shkon me mullixhinë.

Po Gjika s'e ndalte çapin dhe zbriste tatëpjetë, tatëpjetë. Ish po ai djalë shpatullgjerë, nga kurmi i pashok, syrin thëngjill, mustaqen kaleshe e mjekrën një pëllëmbë.

Rruja e gjerë pranë qytetit është pluhur e tym. Vappa mbyt è zalisë. Ai sheh rrugës kalamanë me karpuzë ndër duar, sheh të tjerë me stomna krahut, etja e mundon, por ai as që e ka mendjen atje. Lidh krye e fytyrë me shami si košovar dhe hyn në qytet. Posht' e lart ballistë me opinga, me këpucë, me çizme, me kapella si kërpudha. Laro e dyfek, dyfek e laro. Ai sillet me sytë katër dhe jatku i del përpara Laze Vrata, komandant i Ballit. Po përpara don që ta vrasë. Jo me pusë, as prapa ferrës si burracak, por ballë për ballë si shqipëtar.

Laze Vrata, o Laze Vrata! Kam një përgjigje shqiptarë, berdha të tta sjell dorazi, se amaneti ndodh, që humbet!

Ai e pa dhe dyzoj në mes të sheshit. Pandehu se ishte ndonjë nga ushtarët e tij.

— Leri shakatë, djalë, unj dyfekun se djallit atë punë, kë.

— Lere djallin, o Laze laragani, krizmën e ke nga kaçaku i malit, plumbin përidher të shqipëtarit, prite, ore, prite në lule të ballit! Hajt, të goftë me shëndet!

Shungulloj dheu në mes të qytetit, një goxha burrë u shtri sa gjatë gjerë, gjak i mburoi nga balli, shkumbë nga goja.

Rremujë an' e mb'anë, vërvshëllime bilbilash, rrëshqitje gozhdësh nëpër kalldrëme, nëpër rrugë, nëpër qy-

tet. Ballistë e gjermanë ndjekin një partizan. E ndjekin ta zënë gjall' à vdekur.

Fusha sikur mori zjarr. U hap fjala se u zunë, u hap fjala se u vranë. Thonë se atëhere mali e mbajti frymën, thonë se lumi e ndali rrjedhën, thonë se Vita ulëriti e shkuli flokët, thonë... e çfarë nuk thonë!...

Po ç'ka gjermani që shtie me top e kumbara? Përse u rrabin barqet halldupëve të ballit? Përse çirret prefti në mes të pazarit? Përse?

Një partizan dha luftë në mes të qytetit, bëri dyfek e vrau kë deshi. Pastaj u zhduk. As fishek e zuri, as plumb e móri, as top e vrou.

Thonë, se ka pirë ujë të gjallë!

Po për të ndjekur e ndoqën, këmba-këmbës, tutje xhadësë, nëpër fushë, nëpër ugare e gjer në këmbë të malit. E atje, ndal!

Bataretë ulëritën nga të dy anët. Gjermanë e bëhistë më një anë, partizanë më tjetren. Gjikë Vérria po në mes:

Bjeru t'u biem, lufto të luftojmë, për nder të shqipëtarit, për gaz të Laze Vratës, bjeri, ore, bjeri, me duf të zemrës, me nishan të syrit, qëlllo një e rrëzo dy.

Nga fusha radhët e para u lëkundën, pastaj të dytat, edhe të tretat. Vrapi, vrap. Këmbët te qafa me ik të ikim, me zëri t'i zëmë, t'i zëmë me dorë, t'i zëmë të gjallë e t'u japim dërmën.

Dhe tashti Gjikë Vérria ka qëndruar në mes të luhdhit, në mes shokësh. Kurorët e luleshqerrave i përkëdhen këmbët e tij.

Komandant Mihali nënëqesh e kafshon mustakun me dhëmbë, shokët i urojnë fronin e kumbarit.

Dhe partizani kokëkrisur punon thuprën në grykë të pushkës.

Kapelen mbi sy, buzët shtrënguar, mjekrën një pëllëmbë dhe kokën lart!

Lart, ore, lart! Si trim!

Këngë e rinisë së parë

E çasin kur e sjell nér mënd, kur
sjell nér mënd, ah! atë vënd, as
rroj, as vdes, po jam pa mënd.

LASGUSH PORADECI

Ardhi një kohë në rininë time, kur e ndjeja veten si një dem që e shpon tagjia E megjithse fytyra më ndriste e në të rendur ua kaloja edhe mëzave, prapëse-prapë, nuk dija se pse më dhimbte e më shtërgonte në gjoks.

Mbaj mend mirë se atëherë ish moti kur vranë kralin e sërbit.

— Mirë, o gjysh, — i fola babajt të nënës, — mirë se Aleksandri mbaroi nga plumbat, po ky gjoksi im as me plumb goditur, as me grusht rrahu e as me lule qëlluar.

— Dëgjomë, o xhiger i gjyshit, merre fjalen me ngadalë. Ardhe në moshë, biro, gjaku t'u trash e t'u bë si musht, pa të zjen si i ri që je.

Dhe ma shkrepi syun babaplaku duke vënë buzën në gaz. Këtu unë diç kuptova, por ai nuk mëla me aq. Më hoqi mënjanë dhe më mësoi si ta shëroj të keqen:

— Lavdi zotit, fshati ynë plot çupa është. A nuk të shkau syu pas ndonjë faqekuqeje? Zëre nuse njérën syresh, puthe sa të mundësh, më tej kandis edhe shtëpinë e merre përfare. Bëj si të them unë, sa je i ri, se kjo moshë, as me para blihet, as me punë fitohet as me kokë këmbehet. Se po u bëre sa unë, të këputen verigat dhe shkon zemërdjegur.

Fjalët e tij i dëgjova me sytë përdhe e me ballin të përskuqur si prush.

Rashë të flija asaj nate, por gjumë nuk vura dot në sy-
E ku më qasej gjumi mua kur gjithë çupat e fshatit loz-
nin valle në kokën time.

Por punët që mendova asaj nate m'u dukën fare të
lehta për t'u bërë. Veç të nesërmen, kur dolla në fushe
e hasa atë që i vura synë, e ndjeva se kësi punësh ishin
të lehta, veç me kokën ndënë jorgan.

Këto që tregoj ngjisnin me mua një buzë vjeshte
kur fshati gjëmonte nga zilet e kuajve kur fusha të deh-
te me aromën e ftoit të bryllët, me aromën që lëshon
mjalti tek kullon nga zgjojet, që i përcëllon dielli. Koha
ngiste mbarë, qielli ish i paqmë dhe i larë me vesë të
hollë, ish më i kaltër se deti, më i bukur se ëndërat
mia, e më dukej atëhere se ishte më i madh se tashti. As
era s'e ngiste qielin, as nigji i vapës nuk e vuloste me
rrudha, pa zogjtë nuk kishin të ngopur me begatinë që i
fali vera ugurmbarë.

Dhe ne djemëria gjithë ditën e ditës, rendnim poshtë
e lart: ha rrush e këput veshulë, mblidh gorica e
manaferra. Vërtet se rrushi t'i ngjiste buzët, megjithë
se manat ishin tërë lëng e të velnin, por ky uji i Kroit
(ujë mal) edhe haliça të haje, t'i treste shpejt e shpejt
Shto pastaj të bredhurat, shto mundin dhe zemrën që
na brofte or e çast e... po deshe thuaj se kishim të
nginjur.

Vajza që i vura synë asokohe nuk ishte moshatare
më mua. I kisha unë nja dy vjet më shumë, por ajo ish-
te kurm e derdhur e mollzat e faqeve i ndisnin si cipa
qershisë kur lodron me rrezet e mëngjesit. Gushën
kish të bardhë si shkumbë, por jo gjithnjë, se sa vinte
pranvera e përcëllonte dielli dhe bëhej një zeshkane
kaleshe me sy të hequr si bajame. Hundën e kish pak
te ngritur dhe kur bënte çapet i kish të shkurtër po të
shpejtë. Në fshat e hiqnin si çapkëne, se punonte njësh e
njësh me djemërinë. Delte pllajave me dëllinja e ku-
lloste shqerrat si t'ishte djalë. Dhe gjith si djalë i hipte
mushkës dhe u vërvhellonte mëzave me dy gishtat në go-

jë. Po mushkën kurrë s'ë lëshonte nga kapistrat se në kishte xanxare dhe po të merrte fushat s'e shqiptje dët në dorë. Lira e kishte emërin vashëza ime. Rendte gjithnjë kodrave, shtrilej e rrrokullisej, mbi barë tërfilë, dhe kur ngrinte këngën, më dukej sikur heshtnin bilbilat. Zërin e kish vërtët të fortë, por kënga e saj kumbonte ëmbël sikur gumëzhinin ujrat e penguara të pendës, sikur kërkëllinin zajet n'ujë, e dalemëngadale, tek i shuhej zëri, më bëhej sikur akoma binte një glyrë e hollë e hollë.

— Si u bë kështu kjo kallogre! — thoshnin në fshat, — c'është gjithë kjo zhurmë që sjell ngado që vete? Dikush ja ngriti këngën, por ajo e hidhte perçen la e më la:

«Mike me shami më nj' anë
Mos nxito se dogje fshanë
— C'i bëra fshatit të shkretë
Sepse shkoj posht e përpjetë
Xhinde mushka, xhinde vetë.»

* * *

Fillova të bridhja fushës me një mollë të kuqe në xhep. Se kështu më pat mësuar gjyshi: «Qëlloje me mollë në kokë ose rrëmbeji shaminë e bardhë.»

Kaq herë e takova Lirën mb'udhë, kaq herë shter-
ngova mollën në pëllëmbët por, që ta nxirrja nga xhepi... ish më e rëndë se një shinik urof. Sa për shaminë
ish punë që s'bëhej. Se, si ju thashë, ish një xhinde ajo.
Andaj si e rraha mendjen mbarë e prapë, e gjeta udhën e mbrodhtë:

Iku koha e pleqve; tashti s'pi më ujë as molla e as shamia. Në je burrë ec i thuaj si e qysh. Jo po s'je, mbaj gjoksin me dorë e veri gojës një koçan misri.

Dikush më tha: «Gjej një tërfil me katër fletë, hidhja në flokë çupës që do, se të ndjek ajo vetë.» Çava dherin nija tri ditë me radhë e t'i bëra luadhet patoz. Pun e kotë. Tërfil me katër fletë nuk gjëta e nuk gjeta gjëkundi.

Mendoja: Vështirë e kam sa t'i jap të kuptojë që e

dua, sepse edhe ajo prej gjaku 'është. A thua nuk shtërngojnë gjiret edhe asaj! A s'm'i ka si ftonjt e Ten Vanos?

Isha te rrema e madhe një pasdite. Përreth shelgjet e kulp, kumbulla e plepa. Dukej si mbrëmje, si të kish rënë muzgu. Rosat gjuanin cironj e silleshin ndër ujrat. Po një djall rosaku s'i linte rehat rosat e ta bëri rrjetdhën shkumbë e stërkale. Ja atëhere më kalon Lira aty.

— E mo kapedan i Maçit, — më foli, — si të duken rosat, a zënë cironj?

— Ah, moj Lirë, po ku i le rosaku rehat... sa mirë tē isha edhe vetë rosak...

Nga kjo e folur me romuz, vajza u bë tufan e veri M'u qas pranë e si tē isha ulur në ledh, ajo m'i kap flokët me pëllëmbë e m'i tërhoqi.

— Qënke djall me brirë ti!

— Lermë, o Lirë, lermë, tē thom, se kam një tē keq në kokë.

— Çfarë ke, more vëlla?

— Ja, më çan e më dhemb në gjoks.

— Po ç'të ka gjoksi, mor hamshor i Maçit?

— Pse, ty s'të dhemb gjoksi a?

Atëhere ajo m'i lëmoi flokët, mbylli buzët e ik duke tundur kryet.

E ja që aty te lumi ja ngrita kurthini. Zura i rrjaja hum dë e buzë, nuk i flisja me gojë, nuk e shihja në sy. F si më përpëlitez zemra kur e takoja, si më dridhej gj ha, si më mbahej fryma!

Po atë ditë ngjau në fshat një ndodhi që më dorë mua. E solli çargu që prifti i ynë i ardhur, shkel li kryqin e zotit. Ai ditë përditë e këndonte tropari «O Zot, o Zot, mos na shtjerë në ngasje por shpëtor nga i ligu.» Po çfaj kishte Papajani i ngratë? Fshati mbante si jo më mirë. Ç'jepte fusha jonë, majën e mi llit, lëngun e vreshtave, ujin e krojeve, ai i bekonte ai gëzonte. Po t'i qe bërë zverku si i mëzatit dhe i flakëro te nëpër qimet e zeza.

Kish ndodhur në nunosje:

«Jam në mes të detit, uratë, rashë në ngasje të qof-tëlargut.»

Kështu i qe rrëfyer një nuse e re me burrin në kurbet. E Papajani, si e pa të kolme i qe përgjigjur pa frikë. Them pa frikë se nunosja bëhej me petafijo mbi kokët.

— Në je në mes të detit, o e krishterë, duhet dalë matanë me doemos, se ndryshe të pret kazani me pisë, e pér të dalë... si hyri ashtu dilet!

Në vend të përgjigjes nusja nënëqeshi me dy gropëza në faqet.

Por më shumë unë nuk tregoj se marrin vesh atij Devolli e më nxjerrin tradhëtar që vura berihaj.

Në fund të sherrit erdhi në fshat dhëspoti, dëboi Papajanin që i pat shitur shpirtin satanajt e dha fjalë të shkoj unë të nxë pér prift.

Unë, ore unë, dora, vetë!

Babaj dhe hirësia e lidhën fjalën e s'mbet veç të vi-ja dorën edhe vetë. E më mirë të shkoja, do ikja nga fshati, do shihja botën, po çfarë t'i bëja gjoksit që më çante? Po fjalë nuk nxora prej goje, se më punonte mendja poshtë e përpjetë. Dhe ja, takoj Lirën te lëmi lart. Unë me inat, ajo pak m'e zbutur:

— Do shkosh pér prift, o Tili?

— Pse, këtu do rri, a? Do bëhem prift e dhespot, njerëzia do më bien në gjunjë e do më puthin dorë, të martuarve do t'u vë kurorë, po deshe të ve edhe ty...

— Si duket më s'të dhemb gjoksi tashti.

Kaq më tha ajo e më vështroi me pikëllim. Po ç'të vështruari se!

Eh, si m'u drodh zemra atëhere. E jo prift të më bë-nin, jo dhespot, por edhe skeptrin e patriarkut të më falnin, do ta flakja tutje.

I vajta një ditë Lirës tek lumi. Pranë kish një kanistër me rroba që i lante mbi gurin e madh, më tej një kopan që i rrihte. E tek ulej e ngrivej ajo, vura re se bluza i shkiste pas njërit sup. Veç njëri sup i xhvishej asaj e fare pak, por unë me mendje ja xhvishja krejt.

Kjo ma ndezi gjakun dhe gjaku i ndezur më dha zemër.

S'e bëra të gjatë po iu qasa dhe i thashë si e qysh.

— Unë për ty s'u bëra dhespot, unë pas teje kam humbur mendjen, ja të marr për fare, ja s'e dua jetën!

Por asaj jo më kotoj i thoshnin «xhinde».

— E sheh këtë kopanin? — më tha.

Më shkuan të ngjethura në trup.

Bo, bo, i ziu unë, kú të mbytem tashti, më gënjevë e më more më qafë! Ti qënke fare zemërgur, o Lirë, mirë thonë: ti s'e ke për gjë të djegësh gjithë fshatin.

E me t'ja thënë këto fjalë, asaj i qeshi nuri dhe lëshoi kopanin përtokë. Nxori këmbët nga lumi (me gjithë pulpët e bardha) dhe m'u qas:

— Desha të të provoj, — më tha, — mirë se ti më do, po shtëpia jote?

— E kush pyet për shtëpinë? Dashkan s'dashkan ata, unë të marr nuse ty, po deshe shkojmë bashkë në kurbet, në Limboz, në Sheher në Allasonjë, unë për ty vete edhe gjer në Moll e Kuqe. Po ti je çupë e mirë shtëpia do të të duan.

— Ke dhënë fjalën gjetiu?

— Jo.

— Si shumë sillesh nga lagjeja poshtë, unë të kam ruajtur.

— Nuk të gënjej.

— Po mori vesh njeri, jemi të prishur.

(Domethënë se qenkeshin të ndrecurr.)

Ajo m'u afrua, më vështroi në bebet, pastaj në maja jén e hundës, sikur aty do më delnin gënjeshtrat. Fryma e saj më përkiti faqet, zjarri i syve desh më përvëloj. Më arrdhë ta pushtoja ndë krahpë, po kisha frikë më shumë nga kopari aty poshtë se nga syt e botës anë e mb'anë.

— Shiko, hap sytë, se mua më luten edhe gjetkë.

Më kapi në mjekër, ma ngjeshi me bryl n'ije e u fut sërisht n'ujë si një patë e bardhë.

Kjo ishte fitorja ime e parë. Po kush kënaqet aq sa i japid? Tashti sa herë isha i ngeshëm, dëri shkodra përpara portës. Aja më buzëqeshtë e ma tundte.

dorën, dhe vetëm kaq. Po unë kisha bërë be, që ta gje-ja një herë vetëm e si mënjanë, pa kusurin e dija.

Kur zbrita njëherë tatëpjetë e pashë në prag të portës. Para saj ishte Numi, vërsniku im. Mbi krye dardha e madhe u mbante hie. Edhe Numit diç i kish rënë era ndaj, kur u qasa unë, atij iu flakërua balli. M'u bë atëhere sikur në tavan të kokës më rrihte një çekan. Pa vara buzët, i lëshova vetullat e bëra të ik pa folur. Por Numi sikur desh ta ëmbëlsojë punën. Ngriti kryet si i zënë në faj dhe ma pat.

— E shikon, o Tili, ja edhe dardha u arrit!

— Ashtu ore, posa, prandaj çalltis ariu të hajë dardhën e botës.

Kaq fola dhe ika tëposhtë i zemëruar. U bëra pikë e vrer.

Të nesërmët kthehesha nga mali më një sërë shokë. Përpara nesh ecnin kuajt të ngarkuar me dru. Trokthi i tyre qëllonte nxituar mbi rrugën e bütë. Mbi samarët xixëllonin tehet e sopaçave. Më hahej bukë sa unë e dija. S'lashë krua pa pirë, s'lashë fletë pa përtypur, po përsëri më hahej bukë. Dikush nga shokët e ngriti zërin.

Ai Numi, lugati vetë është, grurë e ka me t'anë e Lirës!

Mua sikur m'u dogjën ijet, goja m'u tha e bukë nuk më hahej më.

— Thonë se Shëmitrit shkëmbejnë nishanën.

Këto shtiza ishin për mua, por unë bëja sikur nuk dëgjoja dhe u thërrisja kuajve:

— Çil Çil! Dooo! Dooo!

Sa mbrijta në oborr shkarkova kalin. Isha i lodhur fort. Më shumë i dërmuar. Nëna më doli me palarë në dorë. Ay kish lakin të pjekur në çerep.

— Ha, bë, se është i butë, ta bëra me arra.

Ja rrëmbeva nga duart pàlarenë dhe e flaka mbi furtë. Po vrulli i hedhjes na qënkështë i madhi, ndaj lakin doli nga pàlareja, u vërtit n'erë si disk e ra mbi pullazin e hajatit. Nëna u kthye nga lindja e bëri kryq.

Unë e ndjeva që e pata shkelur po isha me inat dhe nuk unjesha dot. U mblodhën kalamanët të shohin lakinorin mbi pullaz.

— Ç'bën kështu? Ishte ky një zë i shkëjur që më solli ndër vete. Kur e pashë në sy, m'u drodh buza gati për vaj.

— Ti... ti...

— E preva fjalën, se lotët m'u kopstisën në mjekër.

Po Lirës i punoi mendja si ujë i gjallë, ndaj më lëshoi në dorë një dardhë të madhe e më foli ngadalë:

— Pasdite dil nga fusha.

Kaq desha unë, Te pragu i portës, nënës i qeshi nuri.

Rrëmbeva shkallën dhe renda të marr lakinorin mbi pullaz. Po kur u ngjita aty, ç'të shoh?

Rreth tij me putrat ngritur në «qëndrim luftarak» ishin mbledhur gjithë maçokët e lagjës.

— U bëftë mirë, vëllaçko...

Dhe fytyra më ndriste nga gazi.

* * *

Kur e pashë që doli nga arat, s'di sepse nisen gjunjët të më dridhen. Kish veshur fustanin e ri, i rrinte pak i ngushtë, po kështu më pëlqente më shumë. Pa nisi mendja të më punojë nëpër vraga të pashkelura ndonjëherë. Ajo me bucëlë ndër duar u nis të mbushë ujë rië kruan e madh të fushës, disa çape më poshtë. Unë renda para saj se desha ta gjej vetë, mbasi, sikurse ju thashë, më punonte mendja poshtë e përpjetë. Arrijta te kroi kur edhe ajo s'kishte mbrritur. Po atje ndodhej plaku Mitrush që lidhte legëtyra, andaj m'u desh të fshihem në trandafilat e egër, kundrejt kroit, matanë lut. U kuspullosa në ferrat e qëndrova si hajduti që pret qengjat. Lira u qas me bucëlen në krah. I përkundej gërshteti bashkë me dy vëthët si dy sumbulla ari në bulat e buta. E sa herë gjuri i nrihte tehun e fustanit, aq herë i hidheshin gjinjët. Vjetët e rinisë i kishin dhënë

një bukuri që ishte nuri vetë i mbuluar me një vello trëndafili. Lira me duar të kryqëzuara mbi gjoks rrinte te lugji (1) si një nuselalë që rri pezull shelgjeve mbi lumë.

Ujët në krua, vinte sulme sulme, sikur ankohej për shtratin e tij të ngushtë, vinte me buçitje të ndrydhura, që më dukej se u ngjisnin tingujve të zemrës sime. Qershia mbi krua pat rrëmbyer ngjyrën e agimit përfletët e saja. Dhe sa dielli zu të fshihej prapa kumbullave, llokaçët te postafi nisën të ngjyhen me të kuq. Po s'ishte një kuqërim i përflikur, ishte një i kuq më i butë, që të kujton ja pushin e gërqinjës, ja cipën e pjeshkës, ja më mirë faqet e Lirës sime. Po ne kroi ç'u bë ashtu? Ç'janë gjithë ato fletë trandafili t'egër q'u përzjejnë me ujrat?

— Mbarove, moj bijë? — e pyeti vajzën plaku.

Më iku, mendova unë. Por asaj i la vragë bukuria përreth, ndaj e zbrazi bucelen në thekërishten e plakut.

— Sa bukur këtu, babagjysh!

— Ku moj bijë?

— Po ja, ujrat, ngjyrat, kroi, qielli!

Ashtu, bijë, ashtu. Dhe plakut i shkoi një pshëritimë.

Bëra njëherë të dal nga ferrat, por m'u duk se bashke me mua do më delte edhe zemra nga gjoksi. Së fundi vajza u nis për në fushë. Nër arat, kapicat e misrit ishin rritur si të qenë lisnikët e prillit. Nxitonin njerëzia te mbartnin gjithë atë bereqet se, sikurse ju thashë, pat qënë mot i mbarë e u shtua buka një kalli një killë misër. Pa, doemos, kur të vinte nata, do qëndronin njërez nëpër fushë, se këputeshin bagëtia nér kupalet e bënin dëm.

— Selishtën tonë e patëm afër Lirës e nj'aty më zuveshi zërin e gjyshit të saj që i foli mbesës:

Ti Lira do flesh sonte këtu në fushë, se unë umplaka dhe gjaku m'u hollua, po mardh e s'duroj dot. Pranë ke zonjën Krisë e pështetu pas saj.

1) Lugj = një farë postafi në grykë të rrjedhës, shurëpuq.

Se kështu pat vendosur edhe nëna ime: të flerë ndarë. Po me zor e kandisa mëmën, mezi ja mbusha mendjen «se i qe holluar gjaku edhe asaj.»

* * *

Thonë se dielli, me t'u qasur afër perëndimit, nxjerton rendjen e tij vigane e varet poshtë shpejt e shpejt, Kështu thonë e kështu mund të jetë, po asaj mbrëmjeje ky lëmshi i madh e i zjarrtë na pat marrë inat e s'desh të tundej vendit. Përpoqa këmbët unë e psherëtita, brodha poshtë e përpjetë e kafshova gishtat me dhëmbë... kot që kot. Rraha kokën me misërishte, vura mbi buzë mustaqe prej misri, çaplova degë kumbullash, bëra kunguj fenera, shkula kopane fshesash nga toka... mos a mos..., dielli nuk tundej fare. Atëhere rashë më gjunjë e u luta në zot e në shenjtorë. Thirra në ndihmë erën dhe shpresën... bosh që bosh!

— Një vidér! Një vidér, — thirrën tatëpjetë ormanit. Një vidér me lëkurë të ndriçme, një vidér me lëkurë si kunadhe! O burra ta zemë!

Po ç'më bëhej vidra mua kur dielli s'desh të perën- dojë?

Por, pa dale... ç'është ajo si mjergull, si katallan me shtizë në dorë, që bashkë me retë po ngarend nga perëndimi! Po pas saj. Ç'janë vallë gjithë ato si ushtëri! Ç'i kan gjithë ato armë, mburoja, shigjeta, topuza, ushta e trumbeta! Ha! ha! Rendin në ndihmë time. Ja, ja, si krishi lufta me diellin zemërak, ja, ja, si po e shtyjnë tatëpjetë si ortek. Pa nisi qielli dhe u skuq, pa nisen retë e u bënë zjarr, pa nisi fullimi t'ushtojë në qiell. Dhe gjithë ata luftëtarë e perëndi (për hatrin tim) u ngjyen me gjak. Re të tjera u nisen të ngjiten në perëndim dhe dielli u mbulua me tym të murmë, sikur tundi kryet disa herë, sikur m'u kanos mua dhë do kthehej shpejt.

Dhe së fundi ra natë. Taçhti jemi shtritur me Lirën mbi kupalen e misrit. Ndonjë kallëp na shpon në shpinë. Sytë na vështrojnë qiellin e paanë. Vjen era me xhufkë!

të misri të thatë, po sa fryn, filladi bashkohet me aromat e fushës që të dehin, po kurrë s'të velin.

— Unë, Lirë, të dua ty e ti për mua je e shenjtë, po...

— Po zure në gojë Numin të zemërohem.

— A më do mua?

— Ndryshe nuk vija këtu. Prandaj mos ki frikë, ki besim tek unë, se Lira nuk kthen fjalën prapë.

— Florin' e ballit druajmë mos e humbim, se mangërin s'e ngjet njeri.

— Sa i madh është qielli! Bo, bo, sa i madh.

— Sikur perëndia ka ndehur tej e ndanë ujë çergë mavi e pastaj mbi të i është derdhur shiniku me misër.

— A vemi dot në yjet?

— Po çfarë të bëjmë atje?

— Të zihemi dorë për dorë e të rendim nëpër qiell.

— Po atje s'ka rrugë.

— Këcejmë yll më yll.

Deshalbe them: Ç'më duhen mua yjet e largët, kur sytë e tu ndritin këtu pranë më shumë se ata?

Pastaj heshtje. Reshpërojnë zogjtë në bárëra, ungu-rojnë qentë larg në fshat. Më tej zjärre n'errësirë, fytyra të skuqura duken pas flagëve, prushi i zjarreve skuq si thëngjij kamine. Më vjen një déshirë e marrë, gati e egër. Dua të puth Lirën, ta puth fort e me ngulim. Pë nuk kuxoj dot, e pse nuk kuxoj as unë nuk e di.

— Ja ja në kupëzën e qiellit tej e n'danë një napë ngjyrë hiri.

— S'është napë ajo, është Kashta e Kumtërit, është xhade e gjerë, mbi të kalon Shëndëlli me karrocën e hekurt.

— Me kuaj?

— Po, me kuaj prej zjarri, nga syt u dalin vetëtimë nga hundët shfryjnë rrufenë, kështu tregon im gjysh.

Larg tringëllin një zile, në rrugën e fshatit humbi krikëllima e një qerri, një mëz hingëllin pas lumit.

— A do një mollë?

— Jo, jo, më vjen e ngjethur kur kafshoj në mollë.

— Mua kur presin xham.

— Mua kur griset pëlhirë.

— Ta gris shaminë? (S'di nga e kuptova këtu që sytë e saja qeshin.)

— Jo, jo, mos e nga shaminë, por... bluza e gjoksit të është tendosur aq fort sa do të griset prej vetiu.

Këto sikur i tha një zë tjetër, por ajo mua më qëlloi me gjisht në kokë. Më qëlloi me mollzën e gishtit, butë, sikur desh të më përkëdhelë. Po ja që tani m'u bë sikur e shihja nga lart. E pse, fill që këtu m'u duk se krenaria e saj zbriti gjer në gjunjët e mij?

— Po sikur të griset, a don ti ta dëgjosh?

Kështu desha unë të thoshte vajza por ajo nuk u përgjegj. Veç syt e saja xixëllonin n'errësirë. S'di ç'm'u kujtua atëhere dhe nisa të këndoja.

«Kam dy fjalë për të thënë
Ke dy shegë për të ngrënë ...»

— Kujt ja këndon atë?

— E këndoja për mall.

— A i nëmërojmë yjet?

— Ti nga mesi anën e jugut, unë anën tjetër.

Dhamë e dhamë por na u mbushën sytë me xixa. Dhe xixat e syve tanë u përshkënditën nëpër qiell. Pa nisi mendja të më punojë nëpër vraga ku kundërmon trendelina e manushaqeja, nëpër vraga ku të zihet fryma, ku të priten gjunjët, ku qellza të mbushet me avull të valë.

Dhe mendjen e kam ujem.

— A të dhemb gjoksi tashti?

— Diku më dhemb, po ty? Pa dale, pa dale, ç'ndodh ashtu nga ana e lindjes?

Ndofta natyrës së përgjumur iu drodh poçi me lëng t'artë.

Po del hëna.

Mos vallë yjtë kulluan ngjyrën e tyre dhe ngjyren me varak bashin e qellit?

Dalemengadale hëna nxori vetullën e saj të zjarrtë që nga tehu i malit. La poshtë lajthishtat e bregut, ndezi si me zjarr dy tri re të vogla që i prenë udhën; nē fillim sikur desh t'i shkrijë, po, si duket, ndroi mendje dhe i la pas, dhe ja tashti e shoh hënën edhe nē sytë edhe nē buzët e njoma të vashës sime. Dhe hëna vulosi nē flokët e buta të Lirës një fashë drite, ashtu sikurse bën fshehur natën me ujrat nē lugjet e krojeve ku mbli-dhet të Bardhat e lajnë leshrat e gjata. E prandaj rri e çuditem unë: me se m'i ka flokët vajza ime! A ka vaj ngjyrë ari, a ka vaj ngjyrë hëne?

Dhe unë ndjek gjithnjë sytë e saja, gjithnjë, or e çast, sikur ato të jenë diell dhe unë luliedielli. Bëj kësh-tu, sepse sytë e saja ruajnë duart e mia.

— Shiko, po afrohen hie, mos vijnë na gjejnë të dy-ve vetëm kushedi se ç'thonë.

— A zbresim nga lumi?

— Andej më vjen si frikë.

— Eja se kapemi dorë për dorë.

Më zgjati dorën dhe unë i zura pëllëmbën. I digjej si zjarr.

Zbritém nga rema e madhe. Atje lumi është i pen-guar nga grezhde të larta me kunjë lisi, që e këthejnë rrjedhën nga jazi i mullirit. Po ujra vijnë shumë, e si pengohen, dremitin e flejnë nē një pellg të madh që i ngjet një liqeni të vogël. Për anash rritur mbi tokë tul ngrihet shelgu i madh me katër biga. Degët i varen gjer nē cipën e rrjedhës e fletët e tia si të përhime zbardhin mbi lumë. E duket sikur shelgu plak ka zhytur degët n'uji, ka zënë gjithë cirojtë e bardhë e i mban pezull n'erë.

Po çfarë duket kështu? Hëna s'i kalon dot fletët e dendura të shelgut. Dhe mbi ne po zgjaten ca shtiza të holla si fije xixash të verdha.

Lira më shtérngon dorën fort.

— Ç'janë ato?... ato?

Gllup, gllup, zhurmoi nga lumi.

Fësht... fësht... reshpëroi nga plepat.

Vuuu... vuuu... uturoi nga terri i drizave.

— Mbaise dikush del nga pellgu.

— Qenka koha kur shtojzavallet (1) e natës dalin nëpër fushë. Dalin e mbledhin nj'ato si fije të holla që dërdhen prej hënës nëpër fletë e shelgut. Po ato nuk janë rreze, po janë fije klapodani (2). I mbledhin ndërsa sepetat argjentë dhi endin fustanë, se shkojnë në dasmë: martohet bukuroshja e dheut me të bir e mbret! ..

Unë qeshë ulur në gjunjë, ajo ish kërrusur mbi mia e mbanin vesh. Ndjeja mbi shpatulla gjoksin e saj, që m'u dha zjarr supave.

Gërr... gërr..., krikëlliu një minjollë.

Ne rendëm te shelgu plak. Unë s'kisha frikë fare, po is'di se pse ajo u tremb e u struk pas meje. Dhe ashtu mabetëm.

Tashti buzët e saja ishin si dy thelëza portokalli të shartuar në shegë. Faqet e saja ishin të lëmuara e të ndriçme, por sytë s'ja shihja dot, se nga zjarrmia i pat myyllur thuajse fare.

Po unë s'kisha putur gushë prej vashe, s'kisha përkitur llërë të plota, as supa të mbushur, ndaj më dukej se isha në ëndër.

1) Shtojzovalle = vajza të bukura të mitologjisë.

2) Klapodan = fije mëndafshi ngijer me ar.

Ballë për ballë me errësirën

Luftës që shkoi edhe unë dolla partizan.

Isha djal' i ri atëhere e m'u mbush mendja se ish më mirë të ikja maleve me shokë se sa të qëndroja në qytet. Ushterinë e huaj që sillesh rrugëve tonë nuk e shihja dot përpara. Kështu që shkula shenjën e liceistikt nga kapella dhe u nisa përpjetë.

Por sa mbrijta në komandën partizane të qarkut, m'u duk se mundësitetë me dëshirat e mia ishin larg e larg.

Kisha ftyrë të hequr e shëndet të lig, në sy gjyslykë e fanellë leshi për mishi. Të gjitha këto më tregonin ligosh e thatim. Pushkë nuk kisha zënë me dorë, këmbëzë s'kisha tërhequr kurrë, kështu që, dashur pa dashur, më dërguan mësonjës në katundin e largët e malor të Panjasit.

Gjithë kohën sa vijoi lufta, unë qëndrova aty. Pata një përvojë t'ashpër e të rëndë. Ishte rasti i parë që njoha gjendjen e mjeruar të kësaj krahine shqiptare. Ndesha atje prapambetje dhe errësirë, zakone t'egra dhe...

Por më mirë le të filloj me mbresat e mia aq sa mund t'i kujtoj pas kaq vjetësh.

* * *

Arrita në Panjas një mbrëmëherë. Përpara kisha një fshat të çakërdisur në këmbë të malit me një copë fu-shëzë përpara. Toka përeth ishte zallishtë dhe anash mezhdave e përmbi fshat po fluturonin fletët e fundit të pemëve. Një lumë i vogël kalonte nëpër katund e përmbi të një urë e ngushtë e stisur me lesa, lidhëtë të dy

lagjet. Dy çuna po kullosnin lopët në një farë meraje dhe ata më hoqën rrugën për te kryetari i këshillit. Qën-druam para një mulliri.

— Ja, këtu e ke, kanë prerë ujën e jazit e po zenë peshk ndënë pendën e mullirit.

— Ago Asllan, o Ago Asllan! Të kërkon një i huaj!

Dikush zgjati kryet që poshtë nga gryka e pendës e vështroi jo mua, por llokaçen e ujit ku pasqyrohej fytyra e ime. Një krap i vogël i shkau nga dora, fërgëlloi n'erë dhe hieja ime u lëkund e u ngatërrua nëpër stërkalet e ujit.

— Ja, ja, po vij!

Muret e mullirit ishin të ngarkuar me tufa myshku të gjeblër e të lagësht e prej tyre rridhnin pikëla uji. Një plak kockëmadh u ngjit drejt meje duke fshirë duart pas gjunjëve, mbi krahë kishte një farë gune e megjithëse supat i kishte të kërrusur, nuk ishte gjendur një tallagane për masën e tij.

— Eja bazë tek unë, — më tha, — më quajnë Ago Asllan dhe Xhaxha, por ti thirrmë si, të të vijë mbarë.

U nisëm nëpër një monopat të ngushtë. Fshati du-kesh i zymtë dhe i shpérndarë, kupat e plehut na prisin rrugën, larg nga ura e drunjtë po kërruseshin njerëz mbi rrjedhën dhe mbushnin stomnat me ujë. Kudo baltë e vallto, shtëpi të shtrembëta, dritare të ngushta. U ngjitet nisëm nëpër një palë shkallë guri e Xhaxhaj rrahu «përlëmbën mbi një kollonë druri me lio (1), si për të dhë në shënë në shtëpi. U futmë në një odë të madhe pa tavani, me trarë të nxirë nga tymi e të ngarkuar me vandak misërishte.

— Domethënë erdhe, shoku «mësues», ja filloi plaku. Na patën thënë prej kohe për këtë punë dhe kemi bërë derman. Në këtë odë do kesh jatakun.

— Është e mira t'i hedhim një sy shkollës.

— Vemë, posa, s'është ndonjë godinë e madhe, po punë mbaron. Ka qënë dyqan i Xhelos Tapisë. Xhelos

1) Trung me lio = trung jo me qoshe.

mori kok erë dhe u bë ballist, ka dy muaj që kur thieu qafën prej fshatit.

Kish rënë nata. Yjet qenë kumbisur në qiell e plepat e gjatë po faleshin mbi fshat, fryu një erë dhe kundërmuan bërsitë e kumbullave. Po kalonim pas jazit, kur shoh diçkë të çuditëshme:

Një tufë urësh të ndezur lëviznin si me magji nëpër errësirë.

— C'janë këto, shoku kryetar?

— Mos ki droje, ma ktheu ai, s'është gjë.

Qëndrova në vend dhe ngula sytë mirë. Ndënë një urë të ndezur, që akoma nxirrte flagë shquajta një kokë gruaje me një gërshetë hedhur mbi tullgë, pas qafës një shami ngjyrë uthulli. Secila urë mbahej nga një dorë neriu. Pastaj hiet u saraviten në të dy anët e jazit. Një këne lehu përtej. Më shkoi mendja në magjistarë, kur u dëgjuua një zë:

— Hunj! Hunj!

Një tjetër ja ktheu:

— C'bën ashtu?

— Hedh kukunj!

— Leri andej, eja këtej!

— Hunj! Hunj, hedh kukunj!

Hiet u mblohdhën pas jazit, diç pëershëritnin, dikujt i shkau këmba në ujë.

— Mos u fol — më tha ngadale xha Asllani, — nuk bën, turpërohen gratë.

— Turpërohen se janë dembele, kanë ujë ne porta e nuk pastrojnë, nuk lajnë.

— Jo more përlarjen, për atë nuk bëhet merak njeri, u vjen turp që i shohim ne si burra, ato gra...

DITA E PARË E SHKOLLES

Të nesëremn e mbërritjes sime, ish dyqani i Panjasit u mbush me fëmijë. Nuk kisha as banka e as frona, pa u thashë nxënësve të ulen këmbëkryq mbi dysheme.

Për dërrasa të zeza mora në fshat tre copë astagaçë dhenjë grusht thëngjij vatre. Midis tyre nuk kishte astiqë femër, të gjithë ishin këmbëzbathur, me hajmali në qafët, thatanikë; të pakrehur e të palarë, disave u kishin llangosur dregat me mellan mavi. Njëri mbante një vëth tunxhi në vesh, një tjetër ka një plaqë të thellë në mje-kër, por ajo që më habiti më shumë ish koka e lidhur e një çunaku. Kur iu afrova vura re se ndënë një farë pa-çauje që ja kishin shtrënguar, mbi krye kish copa ço-çaniku prej arre.

— Përse i ke këto? e pyeta.

— Për të vrarë morrat, zoti mësues!

Hodha sytë nga dritarja e rashë në mendime:

«Pra, këta janë pjesëtarë të brezit të ri shqiptar! Dotë na duhet që këtyre fëmijëve gjysëm t'egër t'i shkulim padjen nga mendja, t'u shkulim prazhdat dhe thiskat nga xhepat, t'u shkulim hajmalitë nga gjoksi.

Shekuj t'errët lufte e pushtimi kanë kaluar këtyre anëve, kaluan romakët, bizantët, skllavët, turqit, grekët, italianët, por edhe shqiptarë e djaj me brirë, por asnjeri nuk çeli një shkollë këtyre anëve. Këtej kanë rrëmbyer taksa, kanë mbledhur ushtarë, kanë rrëmbyer fëmijë për jeniçerë, me dhunë kanë marrë vajza për në hareme, kanë rrëmbyer kafshë samari e mishë, por për këtë popul askush nuk u kujtua se jeton n'errësirën e padiges.

Shkrova mbi astagaç gërmën «A» dhe fillova nga mësimi

Nuk kaluan as dhjetë ditë, kur një ditë më vjen xha Asllani në shkollë. Nuk trokiti e as pyeti në isha aty, po hyri drejt e brënda. Dukej i nxehur dhe gjithë inat.

— Lexoni këto, — më tha, — këto!

Nër duar mbante dy zarfe të mbyllur. Ja mora dhei i çela

— Janë letra nga Xhelio Tapia, i thashë.

— Xhelio Tapia s'di të shkruajë, po do t'ja ketë gatitur ndonjë tjetër, pa shiko, shiko, ç'thotë.

«Më tetëmbëdhjetë të Tetorit 1943. zotit Asllaň Lajthia i marr dorën dhei i bëj shumë të falë dhei i lutëm shu-

më të mbledhë fiqirë e të vijë në rrugë të mbarë. Se me ti, o xha Asllan, kemi qënë miq e kështu dua të jemi gjithnjë. Hiq dorë nga komunizma dhe kthehu me forcat nacionaliste të Ballit Kombëtar; të njohim për komandar e të presim një rrögë në krye të çdo muaji. Pres përgjigje sa më parë; brenda pesë ditëve ke kohë të mendohesh, në mos ardhët përgjigja, daç me kartë e daç me gojë, i kemi punët të prishura përgjithnjë... I yti me ndër...»

Mora letrën tjetër. Ajo ishte për mua. E nistë me sharje e kërcënime. Kërkonë të mbyll shkollën e t'i dërgoj kyçin gjer në qytet. Në fund më kanosej: «Nëqoftëse vazhdon të përdoret dyqani im pa lejën time, ke të bësh me mua dhe do ta paguash shtrenjtë!

Xha Asllani dëgjoi pa folur leximin e dy letrave, pastaj, në sy të fëmijëve, këputi një të sharë që nuk shkruhet në kartë dhe dolli përjashta duke mallëkuar.

VÂTE AJO KOHË, PERËNDOI!

Druhesha të hyja në shtëpi më çdo kohë, druhesha mos takoja gratë në çardhak, prandaj sa afrohesha ne porta e oborrit hetoja nga larg e i lija kohë qenit të lehte me të madhe.

Një drekherë, apo lëshova nxënësit, u nisa drejt e në shtëpi. Si ndejta brënda një copë herë u mata të dal, por sà vura këmbën në prag të kthinës pashë një vajzë që ishte duke më përgjuar pas derës. Ajo u vërsul të largohet, por nga nxitimi u pengua dhe u përplas sa gjat' e gjérë në çardhak. Si duket u vra se e vari kryet pas ëdhë u drodh. U zura ngushtë, por megjithatë iu afrova ta ndih. E kapa për krahu:

— U vravë, o çupë?

Ajo çeli sytë e saj të mavi dhe më vështroi si me pikëllim.

— Ikë, shoku mësues, ikë se na shohin

Ish te veshur thjesht e varfër, por fytyra i ndristë nga shëndeti e nga pushi ngjyrë trandafili që kish mbi faqet tash — Merušhée!

Ky ish një zë gruaje që thirri nga odat përtej Vajza përbloqët gjunjët, u ngrit rrëmbyer dhe rendi andej.

Unë dolla n'oborr dhe u pështeta pas trungut të një gorrice. Një dëgë kaçke godiste mbi çati, ndërsa fryntë një erë e hollë. Disa çape u dëgjuan tej në patozin e rrugës. Ja dhe Balua i kopesë hyri në oborr e shkoi pas gërdhit. Ne lesa u duk njëri nga djemtë e Asllanit, ai që kulloste dhentë. Ish i zbehtë si meit dhe i dridhej gju e buzë. Rexhepi, vëlla i Asllanit, i dolli përpara:

— Ç'ke, more, ç'ke kështu?

... kopeja, shkoi kopeja... e gjitha! Ago Asllani u derdh nëpër shkallët, në fillim zbardh buza, pastaj i hipi gjaku në kokë. Një çetë Ballit kishte dalë ne Guri i Prerë dhe i kish rrëmbyer me dhunë të pesëdhjetë e ca delet e shtëpisë.

— Talleshin më mua, — tregonte djali, — thalleshin kur u lutesha e më thoshin: «Ku do gjejë Asllani qu-mësht pér të ushqyer atë komisarin që mban në shtëpi?»

— Po dyfekun s'e kishe?

Djali unji kryet.

— Të rrëmbeftë mortja ty!

Plakut i dridheshin gjunjët dhe rrihte gjoksin me grusht: Do të ma paguajnë këtë, pér atë bukë do të ma paguajnë, do t'u kërkoj vezët pula e pulat vezë. Ju dje-mia, delni nëpër fshat, thoni njerëzisë të hedhin tufat anës së gjolit.

Nuk vonoi dhe u mblohdhën aty gjithë burrat e shtëpisë. Xhaxhaj ishte unjur më bisht, sytë i qenë bërë gjak të kuq dhe i dridhej njëra këmbë.

— Xhaxha, — fola, — më duket se kjo e keqe të jeti pér shkakun tim.

Ai më vështroi rëndë-rëndë,

— Kjo kockë, nuk tundet ku ka dhëri fjalën, mund

të qeshë sot Xhelo Tapia, por të shohim kush do qeshë, në fund.

U mblodhëm në odën e madhe. Dukej sikur gjithë shtëpisë i rë zia e mjerimi. Ardhi nata, por bleqerima e gjësë së gjallë nuk ndihej në hauret poshtë.

— Po vjen dimri, — foli Rexhepi, — duhet menduar për bukën e fëmijës.

— Të pajtohemë çobenë në vërrri, — foli një nga djemtë.

— Kam një amanet nga babaj, rahmet pastë, — foli Ago Asllani, — kur dha shpirt ai nxori bashkë me frymën; këto fjalë: «Kur të ndodhesh keq, — më tha, — kur të jesh buzë greminës, por vetëm atëhere, të jap lejë të hapësh një haznë që kam lënë, është mbuluar n'oborr, tre pashë këtej nga pusi, drjet plerëhit 1) Do Zoti e vemë kopenë në vend.

Të gjithë në odë po haphnin sytë, unë vështrova plakun në sy, gratë po pëshpërisnin në çardhak.

— E ke me gjithë mend, Ago Asllan?

— Merrni këzmat! — urdhëroi ai.

Kockat e gjunjëve i krisën kur u ngrit. Jashitë kish rënë nata, përmbi mal kish dalë hëna. Disa nga djemtë e fshatit, me armët peshë, po kalonin tatëpjetë.

Nisën të rëmojnë n'borr me një vrull të dëshpëruar, Mëruhja afroi aty pishtarin e ndezur, e gratë e tjera qëndronin më larg, si për të fshehur fytyrën nga unë. Hiet e zeza të burrave që rëmihnin ndeheshin gjere larg faqes së malit.

— Duket tokë e hedhur, — foli një nga mihësit.

— Dhé i punuar.

Papritur kazma kafshoi një hekur, kerciti e lëshoi xixa.

— Dale! — urdhëroi plaku e u hodh në gropët, — qasni pishtarë këtu.

Hogen ca shufra hekuri dy-tri plashta gati të kall bura, një teneqe të gjatë; nja dy gurë u rrökullisën the-

1) Lesë — a

llë gropës dhe ja... kazma! Ish një shishane e gjatë e një arkë me plumb e barut.

— Breh! — ulëriti xhaxhaj; dolli nga gropë si i trëmbur dhe i hiqte këmbët me ngut sikur largohej nga vji hie e keqe.

— Breh! — Ai fërkoi mjekrën e shkundi krahët. Pastaj u kthyesh buzë gropës kokëzbulluar, trupmadh e hirëndë me ballin e ashpër drejt hënës së kuqe.

— Medet! Këta të shkretë dyfegje na e kanë ngrënë kokën gjithë jetën, me këta ja kemi nxjerrë zorrët njëri-tjetrit. Le të ishte një çekan a një lelek, do isha kënaqur, haznë fë mirë na paska lënë, o baba, Perëndia të ndjeftë. Por ikën ato kohë, po rrokuillisen.

— Nxirreni këtej, — urdhëroi Rexhepi, — për luf të e mirë është.

— Vereni në kotec se mund të flejnë gjithë pulat në tē.

Një këmborë tringëlliut në rrugën e fshatit, një dritë pishe, si shami e kuqe, u duk andej.

— O xha Rexhep! Xhepo!

— Ç'është, ore?

— Mbaji qentë se po vij, kam një punë.

— Po ky? — Rexhepi ngriti supet.

Ishte një fshatar me një dele ngarkuar mbi zverk, qengji i vinte pas.

— Kabull dashurinë, xha Asllan!

Plaku kafshoi buzën e poshtme.

— Mos u nxito të flaç, Ago Asllan, mos u nxito, se hyn në hasmëri me gjithë fshatin.

Në rrugën lart këmbë të tjera:

— Xhepe! O Xhepe! Mbaj qentë.

Dhe duke parë gjithë ata fshatarë që afroheshin me nga një dele ngarkuar mbi qafë, m'u kujtua se burra të tillë, bujarë e fisnikë, ka vetëm nér malet tona.

NE SHTEPINË E MJERIMIT

Dimri ardhi para kohe. Dëbora e parë ra e trashë me pllaska të mëdha si copa pambuku. E nisi në mbërmeje dhe pushoi n'agim. Pastaj u hapën retë dhei filloj veriu të ulërijë si i marrë.

Por me gjithë të ftohtën, nxënësit erdhën. Ndonjëri kish mbështjellë këmbët me lecka e copra çadëresh. Vajza nuk më erdhën nxënëse në shkollë. Kuri i fola njëherë khaxhajt për këtë, ai ma preu shkurt:

— Hidhi gunën asaj pune.

Pastaj për tri dit me radhë nuk më erdhë në shkollë Giçi i Qamilit. Më kot i dërgova fjalë, por ai nuk u duk. Ditën e katërt vendosa t'i shkojti vetë në shtëpi. Ishte mëngjes. Lashë nxënësit në shkollë dheni nisa. Bardhësia të verbonte sytë nga dielli i fortë. Dolla nga kreua i fshatit dhe duke pyetur e gjeta pas një strumbullari shtëpinë e kërkuar. Kish një derikë ngjyrë plumbi e nëpër të çarat i kishin futur copa rrogozi. Trokita. M'u kthye një zë si i dalë nga dheu:

— Hëë? Kush është?

— Jam unë, mësonjësi, xha Qamil, hape derën.

— Hapur është, hapur, shtyje.

I dhashë një gju kënatës. Brënda errësirë e plotë, nuk dukej asgjë. Nuk kishte as dritare, as zjarr. Fola përsëri:

— Xha Qamil, këtu je?

— Këtu ja, këtu.

— Po ku, këtu? Unë nuk të shoh fare.

— I ke sytë nga dëbora; shoku mësues, prit pak sa të të mësohen.

Këtë zë e njoha. Ishte ai i Giçit. M'u kujtua shkrep-sja që kisha në xhep dhe ndeza një fije. Skena që më dolli përparrë bëri të më dridhet zemra. Kthinës i qenë zënë dritarët me plitharë e baltë, nuk kishte asnjë orendi, as zjarr, as rroba, as rrogoz. Në një vrimë çelur në tokë e të mbushur me lecka e kashtë ishte futur Qamili me gjithë të birin, rrinin të kuspusulosur pas njëri-tjetrit si për t'u ngrohur.

— Jemi keq, zoti mësonjës, keq, unë u sëmura që në vjesht fukara njeri, mbeta pa kamje, pa bukë, pa dru. Më erdhi kasollja rrotull dhe e humba toruan, nuk dia nga hyra e nga duhej dalë. Ajo kuvli m'u duk si cepi më i largët i dhet. Nxora xhaketën time dhe e mbësh-tolla Giçin me të. Ai kishte në trup veç disa lecka prej linace.

— Eja me mua, vogëlush, — fola, — do të të gjej edhe këpucë, edhe rroba të tjera.

— Po mua, zoti mësonjës? Ku do më lesh vetëm kështu? Mos ma merr djalin, mos de, kështu ngrohem i të dy, e ka zemrën të re çunaku, i punon aq shpejt sa e ngroh babëzinë. . .

Të sëmurin e mbyti një kollë e çjerrë, që dukej sikur po i gryente mëlcinë.

— Mos ki merak, Qamil, edhe për ty do bëj derman, nuk vonohem.

U lëshova me vrapi nga shkolla, lëshova Giçin pranë porit dhe u sula në shtëpi. Në çardhak gjeta Merushen. Ajo nuk iku, bile më pyeti:

— Kérkon gjë, shoku mësues?

— Kérkoj xhaxhanë, Merushe.

— Ai është poshtë, po ti q'jerë kështu?

Thuaji të ngjitet këtu, shpejt, Merushe, shpejt. Hyra në odë dhe prita. Plaku u dha ne dera. I tre-gova mbi gjendjen e Qamilit.

— Si more, e vraftë Zoti, — ma ktheu plaku, — po si nuk na kishte thënë gjë, e di unë, është namuzqar i madh ai, vdes e nuk kérkon.

Djalin e mora në shkollë, i rregullova edhe një veshje dosido, por duhet ndihmuar i ati.

S'do mend, xhanëm, nuk do ta lëmë ashtu, po... Mëruşhe! thërriti ai, — sillmë këtu tallaganen time vjetër.

— E lanë nuset dje në mëngjes xhaxha, kishte zënë morra dhe e përvëluan, pa dale ta shoh.

U vonuam sa u tjer veshja, sa mori një çyrekë bükë plaku, dhe u nisëm. Nxituam përpjetë, unë trokitë.

— Hë, more, përse troket; shty derën.
— O xha Qamil!
Asnjë përgjigje. Qamil ore! Fol, ore, të foltë hoxha në vesh!

Iu afruam gropës, ndeza një shkrepse. Përpara kishim një kufomë. Në prag të sýve dy lot ishin kthyer në pikëla akulli.

Tëpër i tronditur u ktheva në shkollë. Gicë i vogël po hante një ftua pranë zjarrit. Më sëmboi në zemër kur e pashë të qetë me atë qafëzën e hollë si pé. Ndënë kafazin e gjoksit, ku i nëmëroheshin brinjët e tukequr i varej një hajmali e zezë si një vulë talljeje dhe mjerimi.

NJË SULM I PAPRITUR

Një ditë isha ulur në këndin tim në shtëpi dhe po qortoja gabimet e nxënësve nér fletoret. Pasi mbarova, mora dylbinë dhe nëpër dritaren e kthyer në frëngji, fillova të vështroj malet me gurë të kuq, që shtrihen kundrejt Panjasit. Male t'ashpër e me shkurre e bushi. Nëpër monopate të ngushtë dukeshin mushka të ngarkuara rëndë me dru, më tej një tufë dhensh dukej si një vezë që rrrokullisej shpatit. Më tëhû, poshtë, në këmbë të malit, një mulli me dërstilë, currilat e urave dukeshin si të mavinja, papritur në njerin xham të dylbisë një njollë e verdhë si një luleshqerre. Hoqa dylbinë nga syri dhe vështrova në kopsht. Ishte Merushja. Ajo kish dalë prapa shtëpisë e mblidhë rrobat e terura. Ndënë mollët ishte një pellg uji, e mbanin të mbushej përkazanin e rakisë. Vajza vështronte trupin e saj në cipën e ujit e gëzohej. Përshkundi flokë e saj të zes dhe i shihte tek i valaviteshin mbi supë. Vu duart mbi gjinjët e saj kryeneçë, por shpejt i hoqi dhe vështroi anash.

Një nga djemtë e Asllanit erdhi që pas shtëpisë ngarkuar me një kërcu të rëndë prej frashëri. I foli vajzës:

— Ikë brënda, Merushe, sot nuk duket mirë puna; éshëtë Agaj në shtëpi?

— Jo, — u përgjigj ajo — ardhën e thirrën dy partizanë.

— Një çetë ballistësh éshëtë fshehur në luadhet lart. — E pse t'u kemi frikën? Apo nuk kemi kaq pushkë në shtëpi.

— Éshëtë brënda Bardhyli?

— Aty e ke.

Vështrova fytyrën e bardhë e gati fëmijore të Merushes; balli i saj i bukur kish marrë një pamje të treptë.

Në çardhak u dëgjuan çape, ishte xhaxhaj me djemtë.

— Mos dil jashtë, Bardho, më foli plaku, një çetë e Ballit po mérzen këtej, ishin djemtë lart?

Dera e odës u përplas me forcë, në prag u dha Merushja me syt' e çakëritur:

— Xhaxha! Dy njerëz të fshehur ne përroi, poshtë bështës!

Dyfegjet! — ulëriti plaku. — Zëri i tij dukej krejt i ndryshëm. — Ti Merushe del me vrap nëpërfshat, bëju zë burrave.

— Unë?!

— Ikëë! Ju djema ne përroi, ti Rexhep me mua.

Një zë përtej oborrit:

— O xha Asllan, o Ago Asllan! Vdekje Fashizmit! Ti je Asllan Lajthia?

Ne lesa e oborrit ish një farë partizani i shkurtër me këmbët si biza. Yllin në ballë e kish fare të ri.

— E, unë jam, ç'do?

— Komandant Shabani të kérkon në luadhet lart! Të vish atje me gjithë Bardhylin, kështu më tha me gojën e tij, unë po ik, atje të presim, hajde, Vdekje Fashizmit!

— Rexhep, — foli ngadale Ago Asllani, — këtu të dua, e njohe? Mbaja me një kryqeve.

— Dua ta vrás përpëra, më vjen zor kështu.

Unë po çapleja sytë.

— Hej! Hej! — thërriti plaku, — hej, zoti ballist!

I huaji ktheu ballin.

Dhe aty e pat.

Poshtë pérroit u këmbyen të shtënënat. Plaku u turr në frëngjité, edhe vetë i shkova pas. Por asgjë nuk shihnim, se armët binin nga ana e Koritës. Pastaj plaku bërtiti:

— Djema! Hiquni këtej se u mbuloj unë.

Fishkëllima kaluan mbi shtëpi, mbi çati u ndjenë çukitje plumbash. N'atë çast më zë frika. Pa e ditur dhe padashur m'u drodhën gjunjët dhe një lëmsh i ngatërruar m'u mblodh mu në grykë. Një fuqi e padukur më mbante mbërthyer në patoz struktur pas qoshkut të odës. Merushja u derdh brënda:

— Xhaxha! Një sërë djem zunë vend ne xhamia, burrat u përhapën nëpër shtëpitë, po dy vëllezërit e mij s'janë kthyer nga mali.

— S'ka gjë, bijë, ata i kanë pushkët.

Dy djemtë e Asllanit hynë në odë:

— Na ikën, baba, tre ishin, por na pikasnë më parë; gratë e fëmijët i mbyllëm poshtë, portës i shkuam llozin.

— Mirë, mirë, po tashti zini frëngjité, do kërcasë donomaja sot, sytë katër dhe asnjë plumb në hava.

Bëra të ngrihem, kur u ndjenë bataretë përjashta. Merushja m'u vërsul sipër, më kapi me të dy duart për jake e më dyndi pas qoshes:

— Unju!

Ndejti edhe ajo ndër këmbët e mia, po aq pranë sa ndjeva përbri trupin e saj të shkathët, frymën e saj të ngrohtë, një vështrim të përgjëruar. Befas ajo këceu, kapi pushkën time dhe u turr në krah të Asllanit.

M'u duk atëhere se qelizat e trurit tim punonin më me ngulm, m'u bë se mendja më mori një kthjellësi të çuditëshme, tashti ndjehesha i trimëruar, dhëmbët më kërcitën nga shtërngimi. Me një lëvizje t'ethëshme ja rrëmbeva armën vajzës dhe u lëshova në frëngjité. Ballisti i shtrirë tej në rrugë kish përdredhur këmbët në

një mënyrë të çuditëshme. Pastaj u ndeh një qetësi e habitëshme, një heshtje e thellë, edhe e ftohta e dimërit sikur nuk ndihej më. Veç era e tharme e barutit më digjte në qiellzë.

Tashët ishte e qartë: Çeta e Xhelo Tapisë kishte rrëthuar fshatin. Më parë deshën të na futin në grackë. Që nga arat përtej u ndje një zë i fortë:

— O xha Asllan! Jepu me të mirë, ore! Jepu me të mirë, se po vjen gjermani me topa e do digjesh me të gjitha!

Plaku afroi gojën ne frëngjia e fryu bulçitë:

— As na dërgoni një pagur, ore miq! Raki, ore, raki, se për meze kemi shtrirë këtu një gomar pëlldëmkuq!

Si përgjigje të shtenat u shtuan menjëherë, një plasje e egër gjëmoi mbi çati, u dëgjuan klithmat e kalanve, thirrjet dhe ofshamjet e grave. Një zhurmë çapesh njeriu n'oborr. Ai kishte hedhur granatën mbi pullaz. Ago Asllani po hetonte nëpër frëngji. Iu qasa më krah, e shqoja një sup veshur me shajak pas gardhit, mbi të një gjurmë taze e gjembut e ledhit përshkënditur. Shtimë të dy përnjëherësh, gardhi u lëkund, një palë këmbë me bollka shajaku përshkuan erën si hark e ranë te poshtë. Zëra t'ashpër matanë, sharje e vërvshëllime:

— Ah, në të zënçim! Në të zënçim!

Qëndronim të gjithë në gjunjë buzë frëngjive më sytë përjashta. Merushja, si një shkjarthe e lehtë bridhët odave këmbadoras. Një mitroloz zu rrihte fare pranë; pastaj në një çast na ngjau gjëma. Rexhepit i erdhë si trazi e rrotulloi vështrimin n'odë:

— Ago Asllan... Bardhyl... se si jam kështu!

Kaq mundi të thotë, u mundua të mbahej, po pastaj ra me kryet mbi kondak. Ish goditur në zemër. Merushja ja dha klithmës e ra mbi të, më sëmboi në shpirt e shtrëngova dhëmbët. Thirrje armiqsh ushtuan n'oborr, bomba dore në çati. Ago Asllani shkopsiti dy granata e i lëshoi nëpër frëngji. Pastaj ktheu Rexhepin, ja çeli syrin dhe e pa mu në bebe.

— Mbylle gojën — i bërtiti vajëzs! — Pusho! — AF
mbaroi.

Vajza u bind.

Porta e shtëpisë u çakelye nga një granatë, ciflat e kënatave fluturuan në hava, trarë e themelë u lëkundën krejt.

— Pas meje! — urdhëroi plaku.

U vërsulën poshtë e zumë qoshet e remes. Një batax ré plumbash goditën mürin kundrejt portës, të tjere xhvoshkën trarët e çerpitën patozin. Një burrë i shkathët i kërrusur më dysh, u turr brënda, por në gjysëm errësirën e tremës s'i shihnin sytë dhe si ndonjë plaku-riq nate u përplas në shtylla e grazhdit. U vërvit si një makinë e kurdisur e kërkoi qoshet me shkrepse në dorë. Xha Asllani e arriji kur po kalltë zjarr dhe ja nguli shishin n'ije.

Qitjet përjashta u dendësan, fërshëllen bilbila, zëtra të çjerrë, këmbë të shpejta zunë të rrabin patozin e rrugës.

Dum! Dum! Dum!

E pashë Ago Asllanin tek zgjati kryet përparrë e ktheu veshin nga porta e shkallmuar.

— Jashtë! — bërtiti ai papritur — Jashtë! Ti ndjekim!

Batalioni partizan kishte arrijtur në fshat.

Nuk pashë si vijoi ndjekja e si mbaroi lufta. U ktheva në odën lart, ku gratë po qanin të vdekurin tonë. Pastaj erdhi komandanti i batalionit me një tufë partizanë dhe me Ago Asllanin në krye. Fytyra e plakut kish marrë një çehre në ngjyrë të bakrit, koka i dukej si e mbuluar me llohë, gjurmët e dhëmbjes sikur i qenë ngulitur në buzët e trasha dhe balli i tij ngjiste si një mblatës i tymosur. Pikë loti nuk dolli nga syri i tij.

— Vdekje më të mirë nuk i uroj as vetes, as djemve.

Kështu tha ai në mes të odës dhe i kërkoi komandanit të këndojnë djemtë këngë trimash. Unë vështroja të vdekurin dhe mendoja:

Ti re duke luftuar o Rexhep, re duke mbrojtur të

ardhmen e brezave që vijnë, po ti vdiqe pa besuar në të ardhmen, ti vdiqe për besimin tonë, të djemve, të vëllajt

SEKRETARI I KËSHILLIT

E quanin Demkë. I kishte nja dyzet vjet, po i plakur para kohe se flokët i kishin rënë e dhëmbët e para i ngjisnin si ndoca perona të shkurtëra e të rëzhdosura. Kishte besim të verbër ne lufta partizane dhe fitoren e quante si një ndodhë krejt të sigurt. Më vinë dëndur në shkollë, qëndronte atje me orë të tëra dhe kur më mungonin nxënës, ai hidhej në fshat pa përtuar e sillte me vete çunakët buzëvarur. Merrja më mend se ky si «sekretar i këshillit», do të ishte i vetëmi njeri me shkollë në fshat dhe kisha për të një sajdi të ngrohtë. Por nuk vónoi dhe mora vesh se isha krejt i gabuar.

Në sallën e shkollës ishin mbledhur gjithë burrat dhe djemptë e fshatit. Kishin kaluar nja tri javë që kurse na ndodhi vrasja e Rexhepit. Nxënësit e mi kishin vënë për brezi kobure dërrase, ishin ndarë në gjermanë e partizanë e aty para oborrit po vringëllonin shpatat prej druri. Më tej vej e vinte nëpër oborr komandanti i batalionit partizan, duke pasur në krah Ago Asllanin dhe Demkën. Këtij se ku i kishte humbur festja e bardhë e i fekste tullga e kokës.

Pasi filloj mbledhja, Ago Asllani, si njeri që i dëgjohej fjala, bëri thirrje për të dalë vullnetarë djemptë e rinj. Të parët iu përgjegjën dy djemptë e tij e pastaj muarën radhë të tjerët.

— Servet Asllani, vullnetar me pushkën e vet!

— Ali Bagova, vullnetar, po pushkë nuk kam!

— Selim Lajthia, vullnetar me mitroloz grek!

Të gjithë bërtasin:

— Tunde Selim, shtëpi pushkel!

Një çunak këceu në dritare:

— Edhe unë vullnetar, ore! Për besë!

Ishte Giçi i vogël. Dikush i dha një shpullë vitheve, por komandanti e kërkoj. Ja suallën gjer në tryesa.

— I kujt është ky djalë? — Demka, duke krojtur kokën e zbuluar i thotë se është «djali i Bardhylit», i jep edhe shpjegime të tjera. Komandanti i vu çunit një kalem blu e kuq në duar.

— Faleminderit, shoku komandant!

Gjëndja lëshoi një mërmërim ngazëllimi.

Dollën gjithësej trembëdhjetë vullnetarë. Komandanti më ngarkoi t'i radhit në një listë e pastaj, më tha, në fund, të venë firmat ikryetari dhe sekretari i këshillit. E bëra listën shpejt e shpejt dhe ja vura përparrë Asllanit. Ai më pa me habi.

— As firmën nuk di të vesh?

— Di, — m'u përgjegj ai, — por vetëm me këtë. —

— Duke shkrepur syrin ai ktheu tregonjësin sikur hiqte këmbëzën e armës.

— Mirë, mirë, ver gishtin atëhere.

— Poco, atë e ve, ngjyema me bojë.

Pastaj ja vura listën Demkës:

— Firmën, Demo!

Ai sërisht krojti kokën e zbuluar.

— ...?

— Po ti je sekretar!

NJË RAST I PAPRITUR

Kish filluar një shkrirje dëbore e rrugët qenë mbushur plot ujra e llucë. Harabelat i patën lënë hatullat e plevicave dhe fluturonin mbi kupet e plehut. Vetëm larg, nëpër hiet e përrunjve të malit, diku zbardhët bora si ndonjë arnë e çjerrë. Mbrëmëherë u ktheva në shkollë të merrja librat që pata harruar. Papritur më zu syri diçka të zezë përtokë. E zgjata dorën dhe e mora. Në një shami të grisur, një tog gjérash lidhur me penjë leshi; një këmbë zhabe, disa gjëmba, copra thonjsh, një dhëmb dosbale. Më kishin bërë magji! Fillova të mendohem:

«Përsë e kanë bërë këtë? Sigurisht për të mbyllur shkollën; të vish këtu t'u çelish sytë dhe të të urrejnjë Kur i mjekon plagën të sëmurit ai thërret, por i sëmuri është i vetëdijshëm për shërimin, këtu ngjet e "kundërtë".

Ndeza llampën e vajgurit dhe u unja para tryezës Mendohesha e qëshja me veten time, ndeja ashtu një copë herë duke rrahur gishtat mbi dërrasë, duke tündur kryet duke nënqeshur me hamendjet e mia deri sa ra nata. Papritur një hie kaloj para dritares. Menjëherë brofa më këmbë. Mos vallë ishte Xhelo Tapia? Shqjtë llampën dhe vura veshin. Asnjë zhurmë. Prita më këmbë në mes të sallës. Heshtje dhe errësirë. Mos vallë më bënë sytë? Dolla me kujdes nga shkolla duke mbajtur revolverin në dorë. Gjatë rrugës nuk hasa njeri. Mora shkallët drejte e në odën time. Zjarri skuqte xhamat e dritares së vogël. Në çardhakun e gjerë në hije. Ishte Merushja. I fola:

— Mirë që të gjeta, o vajzë, kam diçka të të them.

Edhe n'errësirë ndjeva se ajo u skuq gjer në rrënës të flokëve. Gusha e bardhë sikur i feksi, se iu çel e tëra ndërsa ngriti kryet drejt meje.

— Dëgjo, Merushe! Nesër djemtë do sjellin gëlqeren nga furra e malit, për këtë ka punuar Demka me kohë Shtëpinë do ta lyejnë me gëlqere, për këtë më ka dhënë fjalën xhaxhaj, por ti po deshe ose po munde, lyej me gëlqere edhe qemeret e jashtëm të dritareve. Për të bërë një punë të tillë që nga brënda, duhen hequr kafazet që kini nëpër disa penxhere, pra ti hiqi, gjoja se do t'i vesh sérish e pastaj...

Ajo nënëqeshi e bashkoi duart ndënë mjekër.

— Mirë, Bardhyl, këtë do ta bëj.

Vështrimi i saj varej akoma tek unë, pastaj ajo uli kryet si e turpëruar.

— Vetëm këtë do më thoshe, Bardhyl?

Zëri i saj ishte i ngashëryer, trupi i saj fërgëlli e unë u binda se ai fërgëllim nuk vintë as nga droja e as nga e ftohta. Më duhej t'i hyja një shpjegimi të gjatë.

Por nuk ishte as vendi, as koha. Isha i sigurt se ajo më deshite mua, jo më si vëlla, sikurse më pat thënë disa herë. Dashuria e saj ishte krejt ndryshe. E mblohdha vreten dhe i folat:

— Merushe! Ti je një vajzë e dlrë dhe e dashur. Unë kuptoj se çfarë ngjet në zemrën tënde, por unë nuk mund t'i përgjigjem dhëmkës sate, veçse me një dashuri të pastër prej vëllaj. Përndryshe duhet t'i rrëmbeja lumburinë një vajze tjetër, një vajze që i kam dhënë fjalën më kohë, atje larg në qytet. Unë të kam si motër, të dua ndofta më shumë se vëllezërit e tu e qdo dashuri tej këtij caku do të ishte mashtrim dhe poshtërsi, si për mua ashtu edhe për ty.

— Ajo kishte ulur kryet, sikur ishte duke lexuar një vendim të ashpër e të egër. I lëshoi duart poshtë e mërmëroi:

— Mirë, Bardhyl, të kuptova.

— Ajo iku aq shpejt sa m'u mbush mendja se qe zemruar.

U ngroha një copëherë pas zjarrit dhe rashë në mendime. M'u kujtua një bisedë që dëgjova disa ditë më parë në oborrin e shtëpisë. Zërat vinin nga bashta e unë isha në dritaren time. Atëhere bisedonte Merushja me njérën nga nuset e shtëpisë. Kjo e fundit i lutej vajzës:

— Merre Shefkën, Merushe, do shkosh jetë, jo sha-ka, është si është im vëlla, po njëzet dynym tokë i ketmi ne, edhe nga kopeja nuk biem poshtë. Mos vra mëndjën shumë lart, euh... kë trapit ti!

Shefka ishte korier i fshatit motrën e kishte dhënë në derë të Ago Asllanit, nuk isha gabuar që ei urreja apo që e hasa ditën e parë. Kish qenë xhandar disa vjet e hiqej si njéri i zgjuar. Në mes të mjekrës kish një gropëzë të thellë.

NJË ORE MËSIMI

Një ditë dimri, apo kisha filluar mësimin, kur ndjeva një zë që thërriste nga jashtë:

— O shoku mësues!

Çela dritaren dhe u përkula nëpër të. Dy partizanë kalorës qëndruan përballë shkollës.

— E, shokë, si e keni punën?

— Shoku Bardhyl, të lutemi na rregullo nga një copë bukë se mbaruam.

— Që nga vini kështu?

— Nga baza e Segovës.

— I paski rënduar kuajt, u ka dalë djersa mbi vithë.

— Jo, barra nuk është e rëndë, është kaba, por nxituan ca të e përpjeta, kemi ngarkuar dy radio me bateri për kombandën e vendit!

— Radio? Dale. Qëndroni. Nuk ju lë të më ikni. Nxënësit e mi nuk kanë parë një gjë të tillë.

Dërgova Giçin te Ago Asllani, kur të dy partizanët shkarkuan njërin aparat nga kali. Ua mora nga duart radion dhe e vendosa mbi tryezën e shkollës. Pastaj afrova edhe baterinë, bëra lidhjet e ndeva një copë anftenë. Në fillim disa fishkullime të holla, pastaj tinguj violine. Nxënësit mbanin fryshtat, syt' e tyre më vështronin të pataksur. Lëviza butonin më tej. Një zë jepte lajmet frëngjisht: Ushtria e Kuqe çau rrëthimin e Leninogradit, jahë rrëzuar njëzet aeroplanë të armikut...

Te dera u dha xhaxhaj dhë u afrua me kërshteri, pas tij ish Merushja, vështroi vëç bangon time, por jo mija. Plaku i shfrytu me inat — Tashti mërzitesh, — ja ktheu ajo, — po atë ditën e luftës mu në mes të ditës, a nuk më dërgove vetë nëpër burrat e fshatit?

I tregova xhaxhajt lajmet e radios. Të gjithë më vështronin të mahnitur.

— Po ku e di ti?

— Ja, sapo e thà radioja.

Merushja vuri fytyrën mbi diapazonin:

— Po ç'thotë kështu? Unë e dëgjoj e s'e marr veshi

— Flet në gjuhë të huaj, frëngjisht.

— Ç'do me thënë gjuhë e huaj, nuk është njeri ai?

Po ti si e merr vesh?

Ajo më flet pa më vështruar në sy; gjithnjë e kërrusur mbi aparatin.

— Unë e di atë gjuhë, e kam mësuar në shkollë.

Padashur gishti i saj përkiti pëllëmbën time, ajo e tërroqi shpejt. Unë mora fillin e antenës dhe e vura mbi dorën e Ago Asllanit. Zëri i radios u shtua.

— Zihuni të gjithë dorë për dorë.

Bënë si u thashë e zëri u ngrit edhe më. Merushja më foli ngadale:

— Përse ngrihet zëri kur kapemi dorë për dorë? Ishpjegova se trupi i njeriut, lëkura, flokët, i japin dorë radios, e ndihmojnë të afrohen zérat më shumë. Nuk dija se si t'i shpjegoja që të më kuptonte.

— Po sikur ta kap edhe unë telin?

E unja zërin dhe ja ktheva:

— Prej flokëve të tu aq të bukur zëri do bëhet më i ëmbël, më i butë... Mos m'u zemëro, Merushe, unë të çmoj, ti je vajzë e mirë, e bukur e dashur, por mos m'u zemëro...

Ajo bëri sikur nuk dëgjoi, por unë i pashë veç një cep të veshit të saj të vogël që iu përskuq si një petale trëndafili. Por fytyra e saj nuk dukej, ish kërrusur e tëra për të fshehur faqet dhe ballin e ndezur.

— Po si vjen zëri gjer këtu, shoku mësues?

Ky që pyeste ishte Giçi. U kapa ngushtë. Me se t'ua krahasoja radion? Ata nuk njihnin asnjë aparat, asnjë farë motori, as edhe një makinë qepëse. Ata njihnin veç...

— Dëgjomëni, — u fola, — ja, për shëmbëll, të marrim mullirin, ai ka një sërë veglash, si pendë, bosht, gur, e të gjitha këto vlenjë që të bluhet gruri a misri, kurse radioja ka një sërë veglash prej teli e xhami, të cilat, me ndihmën e elektrikut që jep kjo bateria e zezë na afrojnë zérat që vijnë prej shumë larg. Kur të rriteni ju, do keni radio të tilla nëpër shtëpitë tuaja, ndonjëri do bëhet mjeshtër e do t'i ndreqë këto në fabrikë. Si e shihni, këtu brënda nuk ka as djaj e as lugetër, sikurse mund të thonë njerëz të paditur.

Ndërkojë partizanët mbaruan bukën dhe hynë në shkollë. Falenderuam dhe iu uruam rrugën e mbarë.

NE STROFKËN E PADIJËS

Për të katërtën ditë po mungonin nga shkolla dy nxënës. Ishin çuniat e hoxhës, nipat e Shefkës. Pasi mbarova orët e mësimit, u nisa për te Demka. Se ku kishte gjetur dhe kish vënë në kokë një festë të zezë.

— Paske lojtur nga terezia, shoku sekretar, qëndre bërë fashist nga koka!

— Ore, mezi rregullova këtë, më mbet koka jashtë.

I tregoya arësyen e vizitës dhe bashkë me të u nisëm nëpër fshat. Një korier partizan na preu rrugën e i dha Demos një letër nga shtabi i batalionit. E celi e më dha t'ja lexoj.

— O Sulo! — i thirri një djali që po zbriste këtë, merr nga dy shokë e mblidhni nëpër fshat bukë përgjashëtëdhjetë partizanë.

— Në një qoshë u dukën këmbët e palara të një gruaja mbuluar me dumane gjer ndënë pulpë. Ajo vu duart mbi fytyrë dhe desh theu kryet se iu ngatërruan nallonet kur i thirri vrapi. Demka unji kryet, po s'e mbajti dot zemërimin:

— Kokën thefsh, dosë e derrit!

Para kishim një derë të vogël të celur në kënatën e një portë të madhe. Brënda po rrithnin misër në lesë.

— O hoxhë efendi!

Hunjët reshtën së qëlluari, një qen zu lehte më të madhe ndënë prag. Hoxha fytyrë bakër e i thatë si ciragë na celi derën.

— Bujrum, urdhëroni, — na foli ai hund' e buzë. Mjekra e zezë dhe më një majë i dridhej si e përcit në kohë.

— Përparrë kishim një shtëpi shkatarraqe dhe të shtrëmbër; më dritaret qenë varur copra rrogožash, mba-

nte erë arme dhe ren. Furra ishte mbi kaliben e qenit e më sipër si një flamur i zisë dhe mjerimit qëndronte me paçavuren lart pepellashka e furrës. Dëmka me hoxhën u ulën, por vetë nuk desha të ze vend, më vinte zor, më vinte ndohtë. Përkita me dorë sofatin e furrës dhë m'u bë sikur ajo djall pëpellashkë qëndronte me kokën lart si për inatin tim. E rrëmbeva dhe e kthevë kokëposhtë.

— Psë i ndalove nga shkolla fëmijët, ti hoxhë efendi?

— Po ja, more Demo, kemi ca punëra që nuk presin, pastaj na mbetën edhe dhitë brënda, s'ka kush i nxjerr, jo më tutje, por as gjer tek meraja.

— Ato i ler mënjanë, mos m'i hidh mua, të gjithë punëra kanë, por besën e mbajnë. Të kujtohet si zumë dorë kur u çel shkolla?

— Të rrijmë shtrëmbër dhe të flasim drejt, o shoku Demkë, edhë ti o shoku mësues (ai na zgjati kutinë e duhanit), unë nuk i dërgoj më djemtë në shkollë. Ai ktheu pëllëmbët me shpinë nga vehtja, sikur ngrohej mbi zjarr.

U çel një derickë nga fundi i oborrit, dolli q'atje një bushtër kock' e lëkurë dhe shkoi pas murit; te pragu u dha Shefka duke dredhur pa të keq një cigare duhani. Gropëza e mjekrës i qe mbuluar nga të parrojturit.

Ja, — vazhdoi hoxha, — le të flasë edhe im vëlla për këtë, ai si njeri i gjeddisur i di më mirë këto punë, edhe ai njeri i këshillit është; apo s'e kam mirë, o byrazer?

Shefka u unj mbi një kup koçanësh i shkujdesur, sikur nuk dinte përsë bëhej fjalë.

— Ja, për punën e fëmijëve, o vëlla, jepu xhevapin ti.

— Xhevapi është i dhënë. Me zor nuk është kjo punë. Duan, vijnë, s'duan, s'vijnë. Ne e nismë këtë punë që të mësojnë çunat shkrim, nuk i dërguam të na bëhen kaurë.

Më ardhì të rrëmbej njérin nga hunjet, dhe t'ja

kërcas Shefkës mu prapá veshit. Gjaku më hipi në koke dhe mendova se nuk do delja andej pa u përleshur një herë me atë njeri të poshtër.

— Këtu nuk është fjala për t'u bërë fëmija kaurë, këto fjalë thuhen me qëllim të keq, kemi të bëjmë me njerëz që na pengojnë duke e ditur mirë se çfarë të keq po bëjnë.

Kështu i fola, por Shefka s'kish ndër mend të unjej:

— Që kur erdhe ti, në fshat hyri sherri, ja fëmijët në shkollë, ja rash e vdiqa, se vetëm atë hall kanë njerëzia, bagëtinë t'i lenë rrugëve. Pa le po u kishe bëre fytyrën me dhjamë të ndyri...

Hoxha vështroi nga qielli e fryu e pështyu sikur përzinte djajtë.

— Ti e di që po shpif, Shefkë, unë fëmijët i kam trajtuar si njerez dhe përpinqem për të mirën e tyre, unë u kam mjekuar dregat me ilaç të vyer që ua përthau ato...

— Po nuk më thua, përsë u kishe sharë hajmalitë?

— Këtë nuk e kam bërë, veç u thashë nipave tuaj se i kishin plot me thërija e këto duhej t'i tregonin në shtëpi.

— Në ua kemi vënë për shëndet, atë punë e dimë ne.

— E po unë s'kam ardhur për qejf këtu, s'kam ardhur të rri duarkryq, kur fëmijët i ha morri.

— Së përsë kë ardhur, atë s'e dimë...

— Edhe në mos e ditsh ti, mua aq më bën, por nëse ti kérkon të rrosh i kalbur në morrat, mua më takon të ta them se ti dëmton yeten dhe shoqerinë, ti je një farë prapaniku këtu që s'e kë shokun; por ta dish se unë nuk të lejoj të bësh si ta do qejfi.

Ai shtrëmbëroi mjekrën dhe brofi më këmbë me pushkën në dorë. Edhe vëtë vura dörën në revolver. Dëmika hyri në mes dhe ja rrëmbeu pushkën nga dora. Hoxha ngriti dëuart nga qielli.

— Allah! Allah! — bërtiti ai, — daleni, amani, mos me të rrëmbyer. Do t'i bëjmë një çare kësaj pune, as volltja jote, as e Shefkës do t'i mbajmë fëmijët në shtëpi e do t'u mësoj unë shkrim e këndim.

— Çflet kështu, mor derdimen, — ja ktheu Demka, — ti nuk di për vehte, gjer dje ishe pojak, sot na dolle i kënduar.

Shefka po dridhej mb'anë kupyit me koçanka dhe nuk vështronte fare këtej, shkoi pranë kalives së qenit dhe ja ngjeshi këtij me shkelm në turi:

— Plaç de i shkretë!

Hoxha po fliste duke tundur kokën si kone:

— Di unë, di, do t'u mësoj turçe, ju shkruani prapë.

E mblodha veten dhe mendova ku jam. Mendova se jam në një cep t'errët e të prapambetur të Atdheut tim. Medet, i thashë vetes, medet, tridhjet' e sa vjet kaluan qëkurse hordhitë e Xhavit Pashës thyen qafën pas pesë shekuj robërie që hoqëm. U shporr qysh atëhere pushteti i huaj i prapësisë dhe mjerimit, por ja edhe sot aksoma paska gjallë farë të asaj lëngate. M'u duk hoxha edhe më i lig edhe më i pështirë se i vëllaj. Po çfarë t'u thosha unë?

— Këtu, o njerëz, është vendosur pushteti i ri Nacional-Çlirimtar, këtu nuk urdhëron tjetërkush përvèç Këshillit të fshatit. Fëmijët do t'i dërgoni në shkollë, ndryshe e keni punën keq, për të marrët ka edhe të urtë. Kush nuk pranon të mirën me arësy, do ta pranojë me hosten.

Demka mori qëndrim dhe ai:

— Unë i dua drurët të shkurtëra, llafe shumë s'ka, ja do bëni si u themi, ja i vini gishtin kokës.

E ngriti zérin fort, duke tundur gishtin poshtë-lart. Duallëm nga oborri pa i përshëndetur.

— U nxohe, Demo, — i fola sekretarit në rrugë.

— Jo, more, e mbajta veten, veç zérin e ngrita, sepse kam një huq të lig, po arrinë të më kapin xhindet, s'mbahem dot, pastaj hapu fshat se të dogja!

Kur mbërrija në shtëpi, Merushja më dolli në çar-
dhak:

— C'je zverdhur kështu?

— Mos më dil gjithnjë përpara, Merushe, do ná
nxjerrësh ngatërresa, thuaji Ago Asllanit të vijë këtu.

Asaj i mori flagë fytyra e iku shkallëve duke qarë.
E' kuptova se qeshë nxituar në të folur. Kur u ngjit As-
llani më vështroi një copë herë pa më folur. Si duket i
la vragë fytyra ime e zbehtë. Thërriti një nga çunat që
lozni n'oborr:

— Shko, — i tha këtij, — shko i thuaj Shefkës të
vijë këtu.

Pas pak fëmija u kthye e tha se Shefka qe sëmurë
Plaku bërtiti me tërsllëmë: — Shko i thuaj të vijë se po
i vajta atje, do ta marr lidhur. — Nuk vonoi shumë dhe
Shefka u qas. E pashë që nga dritarja që po vinte si një
gen i rrahur, bënte sikur çalonte dhe pushkën nuk e
kishte në krah si ngaherë.

Plaku po shtërgonte oputat e opingave dhe ashtu si
ishte i kërrusur, gjaku i vërvshonte në kokë. Kur ngriti
kryet, sytë i kishte tërë gjak:

— Tungjatjetani!

Asnjëri nga ne nuk u përgjegj. Një hie shkau në
cardhak. Ishte Merushja.

— Si e ke punën ti, Shefkë? Do vish në brazdë me
të mirë, apo do të të fut unë me dobec?

Ai qëndronte i ndejtur në qoshkun e fundit të fro-
nit e më dukej sikur përdridhej si gjarpër.

— Folëëë! Ty të them!

Plaku u ngrit më këmbë i egërsuar:

— Do flaq, apo të të nxjerr si qen prej këtej bashkë
me tët motë!

M'u duk së puna po merrte një rrugë të papëlqyer.
Kurrë nuk e kisha parë Ago Asllanin aq t'egërsuar. De-
sha t'i flas, po kur i hodha një sy, ndrova mendje.

— Si të të them edhe unë, o xhaxha, po... efendiu
në e bëri këtë cen.

— Po ti vetë e ushqen gojën, apo të mëkon ai? Tjetër herë më s'flet xha Asllani. Hapt, mbushu që këtu!

RRETH VATRËS SHQIPËTARE

Një pasdite, kur hyra në shtëpi, vura re se në çardhak dielli hynte nga dritarja, i pandarë në hoje. Pra Merushja i kishte zhdukur kafazët. Pastaj ardhja Merushja me Asllanin dhe e ndezën zjarrin me kërcunj të trashë prej lisi. Unë lexoja një libër dhe e mora me mend se prisnin miq nga larg.

Por miq nuk ardhën e s'e merrja dot me mend se çfarë ngjiste. Pasdarke ardhën në odë gjithë djemtë dhe burrat e shtëpisë bashkë me Merushen. Kjo se q'bëntë disa shenja prapa shpinës sime. Nëpër çardhak kishte vajtje-ardhje. Asllani shihte dëndur nga dera e nënë-queshte duke tundur kryet.

— Hajdeni, moj! — thërriti plaku duke vështruar nga çardhaku. Atëhere e kuptova. Gratë dhe vajzat e shtëpisë deshin të vijnë tek unë. U ngrita dhe dolla në prag. Tri vajza u shtrënguan pas murit duke mbajtur grushët ndënë gushë. Merushja filloj të tërheqë për duarsh një moshatare të saj. Një grua fytyrëbardhë me rroba të zeza ishte nëna e Merushes, të tjerat ishin nuset e djemve dhe dy vajza të tjera të Rexhepit të vrarë.

— Ejani, urdhëroni zonja, edhe ju vajza, unë jam njeri i shtëpisë tashti.

M'u afroan të gjitha duke më dhënë dorën me radhë. Unë i kisha parë edhe herë të tjera, por shkarazi e me droje. Merushja vari një gjym në zinxhirin e kllanikut mbushur me misër për ta zjerë, pastaj sollën një kanistër me mollë. Gruaja e Rexhepit më ndëjti pranë e ma mori dorën në të sajat.

— Ta duash nënën, biro, t'i shkruash kartë gjithnjë se ajo këtu e ka mendjen, të ka fill të vetëm.

Nuseve dhe vajzave nuk u ik të kuqtë nga fytyra dhe druhen të ngrejnë sytë. Të gjitha janë veshur thje-

shtë, me fytyra të bardha, por asnjera nuk ka tiparet e holla të Merushes.

— Qënke shumë i shtuar, xhaxha, — i fola Ago Aslanit, — unë të gëzohem që e ke shtëpinë plot njerëz të mirë.

— Ashtu më rrofsh, o bir, po paskëtaj në të ardhë-shin çunat tanë pisanikë, mos më fol mua, por këtyre kokonave. Le që kjo shejtaneja nuk e turpëron xhanë...

Ai ngriti krahun e pushtoi Merushen dhe e afroj pas vetes. Vajza u shtruk me turp pas ijes së plakut.

— E kam ca bistër këtë çupë, — foli mëmë Esmaja, — i ati, ndjesë pastë, ja kishte frikën.

— Vërtet çupën e ke ca kapedane, por ka zemër të mirë. Unë e dua si ta kisha motër, ju të gjithë më pëlqeni, jeni njerëz të mirë.

Pastaj fjala shkoi thell' e më thellë, gjersa Asllani mori një pamje të rëndë. — Dëgjo, more Bardho, — ma pat, — gjithë këta burra që sheh, bashkë me çupat dhe nuset kanë një lutje për ty. Duan t'u mësosh shkrim e këndim; unë u them se ti ke plot punëra dhe andralla, por Merushja nuk tundet nga e saja.

Kur ktheva kryet, vajza dridhej e sytë i shkrepëtinin.

— Mirë, këtë punë do ta bëjmë këtu në shtëpi, — thashë, — por kam një konditë edhe unë. Duke filluar qysh nesër në mëngjes, të më dërgoni në shkollë edhe vajzat e vogla që mbanë në shtëpi.

— Do na vesh në sherr me fshatin, — ma ktheu xhaxhaj.

— Nuk u ve në grindje, sot nuk më mungoi asnje fëmijë, bile edhe hoxha i dërgoi të bijtë.

Zjarri me kërcunj dushku kërciste në vatër, gjymi llokotiste e nxirrte jargë, xixa shumë të vogla shkonin e vinin nëpër lilat e zinxhirit. Esmaja kish ngjeshur furkën në brez e tjerte një shtëllungë, ndërsa sepetit me mollë filloi t'i dukej fundi.

NËPËR RRUGËT E LUFTËS

Në palcën e një dimëri të rëndë u mblohdhën në Panjas gjithë njësitë partizane të qarkut. Edhe në odën tinte erdhën dhjetë shokë. Dy shoqe partizane se ku i pat gjetur Merushja dhe i mori në dhomat ku banonin gratë e shtëpisë. Ishte hapur fjala se gjermanët dhe ballistët do lëshonin një sulm të gjerë kundër forcave tona. Ishte ai sulm që në histori hyri me emërin «Operacioni i Dëmërit».

Dolla nëpër fshat dhe takova shumë shokë të njojur... Veshjet e partizanëve ishin të pakta, por askush nuk ankohej. Disa i kishin mbështjellë këmbët me mušama e lecka, por edhe këta syrin e kishin pishë dhe këndonin si gjithë të tjerët. Mendova shumë gjëra në atë rast: Ku ishte gjëndur vallë një rini e tillë trime dhe heroike, kush mund ta merrte me mend se një popull kaq i vogël ruante përbrenda heronj të këtillë! Ku vallë ish gjendur ai vrull dhe entuziazmë? Që nga vërshoi ajo valangë e papërbajtëshme? Si u formua? Kush e vu në rrugë?

Në një kohë dëgjova emrin tim. Më thërriste komisari i qarkut. Ai ndodhej në shtëpi të Demkës dhe po më bëzante që nga dritarja.

— Kam dëgjuar shumë gjëra për ty, — më tha, — që asaj dite kur të çuam këtu, që kur të pashë atë kaçurrrelin që të rri si çekan mbi ballë, mendova se je një djalë i zoti dhe me vullnet.

— Kam bërë sa kam mundur, shoku komisar, — ja ktheva.

— Të bënin të gjithë nga kaq... po nejse, nja tre orë larg prej këtu, në katundin Gurazes, te komandanti i njësitet, na ngelën disa dengje me fletore shkolle. I patëm nxjerrë nga qyteti për shkollat këtu rrëth. Po munde tërhiqi.

Dhe, papritur përgjigjen time, ai më ktheu shpinën dhe futi kryet në kamaren e dritares ku ishte shtritur një hartë.

Renda në shtëpi. Ago Asllani, me gjithë djem e ni-

pa, i kishin nxjerrë plloçat prej pullazit, pastaj po skulnин edhe trarët dhe dërrasat.

— C'është kështu?

— Do t'i futim në dhe — ma ktheu plaku, — armiku tek mua e ka synë, do ta zbrazim shtëpinë e me gjithësoj do mbartemi në kalibet e malit.

Unë i tregova rrugën që do bëja gjer në Gurazes. Ai la mënjanë qysqinë dhe vështroi përpjetë nga qielli, (kështu e kishte zakon kur mendohej).

— Prit — më tha pastaj, — do vemë bashkë, ja sa të nisen fëmijët pér në pyll. Edhe plaçkat e tua i ka ngarkuar Merushja bashkë me tonat.

Afër mbrëmjes filloi zbrazja e fshatit, kollona të gjata fshatarësh po ngjiteshin përpjetë. Gratë kishin vënnë pérçet mbi fytyrë, burrat kalonin përpara me lopata nér duar e çelnin monopatin e dëborës që mos fundosnin kafshët. Pastaj u nis edhe kollona e Ago Asllanit. Giçi i vogël nuk desh të hipte mbi mushkë e rendte mbi dëborë. Nga gratë e shtëpisë «sime», veç Merushja me të jëmën nuk e kishin të mbuluar fytyrën. Vajza diç pëshpériste me dy shoqet partizane e s'po ndahej dot prej tyre.

Pastaj filluan të kalojnë kollonat e partizanëve në gjitha drejtimet, kaluan edhe njësitët e fshatrave, grupet e intendencës, ata të prapavijës. Me muzgun u nisa edhe unë me xhaxhanë. Plaku më hoqi skërkës e rungajave. Nxori këpucët dhe i vara në qafë, dëbora më mbante sipër pér bukuri. Në një majole takuam një tuftë partizanësh. Njëri e njobu xhaxhanë dhe i foli:

— Ti je kryetari i këshillit të Panjasit! Para shtëpisë sate, atë ditë kur t'u vra vëllaj, gjetëm dy ballistë të vrarë me një plumb. Eh! Të kisha atë syrin tënd!

Me natën e ftohta u bë më e ashpër, se qielli ishte i kthjellët dhe veriu vërvhellente përrenjeve. Kur u ngjitim më lart dukej një pjesë e fushës, në xhadënë e madhe rendnin dritat e autokamjonave.

M'banë një fshati dëgjuam zhurmë e trazî hingëllin kuaj e çape të rëndë zvarrise shin rrugëve. Ish she-

nja se armiku kishte filluar lëvizjet drejt malësive. Nga Qafa e Martit krisi topi, një tjetër iu përgjigj nga fusha. Dhe unë merrja me mend se n'atë natë me kallkan e susterinë, të dy palët në ndeshje po zvarriteshin drejt shtigjeve ku në mëngjes do ngjiste përlleshja. Afër mesnatës pamë disa xixa që dollën nga kreu i një kodre. Atv afër ishte fshati. Në një farë vendi dëgjuam rrahjet e një çekani, çapet na godisnin më butë nér kupa plehu, kishim arrijtur në Gurazes.

— E sheh atë drithë? — më foli xhaxhaj, — atje është një farkë kovaç, eja t'i vemë.

— Nuk është mirë kështu, më mirë hetojmë një herë.

— Eja, mos ki droje, kovaç ai, e ta dish nga unë, ballist evgjit nuk ka, fukaranë nuk e lidh gjë me agallarët, pastaj ata nuk begenisin kurbatët.

Shtytëm derën e vogël të kovaçanës.

— Vdekje fashizmit, shokë!

— Aaa? Lëshoi mashën mbi kudër e me shpinën e dorës fshiu djersët.

— Dollën t'u luftojnë maleve dhe ju zbritët në fushë?

Dhe pas pyetjeve tona, ai vijoi:

— Nga fshati mos kini frikë, sot dogjën këtu tri shtëpi partizanësh, ballistët bënë edhe plaçkë. Por unë fukaraj e kam mendjen maleve, topi s'ka të pushuar e nuk më ze gjumi, kam djalin andej, ndofta e njihni, e quajnë Kaman, njihet nga lëkura. Gjynah që nuk e njihni, do me sillnit një lajm të mirë. Na heqin si frikashë e na përbuzin ne, por ja edhe evgjiti del partizan!

Ai mbushi lopatën me kaçavel dhe e hodhi mbi zjarr.

— Ngrohuni, shokë, ngrohuni, jeni nxirë nga fityra prej ciknës.

E dërguam kovaçin të na sjellë dengjet me fletore e pas pak u ndje një zvarritje mbi dëborë. Atëhere ne ishim ngrohur e çlodhur. Falënderuam kovaçin, u ngarkuam me dengjet dhe sërish u vumë në rrugë. Por në

kthim shtegtimi na u duk më i gjatë. M'uënjtën këmbët nga ngrica dhe filloj të më djegë gjoksi nga lodhja. Afër agimit mbrrijtëm te Pérroi i Hysit. Kur u dha dita ishim në kalibet e Panjasit. Hasëm rojet, por çapin e qëndruam veç para kalibes së Ago Asllanit. Të gjithë po flinin e vec mëmë Esmaja po gatitej të ndezë zjarrin. Kalibja ishte prej gardhi, e mbuluar me fjer e pérbrënda e lyer me humbë.

— Ardhe, o Aga? Ej, Zot i madh! Nuse, çupa, ngre-huni moj, ardh Agaj me Bardhylë.

— Hë moj, ndize zjarrin e urdhëroi plaku, — u gdhi tashti, s'ka gjë.

U shtruam shesh para zjarrit me shpinë nga njerëzit që po ngriheshin prej gjumi.

I SËMURË ME PLEVIT

Dy muaj ndejta i dergjur në shtrat. Sapo u ktheva asaj nate nga Gurazezi më hipi ethja në kokë. E ndjeja veten të lodhur e të dërmuar. Me gjithë këto u mbajta më këmbë tri-katër ditë. sa u larguan forcat e armikut. Po pastaj më filluan sëmbime në gjoks dhe kolla nuk më ndahej dit e nate. Khaxhaj më rrinte te koka, aty nga kreu i kalibes, dhe Merushja hidhte sytë nga unë, or e çast. E kuftova edhe vetë: kisha marrë plevit. Pas ndonjë javë e gjithë familja e xhaxhajt, si edhe gjithë fshati zbritën në Panjas, por meqë gjendja nuk ishte e sigurt nga lëvizjet e trupave t'armikut, e gjetëm të udhës që unë të qëndroj në kalibet. Me mua ndeji dhe mëmë Esmaja. Për dy muaj me radhë, ajo më shërbeu si të fishte nëna ime. Nuk besoj të ketë në botë nëna kaq të dhëmbshura dhe njëkohësisht kaq trime si nënët tonë. Mëmë Esmaja e mbante gjithnjë pushkën pranë. Në çdo zhurmë, ditën a natën ajo kapte armën dhe atëhere fytyra e saj merrte një pamje të rreptë e trimërore. E unë isha i sigurt se asnë armik nuk mund të më afrohej mua, pa kaluar më parë mbi trupin e saj.

Gjatë gjithë sëmundjes nuk pata asnë ilaq për lëngatën. Pra, u mjekova me ilaqet e Ago Asllanit. Ai më dha të pi një masë gjalpë të ngrrohtë dhe unë e piva. Më dha një lëng të trashë të gatuar me guaska vezësh e lëng mollësh. Edhe këtë e kapërdiva, po kur u keqësova një herë më sollën «alipsanet e Çoban Babajt». Ato as pranova t'i shoh e jo pastaj të pija ujët e kaluar nëpër to.

Një pasdite më ardh Merushja. Ishte ngjitur bashkë me plakun. M'u duk se ardhja e saj më bëri më mirë nga të gjitha ilaqet. Ajo mundohej të fshihe lotët dhe dridhej e tëra.

— Si je, vëllaçko? — më pyeti.

Unë i zgjata dorën dhe i fola për nënën e saj aq të mirë dhe bujare. Fytyra më qe kthjelluar dhe nënë-qesha i gëzuar. Dhe kur unë qesha për të parën herë pas aq kohe, i pashë të dyja ato që derdhën lot ngazëlli-mi.

N'atë çast më erdhën lotët edhe mua. Nuk është turp ta them. Burri nuk qan në luftë, burri mbahet si trim në çdo rrezik, po kur zemra e burrit ndesh në zemra kaq të dlira e fisnike, atëhere shpirti i burrit nuk i përbahet dot as vajit e as mallëngjimit.

— Mëmë Esma, — i fola — ti je gjallë si nëna ime, veçse ti je më trime.

NJË DASMË E PADËGJUAR

Sapo ardh pranvera, filluan të avullojnë tokat dhe kumbullat u ngarkuan me lule të bardha. Ago Asllani delte anash lumit e priste degë shelgjesh, delet lëshoheshin aty e hanin krëndin e njomë. Gjatë dimërit brana e luftës kaloi e ashpër dhe shkakëtoi shumë vojtje e mjerime. Unë fillova sérish të mbledh nxënësit e mi dhe pasditeve vazhdoja mësimin me njerëzit e shtëpisë të Ago Asllanit. Por pranvera më solli edhe kokëçarje të reja. Mungonin nxënës ditë e përditë. I shihja nga larg tek shkonin për

të kullotur lopët, i shihja me sopata në krah, duke ngarë gomarët e ngarkuar me pleh. Xhaxhaj dhe Demka bënин sa u mundej, po përsëri mungesat vijonin. Disa herë rendja vetë korijeve duke ndjekur nxënësit që i dërgonin në shkollë, por ata fshiheshin në pyll duke këruar folë zogjsh.

Një mbrëmje sapo u ktheva në shtëpi Merushja më dolli përpara në oborr:

— Dasmë, Bardhyl! Kemi dasmë, të ënjten marrim nuse në Gjuras!

Asllani martonte njerin nga djemtë e tij.

Kur hyra në odën time, vura re se kishte miq. Përveç tre katër burrave të fshatit, kishte ardhur edhe një baba dervish teqeje. Ky ishte një goxha burrë i madh si gollogozdrun, me një zverk të ngjeshur, që i skuqte nga gjaku i tepërt. Ish gjithë tul e dhjamë me një farë festë jeshile e raso të bardhë. I zura të gjithë përdore si njëri-tjetrin, por vura re se baba dervishi nuk mbet i kënaqur nga ngjatjetimi im. Sepse sa njerëz hynin e delnin aty, i bënин një sërë temenash duke i puthur pëqirin dhe një farë sumbulle prej fildishi që mbante të kumbisur në brez. Baba dervishi na paskëshe qënë mesiti i dasmës dhe medoemos pér nder të tij u shtrua një sofër me tre qëngja të pjekur dhe u derdh rakia si lumë. Nuk di si u rrokullis ajo natë e ethëshme, (kështu do ta quaj), por mbaj mend mirë se afër agimit, të gjithë burrat dhe djemtë që morën pjesë në orgjinë u përbysën shakull përdhë. Unë ishë hequr mënjanë dhe mbaja sehir. Kish ngelur sycelur veç Ago Asllani me baba dervishin. Por edhe ky nuk vonoi dhe u përbys megjithëqë diku hapte sytë dhe nxirrte nga gurmazi një thirrje të ngjirur. Atëhere u ngrit Ago Asllani, zbriti poshtë në ahur e solli me vete një poçe të vjetër e të zezë. I vulosi të gjithë me nga një njollë katrani në ballë, kurse baba dervishit i kalli në gojë një copë presh. Pastaj m'u qas mua, më kapi pér qafe dhe filloi të qajë. Kundërmonte i téri pleh dhe raki. E pështeta pas sofatit të oxhakut pranë baba dervishit. Ky po fliste përcart, po copën e

preshit nuk e shkulte dot nga goja, pa e ndukte si ta kish llokmë. Baba dervishi zgjati dorën e vu mbi kokën e xha Asllanit dhe filloi t'ja tërheqë flokët dhe ta kruajë. Plaku shfryu me inat:

— Pse, ore, më ngjet kokën?

— ... unë, unë kruaj kokën time, more..., ja ktheu baba dervishi.

— Ç'kokën tënde, more matuf, nuk shikon?

Baba dervishi ja hoq dorën nga koka dhe zu e fuste pëllëmbën nëpër një të çarë të dyshekut, ku dukeshin çefla misri. Duke kërkuar nëpër dyshek, ai mërmëriste:

— Kokën, xhanëm, ku e kam kokën time? Ku më vajti e shkreta, ku?

Por asaj nate dëgjova edhe gjëra që nuk i dija. Dëgjova zakonet e lyesive dhe të dasmave të asaj krahine, dëgjova baba dervishin që fliste serbes si një xhambaz i vërtetë njerëzish.

Nesëret në mëngjes u mblohdhën të gjithë krushqia ndënë gorricën e madhe. Për kokat e rënduara nga rakia e natës u pinë kova të tëra me hirë dhe u përtypën disa kurorë qepë. Vura re gratë e shtëpisë që ishin llangosur me kënà që nga flokët e gjer në 'thonjt' e duarve. Prita të shoh Merushen të kënosur, por u gabova. Ajo dolli si ngahera, veç vetullat i kishte nxirë me mazì. Rinte në dritare e mbante sehir. Fytyna e saj ndrin nga gazi e nga shëndeti. Fletët e njoma të kaçkës lozin mbi faqet e saj e ajo duket atje si një mollë anurkë në krye të degës.

Ndër krushqitështë edhe Demka me Shefkën. Ky kish vënë një kapellë xhandari; të gjithëve u foli, por mua bëri sikur nuk më pa. Syt' e tij të djallëzuar çakërroseshin dëndur nga Merushja, por ajo e shihte me inat. Shefka ish prerë ndënë buzë me brisk, si duket ish munduar të rruante edhe qimet e ashpra të gropëzës, që kish në mes të mjekrës.

Kur u nisëm, dikush ja mori këngës:

O m'u thaftë ajo këmbë,
Kur të hip kalin,
Të énjen e madhe, o më marrin ...

Filluan të ngrihen dolli hipur mbi kuaj, urimet ven e vinin e koburet kërcisnin n'erë.

Përpara shkonte Ago Asllani mbi një kalë cil, më thirri t'i vinja në krah dhe e përzuri Shefkën. Më tutje u desh t'i ndrojnë pelën baba dervishit. Dëgjova xhaxhanë që i foli dikujt:

— Jepini një kalë tjetër babajt se na e xhabatasi pelen, do na shtjerë në mes të rrugës.

Gjurasi mbante katër orë rrugë dhe e gjithë koha kaloi me këngë e dolli. Por sa iu qasëm fshatit të nuses na dolli përpara një mesoburrë. Ai qe i fshehur në pyll e na preu rrugën duke hyrë në mes të kuajve që i patëm lëshuar në revan.

— Me lejë, o shokë, me lejë, o zoterinj. qëndroni o agallarë!

U mblodhëm rreth tij.

— Mos hyni në fshat, se ka ardhur një çetë e Ballit e u ka ngritur pusinë. Pastaj edhe punën e krushqisë e prishën. I ati i çupës éshtë me krahun e Ballit dhe ka vendosur mos u japë të bijën. Unë jam kryetar i këshillit në Gjuras!

Ago Asllanit sikur i ra çerja e vdekjes. Baba dervishi i vari buzët e iu nxi surrati. Edhe kuajt nuk hingëllinin më. Të gjithë vështronin nga babaj i teqesë. Ai u mendua një copë herë, pa luadhet për anash, ngriti sytë nga qielli, e pastaj, serbes, e mori fjalën:

— Ti, o mik i mirë, shko në punën tënde dhe i thuaj ati qenit të pabesë që këtë turp do ma paguajë rëndë

Pastaj, si iku i huaji, na u drejtua ne:

— Në Kazaç këtu afër éshtë një besniku im i zemrës, ai ka një deli çupë për të martuar. Vemë e marrim atë dhe e mbyllim këtë punë, mikun e quajnë Meleq Mulliri.

Nuk m'u durua dhe ndërhyra:

— Kjo nuk eshtë punë që bëhet, ne martojmë dy njerëz, nuk kemi dalë të blejmë mëshqerra në pazar, kjo që thotë babaj nuk eshtë, as e arësyeshme. as e njerëzishme.

— E ç'prish punë? Nuse nga Gjurasi a nga Kazaçi, gjithë njëlloj eshtë.

Ky ishte Shefka që foli.

— Këto janë fate njerëzish, pa u njohur, pa u parë!

— Sikur këtë që do merrnim e kish parë njeri? Kjo eshtë puna e baba dervishit dhe ai vendos.

Të gjitha fjalët e mia shkonin kot. Nga sa kuptoja unë halli ishte se u vinte turp të ktheheshin bosh në shtëpi. Shefka s'kish të pushuar:

— Do mbetet fjala për jet' e mot; Xha Asllani u nis krushk e u kthyte pazarak. Ku eshtë nderi e namuzi i tij?

Desha, s'desha shkova edhe vetë me çetën e krushqeve. Qëndruam në të hyrë të Kazaçit. Baba dervishi me Shefkën hyri në katund. Pas ndonjë ore u khye vet i tre-të. Buzët e trasha të babajt ishin të lyrosura me jahni. Kishin sjellë me vehte babanë e vajzës.

— Dera e Asllanit eshtë derë e parë në Panjas, oxhak i madh e i dëgjuar, shtëpi pushke!

I riardhuri dëgjonte, hapte duart, dyzonte. Asnjë pyetje nuk u bë për djalin, në ishte i madh a i vogël, në ishte i saktë a sakat, çfarë bënte e çfarë punonte. Zura kokën me duar dhe rashë në mendime:

«Medet! Edhe për kafshët diç pyesin në pazar. Po të paktën për vajzën përsë nuk pyesin? Kjo eshtë e qartë: S'mund të merren nëpër gojë cilësit e një çupe, s'ka turp më të madh».

Por ajo që më ishte e pabesueshme u bë fare e qartë. Vajzën nga Kazaçi e bënë gati shpejt e shpejt dhe e hipën në kalë. Po cila ishte dhe si ishte, askush nuk e pënga ne. Veç Shefka e kish parë dhe e kish pëlqyer. E pëlqeu krushku për hesap të krushkut.

Vajzën e kishin mbuluar fund e krye me një mutaf. Dy kunetësit e rinj e mbanin për krahu. Zura mendoja!

Vajzë fatkeqe! Ku ishte gjë një orë më parë? Çfarë

bëje e çfarë mendoje? Ku bridhnin mendimet e tua? Me se po merreshe, o motër e gjorë, a të shkonte mendja se vinin krushqit të të marrin? Po a e di se ku po shkon? A ta thanë emërin e tit shoqi?

M'u ngrohën sytë dhe më ardhë vaji në grykë. Iu afrova Ago Asllanit, Shefka më ndoqi pas si një hie e ligë:

— Xhaxha, të lutem nga zemra, të paktën dëgjomë tashti. Është behar, asaj së ngratës do t'i zihet fryma, të lutem...

Shefka mblodhi buzët, pipa prej bakeliti me një të lidhur si shkelekë, i dridhej në gojë. Xhaxhaj sikur nguroi i zemruar e ja bëri me kokë djalit të madh:

— Hiqjani mutafin, ty ore të them, hiqjani!

Nusja e gjorë u drodh e tëra dhe filloi të hapë e të mbyllë qepallat shpejt e shpejt nga drita e fortë. Ishte një femër rrumbullake, me supa të shëndoshë. E kishin lyer mos më keq me shafran të bardhë dhe të dyja mollët e faqeve ja kishin ngijyer me nga një rrotullame të kuqe.

Nëna ime dhe babaj
Me lot po më qajnë,
Të ënjten e madhe, o më marrin!

Ajo ishte një prej atyre mijë e mijë vajzave shqiptare që ishte rritur pas kafasit, si një kece në çark. Kjo ishte një prej ato që priste vjete me radhë gjersa të kujtohej baba dervishi se çupa e Estrefit apo e Shabanit u rrit. Se kështu ndodhë nér malësitë tonë: Baba dervishi duke qënë mik ndonjë natë, tutje nga kolonja a Dangëllia, si ai grykësi që e ka çanakun bosh dhe tretet e zë lëpin gishtat pas çanakut të botës, fillonte dhe e hapte tefterin e lyesive. Çelte buzët e tij të trasha si prej gorille, fërkon-te zverkun e tij si me gdhënj e lëshonte vendimin: Për djalin tënd, o Shabanà, allahu sikur ma thotë në vesh, ka një deli çupë Demir Stënga, nga Gurasi i Gorrës. Shabanaj do këcente nga vendi e do qëllonte tepsinë me mashë në shenjë gazi, do përpinqte duart që të afroheshin gratë, (se gratë i dalin kurdoherë baba dervishit e nuk druhen prej tij, domosdo njeri i Zotit), pa do sillnin

sherbetin dhe mjaltin sa të piqej milori në hell a dashi
në furrë. Dhe një ditë përej ditësh do vinin kruhqi nga
dy, tre dit rrugë, njerëz të njojur, veç nëpërmjet baba
dervishit, (i paçim uratën e i puthshim stekun), do të bëp-
nin në kalë Merjemenë si një thes me kashtë mbuluar më
mjuaf e do ta shpinin te bërrri i parojohur.

Nëna ime dhe babaj
Me lot po më qajnë,
Të ënjten e madhe, o më marrini

PO TURQIA NGA RËNDON?

Kishte ardhur vera, koha e të shirave, më mungonin
gati gjysma e fëmijëve. Një pasdite dolla, nëpër ara të
kërkoj nxënësit. Por rruga më hoqi thellë e më thellë
gjersa takova diçka krejt të papritur.

Në një arë me urof, një fshatar po priste një goricë.
Druri dridhej e tundej dhe trualli ishte mbushur plot me
gorica të vogla. Më tej ishin të tre çunakët e fshatarit,
nxënës të mi. Njëri kulloste lopën për porozhde, sa më
pa mua u unj më bisht prapa ferrës; i dyti kosiste jon-
xhën me një stërmundim të tepëruar, kurse i treti po
hapte hendek me bel.

— Puna e mbarë, xhaxho!
— Mirseardhe, mësues!

Ai la sopatën dhe m'u qas, kokën e mbante unjur si
njieri i zënë në faj. Nxori kutinë e duhanit.

— Ke të drejtë zotrote, mësues, ke të drejtë, po ja
ore të shkretën, nuk na lënë punët, ta marrë e mira, ta
marrë!

I fola dhe i shpjegova, dhashë gjithë arësyetimet, dhe
këshillat e rastit, por ai gjithnjë kokëgdhë.
— Fundja fundit ç'u duhet këndimi cunave të mi?
Ku do të venë ata? Edhe pa të e bëjmë. S'është keq të dix-
nës po... Unë kam dëgjuar se të kënduarit agatërohen
me politikë dhe i ndjek qeveria. Sa për hesap? E ku do

kenë djemt' e mij aq para sa t'u duhet t'i bëjnë hesap? Djalin e madh e kam partizan. Të shohim se ç'do dali prej tij, të shohim se ç'do na nxirrni edhe juve. Ne në baltë kemi pér të vdekur, ja kështu si kemi vdekur brez pas brezi.

— Jo, — i thashë, — nuk u lëmë më në baltë, e gjithë kjo luftë, kjo përpjekje ka pér t'u nxjerrë ju nga mjerimi e padija.

Ai shpërvishte buzët. Befas kérceu:

— Po Turqia nga rëndon?

Prapë avazi i Mukës!

— E ç'punë kemi ne me Turqinë? — i thashë, — ne këtu kemi atdheun tonë, ne jemi shqiptarë. Turqia na katandisi mos e më keq, na shtypi pesëqind vjet...

Fshatari zu mendohej. Pastaj ma pat:

— Më there me pambuk, zoti mësues, ma hëngre kokën me të mirë. Hajde le të bëhet si thua ti, edhe mua ashtu më pëlqen po... nesër do t'i çoj djemtë në shkollë, kështu më foli edhe ai shoku yt, ai partizani im, do t'i çoj, do t'i çoj...

DIKUSH NA PAGOI TË TË VRASIM...

Duke vijuar rrugën nëpër ara ardhi mbrëmja. Era e maleve më tërhoq dhe eca gjithnjë pas gjelbërimit anës së lumit. Dolla nga rruga e malit e po shkoja thellë e më thellë. Kisha dëgjuar se atyre anëve ishte një farë liqeni mjaft i madh dhe desha të arrij atje. Nuk vonova dhe mbrrijta atje. Fushëza para liqenit ishte e mybutur në një gjelbërim të thellë. Nuk ishte tamam liqen, ishte më shumë një farë kënete e mbushur me kallame e shavar. Presat e tyre fërkoheshin e lëshonin një zhurmë që i ngjiste më shumë fërkimit të dy xhameve. Dhe nga gjithë anët ngjitej kuatja e bretkocave që ulërinin pa pushim në një kor të çakërdisur e të paprerë. Ajri ishte i mbushur me lagështirë dhe këmbët më shkelnin në vallto. Tufat e shavarit ishin rritur aq shumë sa qenë përhapur grumbuj-

grumbuj nē formë harqesh. Me perëndimin e diellit dukeshin larg njerëz që rendnin e dukeshin si milingona tē vogla që fugojnë nëpër gëmusha. Andej tringëllinin zile kuajsh e dalngadale tek u err u dukën flakët e një zjarri që i bëri si pasqyrë ujrat e kënetës.

Papritur një fishkëllimë mbi kokë, edhe një e dytë, edhe një e tretë. Ngrita kryet dhe vështrova anash. Dikush po më qëllonte me prazhdë. Nëpër muzgun që bin te pashë diku pas një koçkori një këmbë tē vogël, trupin e atyre këmbëve e mbulonin ferrat. Ai bëri tē ikë më tej dhe unë e njoha. Ishte një nga nxenësit e mi. U lëshova pas tij që ta kap. Më hipën xhindët në kokë dhe vendosa ta zë me doemos. Ndiq këtu e ndiq atje, mendoja se ai do lodhet para meje e do qëndrojë, por ai ishte i shkathët e ikte drizave si një ujk i egër. Papritur drizat e pyllit lëvizën më lart. Hodha sytë andej. Dy njerëz tē armatosur dollën në një padinë. Përkrahu zvarrisnin Selmanin e vogël që po e ndiqja. — Oj! g'janë këta?

Të panjohurit ishin si njëri tjetri, si tē qenë vëllezër, veshur keq, me feste tē zeza në kokë.

— Tungjatjeta, zoti Bardhyl!

— Tungjatjetani!

— Të sollëm këtë çunin, mezi e kapëm, na kafshoi edhe duart, ne tē pamë që e ndiqje, ja ku e ke.

U kërrusa mbi kalamanin:

— Pse u bëre i këtillë, Selman? A kështu tē mësova unë kaq kohë? Ti ishe i mirë, ti mësove shkrim para shumë tē tjerëve. Folë, Selman, folë.

Ai mbante kokën ulur dhe nuk përgjigjej kurrsesi.

— Mirë, Selman, u pa puna, ti do mbetesh njeri i egër dhe i lik, ke një muaj që s'po vjen në shkollë, pra dil këtyre maleve dhe bëhu hajdut, ndonjë ditë do rrähesh kokën me grushte, por do jetë vonë, ikë Selman, ikë...

Duke shtrënguar një tufë komi ndër duar, ai u largua tura-vrap. Ngrita sytë nga tē panjohurit. Njëri ma pat:

— Ti e dërgove, ndër, ne, demek!

— Aaa... juve... kush jeni ju?

E mori fjalën njëri syresh:

— Njerëz si na sheh. Mbase do të thuash me se merrimi? Por më parë duhet të të themi se ne jemi njerëz që na ka marrë lumi me kohë.

U unjëm pas një drize prej ahishte në buzë të kënetës.

— Jemi vëllezër, rifilloi sërisht ai i pari, kishim bërrë një vrasje vjete të shkuara për punë nderi. Ndejtëm tre vjet në burg gjersa u aratisëm kur ardhja Italia. Pastaj mbetëm kaçakë në mal dhe nisëm një zanat që është shumë i poshtër. Ta themi vetë, e pse ta fshëhim? Ti, fjala vjen, ke nevojë të vrasish hasmin tënd, na paguan neve dhe ne e vrasim.

— Shqiptarë jeni juve?

— Shqiptarë, si na sheh e si të flasim. Nga qelli nuk kemi zbritur. Ne kemi pasur të bëjmë edhe me ty.

— Me mua?..

— Po, po, Na vuri dikush të të vrasim. na dha edhe kaparë.

— Khelo Tapia?

— Jo ai, qe një tjetër. Ne nuk të gënjejmë, ne jemi të çiltër, mos ki droje prej nesh e mos u habit. Po para se të të vrasim pyetëm një fshatar. Ç'je, nga je, e qysh, e si, e pse. Na thanë se je mësues në Panjas. Kjo na u duk një punë e ndershme. Ne nuk dimë as të vemë im-zanë, por sidoqoftë, mësimin e duam. U mejuam: Ky djalë ka lënë rehatin e tij dhe vjen të mësojë këta pisani-kët e Panjasit. Pastaj na thanë edhe se je njeri fukara. Por me gjithë këto, ne kishim marrë kaparin dhe ta ngritëm pusinë një natë. Ti ishe vetë në shkollë, kishe ndezur llambën me gas e diç shkruaje në trapezë. Por më shumë mendoheshe, mendoheshe e sikur qeshje me vetëveten. Të mbajtëm sehir një copë herë, kur po trazoje disa si gjemba eshi e si dhëmbë dosbale. Ata që kemi përcjellë nga kjo botë, pak a shumë kishin ndonjë faj, bie fjala ishin rrashur me myshterinë, ishin sharë apo qëlluar. Po ky, thamë me vete, ky përsë të vdesë? Se

vjen t'u hapë sytë qorrave? Ja kështu nuk të vramë dhe e kthyem prapsht kaparin».

Më shkuan të ngjethura në trup. Vështrova anashë e sikur nuk u besoja syve të mi, mendova se mos qeshë në ëndër.

— Po kush u vuri të më vrissni?

— Ne jemi njerëz të liq, — m'u përgjigj ai i pâri, — jemi të liq, por jo të pabesë, nuk mund të ta themi kush, veç një këshillë do të të japim, ti je partizan, je komit. Pleqtë thonë se komiti që ngatërrohet me grë e ka davanë të humbur!

Kafshova buzën e poshtme me dhëmbë dhe mendja më rendi te Shefka.

— Pastaj si kthyem kaparin ja thamë troç atij has mit tënd: Po pësoi gjë ky njeri, ne do të të kallzojmë ty. Por ne kemi një qëllim që të hasëm sot, kemi dashur të të takojmë me kohë se na kanë thënë që je njeri me mend.

Ata çelën një qese duhan dhe filluan të dredhin cigaret. Mendimet po më shponin kokën si një turjelë:

«Të më pyeste njeri t'i nëmëroja zanatet që ka bota, do t'ja nëmëroja një për një, po kurrë nuk do të më shkonte ndër mend se paska një zanat të tillë. Këto që dëgjoj duhet t'i shkruaj dhe do t'i shkruaj, nuk do t'i lë pa ja thënë gjithë Shqipërisë, do t'i shkruaj për brezat e ardhshëm, ta dijnë ata, ta lexojnë, se brezi i ynë trashëgoi një atdhe të mjeruar, prapanik, të varfér e injorant, t'u them se te liqeni i Panjasit takova dy vrassës profesionistë, t'u them se raca, raca jonë, u qe besuar hajmalive e nuskave, t'u them se malësorët tanë ushqeheshin me misérnikë të mykur, t'u them se plagët e dregat i pllakos-nin me të pëgërë, t'u them se gratë e këtyre anëve lindnin fëmijën duke tërhequr një povoj leshi lidhur në trë, t'u them se shqiptari flinte përtokë, t'u them se hoxhallarët e babadervishët ishin mbretër nér fshatra. Do t'u tregoj se Qamili vdiq në një gropë dhe lotët i qenë bërë akull, do t'u kallzoj se vajzat tona i mbanin brënda të mbyllura si në burg, t'u them se më hidhnin bajga në shkollë, se

më bënë magji, se më qëllonin me prazhda, vunë njerëz të më vrasin, do t'u tregoj se haznat e pleqve ishin martina e shishëna. Do t'u tregoj se në Panjas, në mes të popullit të varfër e të prapambetur hasa një vajzë që më mahniti me bukurinë, me ndjenjat dhe virtutet e saj. Por do t'u them se brezi ynë shpërtheu si një valangë e paparë ndonjëherë, patëm djem trima e sypatrëmbur, populli i tërë rendi me ne, Shqipëria u kthyte në një front lufte. Ñe fituam!»

Vrasësi që kish marrë fjalën po fliste me një hidhërim të thellë, kurse vëllai i tij ish mbledhur kuspull me kryet futur midis supeve e shtrëngonte mjekrën midis gjunjëve.

— Ç'na vështron kështu? Edhe ne njerëz jemi. Mua më quajnë Rakip, vëllanë Malkë. Prej nesh dridhen këtyre anëve, po si të të them? (ai çeli pëllëmbët e shtrëmbëroi fytyrën sikur i vinte trazi) na u rëndua jeta, na ndjeakin, na mallkojnë. Por ne duam të vijmë me ju, duam të vijmë partizanë. E dimë se në luftë do vritemi, doemos, ne na ndjekin edhe «plumbat e topave», si u thonë, por edhe kështu si jemi ne do vdesim shpejt. Po më mirë le të mbarojmë si njerëz, le të ngjyhet emri ynë me një farë nderi, le të thuhet se edhe ne më në fund vumë dorën në zemër. Arratia na e ka sjellë shpirtin majë hundës, shpirti na është ngarkuar me shumë gjak. Na u mërzit jeta. E di ç'do me thënë të rrosh gjithnjë me kokë në torbët, nënë një ankth të paduruar, pa miq, pa shokë, pa familje, pa shtëpi, pa grua? Mund të rrojë mashkulli pa grua gjithë jetën? Pa mendo, ne jemi të rinj. Dendur qëndrojmë thellë pyllit si dy kafshë të pështira, qëndrojmë pas drizës me orë të tëra pa folur, bile edhe pa menduar. Na vjen uria, por nuk hamë, na është bërë jeta helm. E përse rrojmë ne? Edhe kafshët e pyllit kanë gazet e tyre. Dash mos beso, por ta dish që na vjen keq për egërsirat e nuk i qëllojmë më, nuk i vrashim, i lëmë të kalojnë. Shohim që edhe ato kanë gazet e tyre kur çojnë këlyshët, kur kapin gjahun dhe e shpien në strofkë, kanë

edhe ato ndijesit' e veta, vjen shkurti ndiqen, kanë femrën e tyre, ndijesit' e veta.

— Po mirë, — ja ktheva, — po a keni besim juve në luftën tonë?

— Besim, thotë! E si mos kemi besim! U mbushën malet plot me djem, gjermani mori tatëpjetën, Balli k-tandisi mos e më keq në plaçkaxhinj e kallauzë, ata s'kanë si të fitojnë, se nuk janë të ndershëm as në luftë e as në fjalë. Krerët e tyre janë bejlerë e agallarë, kurse krahut tuaj janë gjithë fukarenj. Ja, prandaj ne duam të bëni fjalë atje ku duhet e të vijmë me ju. Po si mendon ti, zoti Bardhyl, a thua se do na pranojnë?

U mendova një copë herë dhe pastaj u thashë:

— Për të larë mëkatat tua ja nuk është mjaft, as t'u vrasin e as t'u varin, por unë mendoj se juve diçka mund të pastroheni nëqoftëse me nder e burrëri do të luftoni për këtë popull, mbi të cilin juve keni jetuar si kërpudha e si vrasës. Unë u flas fare hapur e nuk u fsheh asgjë. Mos u zemëroni nëse unë shprehem kaq ashpër, por, t'u them drejt, m'u duk sikur juve jeni penduar. Tashti unë po ju jap një letër për Komisarin e Qarkut dhe në besën time shkoni tek ai me këtë. Hajde, mbeçi me shëndet dhe rrugë të mbarë.

Me ata u ndava te kaçubja prej ahu. Kish rënë natë e plotë.

NË PRAG TË ÇLIRIMIT

Dy muaj të verës e mbylla shkollën dhe lëshova nxënësit për pushime. Vazhdova të merrem me punët e Këshillit të fshatit, por më shumë rëndësi u vura mësimeve në shtëpinë e Ago Asllanit. Në shtëpi m'u shtuan nxënësit, mbasi erdhën edhe disa vajza e nuse, të gjitha farefis i khaxhajt. Shpesh herë u bëja mësim vetëm nuseve e vajzave, mbasi djemtë vonoheshin nëpër punët e fushës ose larg në mal. Në fillim të shtatorit e çela shkollën përsëri. Po sérish filluan pengesat e vjetra. Më mungonin shumë

nxënës. Një ditë, papritur e pakujtuar, një fëmijë ishte af-ruar te gardhi i shkollës dhe po qante. Kur e vështrova mirë, e njojta. Ishte Selmani, ai që më pat zënë me prazhdë. Çela dritaren dhe e ftova të afrohet. Ai kokëunjur duke ndukur gishtin e madh m'u afrua. Pyetjeve të mia u përgjigjet duke qarë e unë nuk kuptoja se çfarë donte të më thoshte, por nëpër fjalët e tij, ai përmendëte shpesh herë Shefkën.

Dhe Shefka, si dembel dhe noprani, rrinte pak më larg nga shkolla mbi një bregore mb'anë fshatit. Rrinte gjithë ditën e diellit atje, gjoja si roje, dhe hante bukën e fshatit si pojak a korier. Tashti nuk e shihja kurrë të rrojtur me brisk, si duket i shkurtonte qimet me gëershërë dhe gropëza e mjekrës i që ngatëruar me qime si një drizë e kreshpëruar. Merushja më vinte dëndur në shkollë, herë me punë e herë me shkaqe të trilluara, pyeste diçka mbi mësimin e ditës, sillte ndonjë letër që më vinte prej qyteti, por unë gjithnjë pata përatë vajzë një sajdi të ciltër prej vëllai. Një ditë, Këshilli i fshatit vendosi të mobilizojë përnë ushtrinë e çlirimt disa djema që ngurronin të dalin vullnetarë. Djemat nuk sollën ndonjë kundërshtim, por se vunë si konditë që edhe Shefka të shkonte në luftë bashkë me ta. Dhe ja e shoh, pojaku e fshatit tek më afrohet dalgadale, që nga lëmeri i tij majë kodrës. I ardhë shkollës rrëth e qark disa herë gjersa bëra pushimin e gjatë. Kur nxënësit po lozni n'oborr, ai m'u qas:

— Unë po shkoj për çlirimin e qytetit tënd, zoti mësues!

Syt' e tij si të miut lëviznin me djallëzi e dhëmbët e sipërme i vuri si një teh mbi buzën e poshtëme.

— Gjermani do të lipset edhe pa ty, — iu përgjigja, — por morrat e tu s'kanë ndër mend të tunden. Edhe unë në luftë jam këtu.

Ai u hodh në anën tjetër të rrugës dhe filloi të dredhë cigaren. Rrinte gjithnjë më bisht me pushkën midis shalëve e me një farë nënqeshje të djallëzuar në fytyrë.

— Luftë e bukur kjo e jotja, zoti mësues, ta kam zili.

Ma ke shkuar ujin ndënë rrogot; çfarë të them më shumë, djalë me shkollë ti... .

— É ndjeva që m'u ndezën tëmhat:

— Unë e marr vesh ku kérkon të qëllosh ti, — iu përgjigja, — por unë nuk jam faqezë, unë veproj me dorë në zemër. Vaj hallit për atë shpirt të zi që fsheh ti ndënë morrat e tu.

— Ato i shit gjetkë, zoti mësues, ti ke dashur t'i ndrosh besën fshatit, ti ke dashur të prishësh zakonet tonë, ti u ljen fëmijëve fytyrat me dhjamë të ndyrit, ti aqik ke sharë edhe hoxhën, edhe babanë teqesë. Po t'i lëmë këto, xhanëm, po... Ago Asllanit ja hodhë mirë... domosdo, xhanëm, sikush për vete e lakin manushaqen.

Ai nxori përpëra buzën e poshtme dhe i dha një të fryrë përpjetë tymit të cigares. Një fjollë tymi iu ngjitet pas ballit dhe filloj t'i endet nëpër flokët e pakrehur.

— Je parë ndonjëherë në pasqyrë, ti Shefkë? E njeh veten tënde?

— E po, ne njerëz të prapambetur de, ti i lan dhëmbët përditë, ne ku t'i gjejmë pasqyrat, ti e pe në pasqyrë të pëlqeu surrati e ju vârdise shqerrës. Ja, kështu, fshatarë jemi ne, njerëz të paditur, po dallavere prapa, krahëve nuk dijmë. T'i them xhaxhajt gjysëm fjale, të ikën koka si laker e arrirë.

Nuk di sa e poshtër m'u duk fytyra e tij në atë qast. Më vinte t'i hidhesha në grykë pa le të delte ku të delte. Ja ktheva aty për aty:

— Lere shpirtin e fshatarit ti qen, je një neparkë që s'e ke shokun. Ti nuk kuxon t'i flasësh xhaxhët se të dalin të palarat e tua. Po nuk më thua, cili që ai që hidhet bajga në shkollë, kush më thyente xhamat, kush kurdiste magjira?

— Për emër të Zotit, unë s'di gjë, kam ruajtur shkollën si shtëpinë time, po s'kam pikasur gjë.

Një çap i lehtë u ndje mbi rrugë. Ishte Merushja. Fytyra e saj e bardhë me faqet trëndafil bëri që Shefkës t'i dridhet m'jekra. Rrahu kondakun e pushkës me pëllëmbë dhe shfryu:

— Edhe manarja s'qaset pa e ndjellë...
— Më hiqesh si shenjt Shefkë, mendon ti se nuk di gjë unë për dallaverat e tua, por nuk më thua... Rakinpit dhe Malkës kush u dha kapar të më vrasin?

Atë e kapi lemeria. Gjunjët dhe buzët filluan t'i dridhen.

— Unë? Unë? Haram shërbimet që të kam bërë, ku i kam parë unë ata? Ku? Je në gabim, shoku Bardho, mos dëgjo shpifje.

— Do të t'i sjell këtu?

Ai qe ngritur më këmbë e dridhej.

— Ikë, — i thashë, — largohu, mbasë në luftë i lan gjynahet. Do delje mirë me Ago Asllanin, por unë nuk dua të gojoset kjo vajzë e pafajëshme. Edhe ballist do ishe bërë ti, po nuk di çfarë të mbajti.

Merushja u afrua, na hyri në mes e vështronë herë mua e herë Shefkën. Fytyra e saj ishte e shqetësuar, deshi të më thoshte diçka, apo ndofta kish droje? Zilja e shkollës tringëlliu me të fortë, Giçi po më thërriste që nga qoshku. I bëra shenjë Merushes të largohet, ajo kish diçka për të thënë, por unë i ktheva shpinën dhe u largova tatëpjetë.

Veç kur u ktheva në shtëpi, veç atëhere kuptova se çfarë kishte ndër mend të më thoshte Merushja. Ago Asllani ishte xhindosur si një ari i egër, mëmë Esmaja po qante e ulërinte, gjithë shtëpia ish ngritur më këmbë. Plaku më vështroi në sy me një shikim prej tigri. Unë e përballa i qetë dhe pyeta:

— Ç'ka ndodhur, xanaxha?

Ai po bluante në dorë një copë letër dhe rrihte kokën me grusht. Njëra nga nuset më foli ngadalë:

— Merushja ka ikur partizane!

Kjo ishte fare e papritur për mua. As që më kishte shkuar mendja që ajo vajzë fisnikë, e zgjuar dhe e bukur, të mund të merrte një guxim të tillë. Sigurisht ajo do të qe menduar shumë për rrugën që mori, ajo e dinte se xhaxhaj do ta ndiqte këmba-këmbës e do ta vriste sapo ta haste përpara,

Mora nga duart e plakut copën e letrës dhe fillova ta lexoj. Atje shkruhej: «Ti xħaxha edhe mémē mësoni se una shkova partizane, pér nderin tim mos u bëni merak, se unë jam çupa juaj trime dhe e ndergħme, mos bëni merak, çupa juaj Merushe Lajthia».

Ngrita sytē nga Asllani që po gatiste pushkēn e mendova: Bota mund tē kenē letra tē mëdha dhe tē vyera, por tē gjitha ato unē nuk do t'i shkembej kurrē me këtē copätz̄e letre tē thjeshtē e me shkrim tē parregullt. Kjo ēsh-tē e para letér e shkruar nga një vajzë shqiptare këtu ndér këto malësi tē egra, ku gruaja trajtohet si një skllave. Unē mund tē krenohem edhe pér letrën e vajzës edhe pér rrugën e saj.

U mundova ta qetësoj Ago Asllanin, por ai nuk, dë-gjonte kurrsesi. Pasi biseduam gjér' e gjatē dhe ai kish vendosur tē nisej me doemos, e dërgova te Komisari i Qarkut me një letér. I dhashé tē kuptojé atij se plaku ishte gati tē bënte vrasje sapo tē takonte tē mbesën. Xħaxhajt i thashé se po vu dorë komisari, ai mund ta-kħthaneç cupën né shtëpi.

Kur plaku u nis, mësova hollësi tē tjera mbi ikjen **e** vajzës. Njéra nga nuset më tha se ajo kishte shkuar bash-kë me dy vajza partizane, tē cilat patēn ardhur né shtëpi qysh né mëngjes, pér rrugën që kishin marrë asnjeri nuk dinte gjie, sepse ato ishin sjellë nēpér fshat me qē-llim pér tē humbur fillin.

DITËT E FUNDIT

Tri dit me radħe kollonat e gjata tē partizanëve żbrisnin tatępjetté pa ndérprerje. Më ishte bérē gati e pamundur tē vijoja mësimin né rregull, or' e ċast kalonin grupe luftetarésh duke kënduar, duke bërtitür, duke rendür. Edhe kuajt e ngarkuar me mortajat e rënda i mba-nin veshet puliq e nxitonin tatępjetté. Edhe ata sikur ndjenin afrimin e fitores. Larg, që nga fusha, vinin gjemmie artillerie.

— O Bardho! Eja, ore, eja në luftën e fundit!
Gazi e hareja shkëlgente në sytë e partizanëve. Delja te dritarja dhe u uroja shokëve udhën e mbarë, fitoren, shëndetin. Edhe Ago Asllani është në valë të punës, se fshati është plot me partizanë që hyjnë e dalin dhe ai duhet t'u sigurojë ushqim. Megjithëse brodhi ndonjë javë posht' e përpjetë, Merushen nuk e takoi dot. Sikur është zbutur ca, sepse i patën thënë që vajza shërben në një spital, ku punojnë vetëm infermiere partizane.

Në rrugën para shkollës qëndruan disa kalorës. Komisari i qarkut ja tërroqi frerin kalit mu përpara derës, kishte edhe disa shokë të tjera.

— Vdekje fashizmit!

U përqafuam shqipëtarisht. Ata flisnin midis tyre:

— Të kishim edhe ca shokë si Bardhyli. Ta shihje këtë fshat, këta fëmijë, një vit më parë... (pastaj duke u drejtuar nga nxënësit):

— Ej, shoku pionier, si e ke emrin?

— Giç, shoku komisar!

— Sa bëjnë pesë herë nëntë?

— Dyzet e pesë, shoku komisar!

— Po partizanët kush i udhëheq?

— Lenini, shoku komisar!

Të gjithë qeshnin, por Giçi është me kurajo:

— A nuk na merrni edhe ne në luftë, do luftojmë sì burrat, pér besë!

— Jooo, ju jeni të vegjël. Ne së shpejti do sulmojmë qytetin, juve me Bardhylin delni natën lart në mal e kur të shihni një zjarr të madh mbi Moravën, përtej, ajo është shenja se ne kemi fituar! Të qartë?

— Si urdhëron, shoku komisar!

Miqtë i përcolla gjer te vau i lumit. Atje e pyeta komisarin:

— C'u bë Merushja? Si dolle me plakun?

— Xhaxha Asllani burrë i mirë, por fanatic, mezi e shtrova disi. Vajza është në Brigadën e katërt, u nis në veri që ato ditë, deshi të largohej shpejt.

— Po Rakipi me Malkën?

Ai tundi kryet duke rrahur gjurin me kamçik:

— Kur më ardhën me letrën tënde, nuk u besova sy-ve të mi: I nisa me çetën e sulmit mbi Qarr. Malka u vra si burrat, Rakipi është në batalionin e Rëzës.

* * *

Panjasasi dhe gjithë Shqipëria po jetonin ditët e fundit të shkeljes së huaj. Pesëdhjetë e ca djem të Panjasit i shin partizanë ato ditë. Balli ishte shkatërruar me turp, gjermanët kishin marrë tatëpjetën me ik të ikim.

Pas lajmeve që mora në mëngjesin e njëzet e katër Totorit, mblodha gjithë nxënësit dhe në mbrëmje u nisëm drejt malit në Lindje të fshatit. Kur sosëm në majolen, ndezëm një zjarr dhe kalamaniët filluan të lozin me shpata të drunjta. Dalngadale ra nata dhe filluan të ndihen thirrjet e çobanëve.

Papritur u ngrit lart një thirrje fëmije. Ishte një zë i hollë dhe i fortë, zë i dalë si britmë gazi e brohorie, zëri i Giçit:

— Po ndrit andej! Po ndrit! Po s'është flakë, më duket si një yll, po, po, një yll shkrepri mbi Moravë!

Të gjithë u mblodhëm pas çunit të vogël e shihnim nga tregonte ai. Dhe pamë një regëtimë të kuqe që dalngadalë u rrit e u rrit, flakët u shquan fare, gjersë zjarri u bë i madh e skuqte si feneri që u tregon rrugën detarëve.

Atëhere ktheva kryet nga Panjasasi. Shkolla ndriste n'errësirën e natës si coha e një flamuri të bardhë.

Vani Kapedani

(Portret letrar.)

Më është ngulitur në mëndje dhe kurrë s'mund ta harroj Vani Kapedanin e fshatit tim.

Në të gjithë kohën e vegjëlisë sime, Vani Kapedani ze një vend të veçantë. E, sa qeshë i vogël dhe sa u bëra i madh, gjithnjë me mendje e me punë, me dorë a me sy, i merrja anën dhe i mbaja krahun.

Kapedan po kapedan ky Vani ynë!

I dëgjuar përmbi shokët, gojëtar iëmbël e në punë dorëmbarë. Por ajo që e dallonte nga të tjerët ishte e qeshura e tij. Se kishte një gaz Vani Kapedani që të zbushte zemrën tek e dëgjoje, dhe në e kishte rrudhosur ballin e prishur qejfin, ja se ku të qasej hareja mu në ftyrë dhe në log të zemrës. Kishte ai një të qeshur të vrullshme me zë fortë, të shkrifur, të ngrohtë dhe plot gjallëri. Dhe tek e dëgjoje një herë të çelej dëshira ta kishe pranë gjithnjë, or e çast e ta kishe mik me kokë e njeri të shtëpisë.

E, në kam një brengëzë në zemër e më lëndohet shpirti këtij çasti... kjo vjen se nuk mundem dot ta shkruaj në kartë nj' atë gaz të dlrë, nj' atë të qeshur të fort të atij burri të rrallë!

Dhe kaq i mirë ishte ky Vani sa edhe vetë baba Musai pat thënë:

— Gjynah që s'e kam dervish këtë deli burrë!

Veç mos ju shkojë mendja se Vani ishte e nuk është. Jo! Jo! Ai është gjallë e shëndoshë edhe sot e kësaj dite

e po deshe ta shohësh edhe vetë, zbrit tatëpjetë asaj Morave, pyet kë të mundësh se Vanin e gjen kur të duash. Veç një gabim mos e bësh! Mos ja thuaj troç: qesh një herë! Rri pak i vrënjtur, se ja, Vanii ilaçin aty e ka, në majë të gjuhës dhe në thelb të zemrës. E po ja shkrepri gazit... kusurë e di unë vetë: të zbret gazi në shpirt, të mbulon fytyrën pa t'i hap rrembat e gjakut.

Edhe burrë i pashëm éshtë Vani. Jo veç asaj kohe e atij moti, por edhe sot e kësaj dite me gjashtëdhjet e cavigjet në shpinë, ai ta ka kokën në trarë, dhëmbët ruaza, trupin filldan dhe gazin po... gaz si herë motit.

Dhe sa shkojnë vjetet gjithë e më dëndur vete e has Vani Kapedanin tim. Pa ja shtrëngoj me vrull nj'ato duar të ashpra e të dashura prej bujku. Kështu bëra edhe motit që jemi. E shtrova ndër këmbë rrugën e fshatit tim dhe pyll më pyll dhe majë më majë, ngjit dhe zbrit Moravën, pi ujë këtu e ha thana atje, ja se ku arrita.

Në fshat më priten krahë hapur se me gjithë ndryshimet që solli koha, mikpritjen e la në krye të bashit.

Tashti gratë punojnë krah për krah burrave e s'ta kanë për pesë, çupat e fejuara rendin në qytet për shtrat, ndonjëra edhe për djep (ca si herët po ç't'i bësh). Por Vani Kapedanin nuk e hasa dot në katund.

«Ngjitu lart në Moravë, — më thanë, — atje shkoi Vani me brigadën e vet po shin të lashtat e arave të malit.» E kështu mora rrugën përpjetë.

Nisa të ngjitem malit. Mbas çdo çuke më bëhet sikur shoh një fytyrë. Mos vallë syri im i përmalluar më gënjen? Apo vërtet kurorët e fletëve thurin ashtu fytrat e shokëve që mbetën këtej?

Dhe drurët oshëtijnë dhe ujrat gurgullojnë dhe syri im më gënjen gjithnjë. Zë e i marr të përpjetat si i ri, i zgres si i ri, pi ujin e ftohët, këmba s'më lodhet, era më përkëdhel, zemra tak e tuk dhe vë dorën mbi ballë. Më bëhet se bulzat e djersës lenë aty gjurmët e tyre. Por jo. Ballin e kam të freskët e ngjitem gjithnjë lart, lart e më lart.

Në fund i fola vetes: Ja mbërrita! Dhe mbërrita vërt-

tet. Ngre kryet të shoh majën e Moravës dhe dorën e vë
prapë kokës që të mbaj kapellën, Po kthej kryet pas... ja,
jan Guri i Arapit! Imadhi si dikur! pesëdhjet këmbë i lartë,
më shumë i gjërë, barkun tërë zgavra, ballin e rrudhur
dhe kokë e bardhë, si plak.

— Takoj një druvar. Pëstaj një tjetër. Dhe zemrën e kam
plot gaz e dashuri. Heq xhaketën, shkopsit këmishën, era
më gudulis parzmin, syri më qesh e nuk ngopem së vësh-
truari Lëndihën e Shqerrave.

— Vanin ore Vanin nuk e patë ju?

— Ikën dy kuaj nga vrahut dhe po i kërkon. Dëgjoje si
thërrret!

— Ve veshin: Një qyqe grindet me zë të çjerrë, një
shqipe troket mbi shkëmb, pastaj...

— Ho... Ho... Hooo! Na doriii, naaa!

Eshtë zëri i Vanit. Sërisht vështroj Lëndinën e Shqe-
rrave. Shquhen mbi të një palë gjurmë si njolla të për-
thime. Dhe gjurmët kanë anash plot bulëza vese si inxhi.
Janë gjurmët e Vani Kapedanit.

Hip mbi shkëmbin e madh. Tashti malin e kam kund-
drejt si pasqyrë. Andej drizat zënë e lëvizin. Hepohen
baloshe, qaplohen ferra, bisqe ahu përcellojnë erën. Di-
kush nxjerr kryet: Ja, ky eshtë Vani. Po, po, ai eshtë. Pa
shih ja edhe kuajt ku i ka, si të mbrehur, fare pranë. Por
nuk i sheh dot se pylli eshtë i dëndur.

— Ooo Vaniii! Vaniii Kapedaniii!

Zërin ma rrëmbeu Guri i Arapit e ja dha erës, era
jehonës dhe kjo ë ndau grykave, luginave me ho-ho-ho
me vu-vu-vu... Një kor i tërë.

Prita sa mbaroi jehona dhe sërisht i fryva bulçitë:

— Vaniii, ooo!

Ai hipë mbi një cukë:

— Kush je ti, ore?

— Unë ore, unë Tili! Bëj nga e djathta; nga e dja-
thta, se kuajt.

Këtu më ndërpren jehona e zërit tim dhe prita sa
mbaroi.

Dhe thirrë e prit, dëgjo e thirrë ja se Vani i gjeti kuajt dhe i tërhoqi pas kapistre.

— Më rrofsh o Tili, më rrofsh sa malet!

— O Vani, leri ore ato fjalë po as qesh njëherë!

— Na, më marrtë e mira!...

Kështu murmuroi nëpër dhëmbë por nuk qeshi. Ish i lodhur fort. Po nuk përtoi dhe m'u avit duke ardhur trottull nëpër driza e gëmusha. Herë unjej, pastaj ngrihej. Lidhi kuajt me kapistër pas një ahu:

E rroka për qafe. U gëlltita disa herë, pastaj lotët nuk i mbajta dot.

Tashti jemi shtrirë mbi lëndinë në mes të barit. Mbi krye gjeth. Ai ndezi çibukun. Tymi mavi nëpër fletët e blerta dhe filladi vu e vu. Gërqinjat që më solli t'ëmbëlla, plot lëng dhe pak t'athta. Po vetëm pak. E shoh Vanin dhe nuk ngopem dot. Ai më pyet për shëndetin, për nipat e tij që i ka larg. Syt e tij, si dy rruzulla çeliku e tregojnë të ri. Kam frikë ta shqetësoj por nuk e lë dot pa pyetur. Dhe ai më përgjigjet. Kaq herë i kam dëgjuar historitë e tia, por e rrëmoj gjithënëjë.

— Ore, Vani, po si të ngjau me dhespotin atëherë? Ai ndehu rrudhat e ballit:

— Ma mblodhi, i paudhë. Ja kryqin, ja sopatën. Po gjet shok të mbrohet. Ja lashë rason dhe m'u ngjit emri. Ndaj më thérresin kapedan.

U përkul dhe zu të shtërngojë oputat e opingave qeselë.

— Eja të ngjitemi nga brigada...

— Oj, ç'është kjo?

— Pse, veç ju kishit malit të këtilla?

— Ardhën kohë të reja, emra të rinj, pas valles shkojnë këmbët.

— Ndënë shpatin e Sarakenëve tre lëminj me radhë; duken si tre çançafë të verdhë në mes të blerimit. Njerëzit

punojnë me vrull, kuajt ndiqen nga djem tē shkathët rrëth strumbullarëve.

Piqem me njerëzit e mi, me duart e tyre, me kujtimet e mia. I shoh tē lodhur e tē përcëlluar nga dielli. Nga këto duar t'ashpra po del gruri që nesër do bëhet miell. Ndjehem i vogël përparrë këtyre njerëzve tē dashur, më vjen si turp nga sytë e tyre tē qeshur e medoemos pyes veten: Çfarë i jap unë vendit tim? A mund t'i shoh këta njerëz drejt në sy?

Vani ka dorën mbi ballë dhe vështron poshtë nga fshati:

— Pa shiko, shiko poshtë, zëri i kombajnës vjen gjer këtu, andej po mbarojnë, ne jemi prapa, ra mbretëria e krahut tē xhveshur, makinat...

— Por mua më merr malli pér këto vrahe.

— Aaa, jo. Ty tē merr malli pér vegjëlinë tënde, na kamxhikun.

Hyra në vrah dhe u lëshova pas kuajve. U lëshova me vrull si dikur. Era e malit pat pushuar; këtu kujtoj qytetin, erën e motorave, pisën e rrugës dhe këtu më duket se kam krahë, ngarend si i ri, qesh si djale, brof si çun dhe jam i shkathët si dre. Çudi! Qenkarëm édhe i ri dhe nuk e dija.

Vani punon më tej, me krahët e tij tē fortë mbart n'erë duaj tē rëndë e i stivos pas lëmit. Pastaj më vjen në krah.

— A u lodhe?

— Jo, jo. Vec këmbët m'u mbushën me kllasina.

— Nxirri këpucët!

Vani i ngre kuajt me duf, i ndjek duke thërritur, duke bërtitur, duke qeshur me tē madhe si di vec ai.

Pastaj vrah u unj, kashta u dërmua. U hoqën më-njanë ca cfurqe. Hynë në punë grebashkat e fshesat prej jakite. Kupi i bereqetit u mblodh mb'anë strumbullarit. Vani filloj ta hedhë vrahun me lopatën e drunjëtë. Zefiri na jep dorë, gruri bie aty, byku përhapet më tej, si një re e hollë.

Pastaj erdhi dreka. Zogë jahni, sallatë me piper, bukë e bardhë, e ngrohtë e butë si sfungjer, ujë shkëmbi, shije mali, ndënë hije ahu.

— Çupa e re ka magje të mbarë, — flet Vani. — Na rrofsh moj bijë.

Asaj i qeshi fytyra. Na vështron me sy të gëzuar. Dhe më duket sikur diç kërkon të thotë.

Vani ze e flet për nipat e vet.

— Ai që kam në Tiranë rri me kravatë, ai i Pragës me papionkë...

Mua diç më punoi në kokë.

— Ore Vani!

— Hë?

— Kur fole për kravata m'u kujtua petrahili yt.

Këtu ai s'e mbajti dot, pa ja buçiti më të madhe:

— Hyyy, ha, ha, ha!

Me një vrull të paparë ndonjëherë, sytë iu mbushën me lot e sa të mbaronte gazin e parë, ja se ku ja shkrepë për së dyti, sa mua faqet më muarën zjarr. Sytë më lëshuan xixa dhe ndjeva veten të lehtë sikur rendja përmbi retë.

Ne jemi shokë lufte

Një rrugë e re më çoi te shoqja ime e vjetër. Udhakalonte jashtë qytetit, ku apo hyja dredhonte ndër videria të mëdhenj, linte nga e djathta një tumbë me blirë e ja, kundrejt, dukej ndërtesa e bardhë me ballin mbushur plot çerdhe dallëndyshe; shquhej një tabelë e madhe «Shtëpi e Fëmijës» e ndën të një portë e rënë në ngjyrë të blerët. Po vija atje të shpija një letër sjellë dorazi nga fshati për një nxënës shkolle, por kurrë nuk marrte mendja se do hasja aty shoqen time të vjetër.

Nëpër koridor kalonin nxënës me çanta ndër duar, djem të kreher me kujdes, vajza me kordela mbi flokë. Më tej një derë gjysëm e çelur, aty trokita dhe hyra. Ndenjur para tryezës një grua afër dyzetave; kish fytyrë të bardhë, vështrim të menduar, flokë gështenjë, të butë, e syze me rreth nikeli. Sa më zgjati dorën takova vështrimin e saj. Ajo më foli në emër dhe më ftoi të ulem. E rëmova kujtesën time shpejt e me ngulm, kafshova buzët, shtërngova dhëmbët... Asgjë nuk më kujtohej. Mbi tryezën e saj shihja tri kopje për telegrame me adresë të ndryshme, por me tekst të njëjtë:

«U trashëgofshi, nuk do vij dot, më falni. Mamaja».

Edhe aty emri i saj nuk përmendej, por mua më rrëmbeu kureshtja, kësaj nëne po i martohen tre djem në një ditë, i uron dhe nuk shkon tek asnjëri. Çudi!

Të gjitha këto kaluan fluturimthi nëpër mendjen time.

— Me të vërtetë nuk më kujtoni dot?

Ajo çeli një sirtar, nxori diçka dhe që aty lëshoi mbi

tryezë një kopje të «Kushtrimit të lirisë» që botohej gjatë luftës. Pashë firmën time mbi kapak. Nuk dija se me çfarë fjalësh të mbushja boshllëkun që shkaktonte kujtesa ime e keqe. Por tashti fytyra e saj queshte e tëra dhe me dorë tregonte saksinë me lulëkuqe në dritare.

Kur shoh «Kushtrimin e Lirisë» më kujtohen Afërdita dhe Kasiania tek kalonin fshatrave me çantë mbi shpinë, kur shoh dinamit më kujtohet Jorgua, kur shoh Gurin e Capit më del parasysh Zairi e kur vështroj lulëkuqe të njoma...

Tashti e njojta fare mirë, por fajet nuk i pati syri im e as kujtesa e keqe. Fajet i pat lufta me fletën e saj të vrazhdë.

— O Liri! Unë kisha dëgjuar se ti humbe spitalevê, më kanë treguar për ty gjëra të pabesuarshme, ngjarje tronditëse.

U nemitëm një copë herë ashtu si të mek një tronditje e fortë a një kujtim i mallshëm. Dhe në mendjen time u ndehën një nga një vitet e egra të luftës partizane:

«Isha këtu e tetëmbëdhjetë vjet më parë më yll në ballë, armë krahut e shokë shumë në fshatin tim. Sipas zakonit dolla nëpër baza të shoh shokët në ndjehen mirë, mos kanë ndonjë nevojë, fjalë a. porosi. Bridhja si djal' i fshatit rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi, duke përshëndetur njërinë me bujë e zë të lartë. Pas më ndiqte një çetë kalamanësh me kobure drrase brezit:

— Si të kam, o Teto Lenë? Si më je, o baba Tile? Pse s'na flet, moj Marë e bardhë? Ku të kam, o Bik i Ndrokës?

Mbërrita te teto Frosina. Oborri i madh; mbi krye pjergulla rrushi, mjaltë të ëmbël.

— Ku jeni, moj gra? A s'dilni, moj çupa!

Drang drung shkallëve, dora më shket parmakëve, zëri ushton odave.

— Teto Frosë, moj!

Muret e kthinan kthenin jehonën e zërit tim. E më

atë zë të plotë sikur desha të bëj të heshtë një zë të hollë që ligjéronte në dhomën mbi shkallët. Kështu desha unë, e fjala ime kumbonte, por sa u qasa aty, sa vura këmbën në prag të dhomës e pashë brënda... shtanga në vend. Zëri m'u pre. Kundrejt meje ndejtur në kënd një partizane e re. Kish faqe të kuqe, mjekër të mbushur, gushë të bardhë, dy gërshteta lakuar mbi gjoks e një revole në brez. Më vështroi buzagaz sikur më pyeste përse e preva zërin; mendja ime ment fluturoi, por sikur më ndaloi ylli që kishim në ballë. Unë heshtja dhe desha që ajo të vijonte fjalën me ndodhinë që u tregon-te shokëve përreth. Kapa me të dy duart anët e hyrjes, e vështrimin tim të thellë ma preu muri i bardhë, pa m'u kujtua poeti lab:

Pa le ta dëgjojmë një her' e dy herë
Fol, moj dallëndyshe, që këndon mbi derë,
Fol, moj dallëndyshe, se sa më vjen mirë!
Mos je ndonjë vajzë nga ndonjë vend i lirë?

Kjo ishte njojja ime e parë me Lirinë. Pastaj ishim bashkë rrugëve të luftës. Dikur ajo më dha një copë bukë e djathë që e hëngra me një barrë shije, dikur më mjekoi një elbth në sy, një herë, faqe meje, i tregoi komisarit takimin tonë të parë dhe herën tjetër...

Na rrithnin italianët me artileri. Ishim në vreshtat e Grapshtit. Ish buzë pranvere, dheu ish i lagësht. Gadi i ullur. Kur pëllcisnin gjylet, veç predhave përhapnin edhe llucë të llokotitur. Ndërsa isha shtritur pranë Lirisë na erdh një gjyle fare afër. Në fillim një plasje e egër, nga shpërngulja e ajrit u shëmbëm në bark. Koka sikur më krisi e m'u ngjesh pas tokës. Por plagë nuk pata. Veç dëgjova zërin e Lirisë.

— Se ç'pësova kështu. Një shuk lluce i kish përvëluar qafën, asgjë tjetër. Ja hoqa mënjanë gërshtet e rënda, ja pastrova zverkun e ja lidha gushën me shami. Dhe gjithë këto i bëja me kujdes dhe s'di sepse veç me majat e gishtave. Pastaj asaj i ra si të fikët, ja derdha pa-

gurin mbi fytyrë. Na u desh tē largohemi, por vendi ish i zbuluar. U afroan shokët tē na ndihin, po ajo më dha krahun mua, dhe zvarrë-zvarrë, duke ngarendur, e nxoxra tej. Pastaj, sa herë e hasja, vështrimi i saj i dlrë dhe i gëzuar më nënëqeshte me miratim. Më vonë Lirinë e hoqën nga radhët e çetës dhe i treguan një armik tjetër. Dëgjova komisarin që i thoshte:

«Armiku tjetër duhet luftuar me këmbëngulje, tē huajtë do t'i nxjerrim nga trualli ynë po ai «armiku tjetër» éshtë rrezik tē na mbetet akoma nëpër këmbë. Unë u habita me këtë tē folur e u çudita një ditë kur Liria në vend tē më përgjigjej për çka e pyesja çeli çantën e saj tē rëndë:

— Lufta ime vijon me fitore, — më tha, — ja robërit që më janë dorëzuar gjer më sot.

Dhe ngriti e ndehu lart një tufë hajmalish e perçesh tē zeza. Si kaluan disa muaj, një plumb i ardhur nga larg më shpoi pulpën. Lirinë e gjeta përgjegjëse në spitalin partizan. Kishim një tē tillë në mes tē pyllit, në salën e një kishe pranë një manastiri tē vogël. Aty mbanëtë erë temjan e qirinj, jod e vaj tē djegur. Kupa e kungatës na vlente si gotë, temjanica si kripore, pëtafijet si kuverta. Në kazanin e dyllit gatuhej gjella, por me gjithë këto senjorët nér ikonat nuk dukeshin aspak tē mërzitur. Ishin shtruar atje nja tetë veta. Shëronim plagët më pak ilaçe, me kujdesin e doktor Pëllumbit, me shërbimin e fjalën e ëmbël tē Lirisë dhe shoqeve tē saja. Drekkë hanim fasule, darkë «frikase me gjizë» dhe mëngjes kusurin e darkës. N'atë spital partizan kam njojur sa e çfarë lulësh kanë malet tonë. Sa çelnim sytë në mëngjes ktheshin vajzat nga pllajat e malit me dengje lulësh në duar, i vendosnin në tryezën e gjatët në mes shtretërvë. Atje përzjeheshin ngjyrat e ylberit në qindra nuanca, mjeku zgjidhët lule për ilaçe, ndërsa salsa kundërmonte në aromë. Një ditë kur më digjte balli nga zjarmia e kur më dhimbte koka, m'u kujtua një mjekim i gjyshës; i kerkova Lirisë një lulëkuqe e ajo më dha një tufë tē téré.

E mbusha ballin me petale të kuqe, e vulosa me konxhet,
të tjera fletë i përtypa në gojë. Për çudi koka m'u lehtë-
sua. Tashti dit e për ditë Liria më dyndëte shtratin me
lulëkuqe të njoma. Kur u zgjova një mëngjes ndjeva
dikë që po psallte e qeshte mbi kokën time. Kur çela sytë
vura re se më kishin mbuluar trupin me lulëkuqe. Liria
po më qëllonte në ballë me një lulëkuqe dhe recitonte
përmendësh vjershën e një labi. E kisha vënë në sedër që
ta mësonte, se vargu i ëmbël, i ngrohtë dhe shqipëtar i
përshtatej asaj vajze ashtu si flokët e saj të butë mbi ba-
llin e gjerë:

Unë jam një arbëreshë, rroj këtu ne rëza
Një gjak e një gjuhë kemi me thëllëza
Pëllumb e sorkadhe jemi farefis
Kemi dhe shqiponjën, gjyshen e shtëpisë!

— E mësova! E mësova! — bërtiste ajo, — hap sytë
se do ndrojmë fashet.

Një ditë erdhi batalioni ynë partizan në spital. Ajo
ishte për ne një ditë feste e gjëzimi. Bashkë me gjithë shokët
e mi të vjetër unë njoha edhe një të ri. Ai dukej një
djalë kapedan me mustaqe të holla e syzi. Mora vesh se
ai ishte i fejuari i Lirisë. Nga dritarja i pashë të dy tok.
Bisedonin në sheshin e vogël. Një çast më zu veshi sikur
ai lutej që ajo të linte spitalin. Balli i saj i bardhë mori
një pamje të rrëptë.

M'u duk sikur biseda e tyre ishte e ashpër, sepse
asnijëherë nuk nënëqeshi Liria. Asnjëherë dora e saj nuk
përkiti të tijën. Po kur partizanët filluan të loznin kala,
fityra e Lirisë ndryshoi. Djemt e rinj qeshnin e kërce-
nin sa tundej sheshi e gjëmonte pylli. E ja, n'ato çaste
kur djaloshi syzi hidhej e kalonte shokët, fityrën e saj
e mbulonte ngazëllimi dhe sytë e saj të ndriçëm sikur
shkrepëtinin e dukeshin më të bukur.

* * *

Por një ditë më drekherë në pyllin tonë me ahe, kri-
sën karthija të thata, një trokth i nxituar rrahu patozin
e lagësht të koriges, shkrofëtinë kuaj, u çanë tumba dri-

zash, një drithmë e egër përshkoi sallën tonë, zëra ar-
miqsh u dëgjuan përbri, kuaj të hasdisur u turrën për-
reth. Një çetë ballistësh na rrëthoi e një zë i panjohur u
kërcënua:

— Dorëzohuni!

Liria u dha te porta e spitalit. Një tufë flokësh i dri-
dhej mbi ballë. Mbi këmishën e bardhë kish pikë gjaku:

— Ej... njerëz, qëndroni! Gratë shqiptare, kur s'ka-
në armë, hidhen nga shkrepat, e armikut nuk i dorëzo-
hen. Por ne armët i kemi, asnë çap përpara...

— Burrani breee, t'i zemë e t'i marrim rob.

— Ndonjë plumb ballit mund të marrësh, o faqezi!

— Kapeni bijën e bushtrës breee, ulëriti zëri i çje-
rrë i aga bej Selfiut.

— S'ja dollët dot fushës me trimat dhe ardhët vje-
dhurazi në pyll të kanosni të plagosurit dhe gratë, ne
jemi akoma shqipëtarë, ikni nga keni ardhur, në jeni të
hurit dhe të litarit, hapuni se barutin të thatë e kemi.

— Kapeni bre, se e keni sonte.

Aga beu ngriti kamxhikun dhe e lëshoi me vrik. Një
kalë i goditur mbi vithe u ngrit përpjetë dhe kalorësi ja
térhoqi frerin me forcë. Një armë vringëlli u në dorë të
Lirisë.

— Turp, o bej i marrë, lumi ato vajza që të paskan
prind.

Një grimë heshtjeje. Pylli sikur mbajti fryshtën, kre-
shtat shohin njera-tjetren, tytat armikun dhe plagët në
spital nuk dhëmbin më. Brënda dritoreve u ngrit zëri i
një partizani kosovar mbetur me një këmbë:

— Hej, sokoleshë malit, sa hie të paska cullufja e
ballit! Floku i ballit dhe fjala e zemrës, mos u tut o so-
koleshë se plagët u mbytën dhe na jena këtu.

Veç të shihje atëhere ballistët e beut tek çuçuris-
nin kokë më kokë si hajdutë. Kokë më kokë e sytë për-
dhe e tytat përtokë, tytat përtokë e lotët për faqe. Një-
ri syresh çpërveshi buzët e lëshoi zërin e tij të ngjirur:

— Sikur s'vete, o bej, të ngatërohem me gra, rah-

met pastë im gjysh, thoshte një fjalë: komiti që merret me gra e ka davanë të humbur. A nuk e sheh atë vajzë kokëkrisur, ta lëshon ballit dhe përpjetë të nxihet oxhaku: I biri i Jonuzit u vra nga një çupë...

Beut kumandar nisi t'i mavijoset fytyra, sytë iu bë-në gjak dhe buza iu var.

Se kaq trimëroshe ishte fjala e kësaj partizaneje, kaq e ëmbël dhe kaq e shtruar, kaq e fortë dhe kaq me duf, sa besa po edhe katili më i pabesë do t'i vente gish-tin tëmthit.

Një taborr me burra u mund nga trimëria e një vajze.

Drizat e pyllit u çapluan përsëri, trokthi u ndje së-rish dhe ja zëri i Lirisë në shtegun e malit:

— Hej burra, ndaluni, ndaluni! hej burra mos ikni, le-re ni t'ikë veç ai bandit. Hej djema ejani ndër ne!

Por ata nuk u kthyen. Veç vonë, pasdite, u gjëndën tri pushkë hedhur viseve. Pushkë viseve dhe gjurmë anëve.

Pas disa ditësh plaga m'u mbyll dhe ika nga spitali. Lirinë nuk e takova më. Por ja sot, pas tetëmbëdhjetë vjetësh po dëgjoj zërin e saj të njojur. Unë i lutem të tregojë pér kohën kur u ndamë, por asaj i vjen zor. E shoh se i vjen rëndë të flasë pér vete por unë nuk i ndahem se dua që vajzat tona sot të dijnë sadopak si vojtën dhe luftuan partizanët nér male.

— Në Tendën e Qypit luftuan edhe të plagosurit edhe të sëmurët tanë. Kjo nuk ishte luftë, ishte një kacafytje e rreptë me një armik të egër. Ajo betejë ishte një nga majat më të larta të trimërisë shqiptare. Në një çast aty u gjenda pa ndjenja. Një granadë e armikut ma griu trupin e ma bëri shoshë. Për çudi duart dhe fytyra nuk m'u qëlluan. Veç sytë i kam edhë të dobët. Dit e javë nuk u përmenda. As dija ku isha e as dija se ku më çonin. Kur erdha në vete nëna ime më rrinte mbi krye. Zemra e saj prej prindi i kish treguar rrugën dhe më pat gjetur. Në spital të Marenës ishin gatitur pér operim. Sa mbrijta, mjeku provoi gangrenën me majën e thikës. Por pulpët

më dhëmbën. Dëgjova mjekun që thirri i gëzuar: — Hiqeni sharrën nga zjarri.

Filloi mjekimi me ilaçë. Fasha këmishët, jod rakinë. Në zemër kurajo dhe durim. Trupin e kisha plot plagë. Kur lëvizja më dukej sikur me mijra gjelpëra më shponin në tru. Sa herë të kam kujtar ty atje, sa herë më shkonte mendja tek lulëkuqet, te vjershat, te spitali i vogël i kishës. Mbaj mend se në përcartin tim të thërrisja me emër ty dhe gjithë shokët e tjerë, sillja ndërmend plagët tuaja, pyesja për juve korierët që vinin nga larg, u dërgoja përshëndetje e prisja përgjigje. Juve ishit shumë larg.

Pas disa javësh u bëra më keq. Më vunë në një vig e sërish në rrugë. Nëna më vinte pas. Duhej vajtur në spitalin e Gramozit për një operim me vegla të holla, për plagë të thella. Por duhej kaluar shteg më shteg e mal më mal, në rrugë të thepisura, nëpër avusha e pyje, në prita t'armikut.

U jam mirënlohëse përjetë shokëve partizanë që më mbajtër në vig kaq dit rrugë. Kur mbrijtëm në Shkumbin, rrjedha ishte e turbullt dhe e rrëmbyer. Urë nuk kishte, nëna duhej kthyer, ajo nuk desh të më linte, po me zor e bindën. Filloi kalimi. Katër veta mbanin vigun, dhjetë shokë të tjerë ecnin krah të parëve. Ktheva kryet pak më një anë dhe pashë dallgën e turbullt të lumit; mendova se më bënин sytë pa zgjata dorën. Pëllëmba më zu n'ujë. Mbi faqen e ujrate duke shin veç kokat e partizanëve, duart e tyre të forta dhe vigu im i rendë dhe në bregun që lamë, nëna ime e çashtërt qante e ulërinte me të madhe:

— Bijëë! O bija e imëeee!

Atë klithmë të dhimbëshme e rrëmbeu vala, e mori gryka e Shkumbinit, ja dha jehonës, dhe zëri ushtonte gjithnjë:

— Bijëë! O bija e imë!

Ajo brithmë më sëmboi e më dhëmbi më shumë se plagët. Me zor e mbaja veten, pastaj gropëzat e syve m'u

mbushën e nëpër sytë e mbytur në lot shihja qielin e kuq që ndehej e lëkundej si në tallaz.

— Po qëndro, o Liri, i fola vetes, mos u ligështo, zemrën lart. Me vajtime nuk i falim asgjë atdheut; do shkojë rrëke djersa dhe gjaku dhe do të vijë agimi pér ne.

Në spitalin e ri më pastruan plagët një nga një. Nga trupi mund të nxirren shumë cifla hekuri aq sa mund të kenë hyrë, por nuk ma merrte mendja kurrë që nga trupi im të delnin aq cifla kocke! Pastaj atje më ngjau diçka e papritur. Një mbrëmëherë hyri në spital partizani Petro Mishi. Ti mbasë e di, (këtu Liria uli kryet), që unë me të kishim lidhur një fjalë, ishim të fejuar. Isha në shtrat mbuluar me kuvertë e veç kryet kisha përjashta. Ai u vërsul drejt meje se vinte nga larg. Më mbyti me fjalë, desh të më jepte kurajo, më pyeste, priste përgjigje. Po përgjërohej pér mua. Por duhej marrë një vendim, duhej thënë diçka e ashpër, por e vërtetë. Dhe kur djaloshi po mbante frymën, kur ai po çaplente sytë, unë, duke ja mbajtur dorën, i fola thjesht e ngadale:

— Ne jemi shokë lufte dhe kështu do mbetemi përgjithmonë, ti s'duhet të mendosh më pér mua. Unë ~~jam~~ pér ty si gjithë shoqet e tjera. Trupi im është grirë nga plagët. Duke të përzënë sot, unë po i çel vetes një plaqë të re dhe dije mirë se kur të përzë... të dua më shumë, por... kështu i dashuri im, vëllaj im!

Në këndin përtëj një partizan sovietik, ish rob lufte, shfrynte me urrejtje:

— Eh, vojna, vojna!

Sa rëndë qenka të dbosh atë që dashuron, të përzëshëndërat prej vajze, të largosh kuptimin e jetës, jetën vëtë! Por ngushëllova veten se ëndërat e rinisë sime ja falat atdheut.

Kur mjeku hyri në sallë, iu desh të nxjerrë pér krahu djaloshin partizan. Të gjithë shokët heshtën asaj ditë; edhe ata që ndruan plagët shtërnguan dhëmbët e nuk nxorën fije rënkim. M'u duk se mbahej zi pér çka më ndodhi mua. Por unë nuk u përkula, nuk ja lëshova

veten lotëve dhe dëshpërimit. Mbajta kryet lart si partizane dhe ato që i thashë vetes atëhere i përsërit gjithnjë:

Vajzat iliriane kthiseshin vullnetare në themel të kësh-tjellave, dikur herëmotit. Dhe nëse rinia ime, ëndërat e mia prej vajze, shpresat, dëshirat, gjithçka e bukur dhe krenare ish apo është tek unë, nëse të gjitha këto u vunë në themel të Shqipërisë së Re, unë tashtë ndjehem e lumtur.

Por ato kohë kaluan. Me gjithë plagët e rënda, unë u shërova. Vëg e kam zor të qëndroj më këmbë. Që pas qirimit e tëhu po rrit fëmijët e atdheut. Qysh atëherë imblodhëm plot të tillë. Kishin mbetur rrugëve pa prindër e pa njeri. Më von erdhën edhe të tjerë. Jetë kjo. Shih këtë album të madh fotografish. Këtu i mbaj gjithnjë fytyrat dhe kujtimet e tyre. Nuk di si jam sjellë me gjithë ato vajza e djem, sepse të rritësh dhe të mësosh kalamanj e t'i bësh burra dhe gra të denja, është punë e vështirë. Por di mirë se «fëmijët e mi», (këtu Lirija i mëshoi zërit), janë në të gjithë anët e atdheut. Ka mjekekë, mami, inxhinjerë, agronomë. Një, varg i tërë. Ja, tre syresh nesër martohen. Prandaj po i uroj me telegram. Pas disa ditësh do të vijnë me nuset e tyre, jam e sigurt. Dhe kështu thelli në veten time ndjehem e lumtur. Unë rroj me gazet e tyre, me shpresat, dëshirat dhe ëndërat e tyre.

Kur u ndava nga Liria, ajo më dha një tufë lulëkuqe. U ngrit sa u përshëndoshëm dhe ndërsa unë po ikja, ajo vu të dy duart mbi albumin e madh.

Frym veriu

Dy shqiptarë po grindeshin në bregdetin e Barit. Ata qëndronin kundruall si dy deshinj kur gatiten t'i sulen njëri-tjetrit. Njëri ishte djal' i ri, tjetri plakosh, kurse një i tretë, mesoburri, me rroba e kapele të bardhë, i unjur në fron me gojën gjysmë çelur dhe vështrimin tej në horizont, qëndronte i përngrehur sikur kish para dentistin me darë në dorë,

Plakoshi tundte bastunin e i drejtohej atij që ishte ulur:

— Të futën në thes kuqalashët, o Hasan Brana, kaq e pate. Por ktheu sa nuk është vonë, ktheu se more veten më qafë, ktheu se...

Dhe midis plakut dhe djalit nis një bisedë e ashpër, një shfryrje dufi e inati, një e folur me thumba, me grushte të mbledhur. Pastaj ata e ulin zërin që ta ngrejnë përsëri dhe prej inatit u dridhen gjunj' e buzë.

Por i uluri në fron nuk çel gojë, ai vështron tej nga lindja dhe mendohet. Ngadalë ul sytë dhe sheh fytyrën e vet mbi një copë det. Duket i hequr dhe i tretur, rrudha të thella, dhëmbë të rënë, një mjekër e përdalë, sy që pasqyrojnë sëmundje dhe në kokë vetëm pak flokë si ato qimet që ka pula kur i heqim pendët.

Por në shpirtin e tij gjëndja ishte akoma më e rëndë: atje po i përfyteshin një varg i tërë kujtimesh e ndjenjash, turp e pendim, mall e frikë. E të gjitha këto i kishin çelur një trazi përbrënda që nuk e linte të qetë or' e cast.

Edhe shtatëmbëdhjetë vjet më parë, Hasan Brana, ballist, kish zbritur në këtë skelë, të huaj. Ikte nga at-

‘dheu atëhere me grykën e pushkës tatëpjetë i ndjekur nga mundësit.

Dhe ndërsa dy shqipot e tjerë vazhdojnë të zihen duke u sjellë anës detit, Hasan Brana rri e mendon, rri e vret mendjen, rri e gjykon veten:

«Do të kthehem në shtëpi kokëbardhë e faqenxirë. Dhe me të mbetur fill me tim bir, do t'i hapem atij, do t'i tregoj një për një fajet dhe vojtjet e mia. Ja kështu dë të bëj, do t'i zgjedh fialët një nga një, një nga një:

Tetëmbëdhjetë vjet më parë, o bir, ti ishe fëmijë pësë vjeç. Unë i qetë ngisja pendën nd'arë, yt vëlla, Bardhylli, vinte pas brazdës duke némëruar kokrrat e misrit. Ishim njerëz të punës, ishim të varfër, mbrehnim kaun me lopën tonë, bënim punët e robit dhe hanim bukën e zotit. Njeriut s'i binim më qafë, pa kamje ishim, por të dhëmshur gjithnjë për njerëz e bagëti. Ti ndaje me lypësit krodhën e bukës, ti ushqije harabelat ndënë dritaren tonë, dhe mua fatkeqit kur të shihja kështu, më këndonte zëmrë e më ndriste fytyra. Po ardhni një ditë e nëmur, një aga i pasur mëra pas, me gjuhën e tij të mprehtë, me shkollën e madhe që kish, më yshti, më bëri për vete. Ishin vitet e luftës që shkoi. Unë iu nënështrova atij, ai m'i shau parti, zanët dhe unë i shaja. Ai më lëvdoi Ballin dhë unë e lëvdoja. Zëri ish i imi, po avazi i botës. Ai njeri i lik ma ushqeu trurin meurrejtje dhe mëri. Ai më bindi se «Kacakët e malit do na prishin ndër e atdhe, besë e flamur!»

Nga fshati ynë shumë djem dollën partizanë; unë e dija se fqinji ynë Syrja Dapja ishte nxitës i këtyre punëve. Dhe ditë për ditë zihesha me Syrjanë, ditë për ditë sherr. Kur ja, një natë edhe yt vëlla Bardhylli iku partizan. Ah, e mbaj mend mirë! Ai mëngjes i mvrejtur sikur u bë lajmëtar për prishjen e shtëpisë sonë. Hundë e buzë dolla nga rruga e malit, kisha një hu thane në dorë dhe ma merrte mendja se do gjeja Syrjanë mb'udhë. T'i heq një dru të mirë, mendoja, t'i heq një dru të shëndoshë, që ta mbajë mend jet e mot. Dhe ja Syrjai

më doli pérpara, Filloi grindja si ngahera, jo ti jo unë, jo të bardhë jo të kuqe, jo me yll jo pa yll, gjersësa më hipë gjaku në kokë. Huri im u ngrit lart dhe qëlloi. Qëllesa nuk u nis e fortë (po ndofta dhe ish) dhe e godita Syrjanë pas veshit. Për çudi ai ra pa frymë përtokë. Diçka i gurgulloi pas grykës, por unë ktheva kryet pas se kisha frikë nga gjaku. Dhe sa ra muzgu, e zvarrisa thellë në pyll, e varrosa, ndeza zjarr mbi varrin e tij dhe i zhduka gjurmët. Dije pra, o biri im, se vrasësi i Syrjait jam unë. Askush s'e mori vesh këtë, askush nuk e di, pra dije ti i pari. Më tej mora armën dhe dola ballist. Mendova atëhere se kështu punoja për atdheun, luftoja për të ardhmen tuaj, për strehën tonë të qetë. Lufta kaloi e ashpër fort. Unë ballist dhe yt vëlla partizan. Dhe veç pak ditë ka që mora vesh se Bardhyli paska rënë në luftë asaj kohe. Unë e dija të gjallë atë, dija të gjallë edhe nënën tënde, gruan time. Unë, o bir, isha larg, shumë larg.

Ish një vjeshtë e nxirë kur grupe të çakërdisur ballistësh, si ushtria e Xhevitet dikur, të trembur, të uritur, me duar të gjakosura, hipnim varka e kaike dhe kusytë këmbët, si gallofët ndër mjergull, merrnim arrati-në nepër detin e mbarsur me furtunë. Isha edhe i ri atëhere. Isha i egër si n'ethe, me kokën e fryrë nga zjarret e kohës. Në muajt e parë që ndejetëm në Itali, krerët tanë na mbanin fjalime të zjarrta, ne moralisht nuk jemi të mundur, na thoshin, na betoheshin për engjuj dhe shenjtorë se kthimi ynë në atdhe ish punë ditësh. Pastaj na futën nepër kurse e shkolla, na mësuan si të qëllojmë me thikë, si të prishim ura, si të vrasim më lehtë njerëz, na mësuan të hidhemi me parashuta. Por dalngadalë unë fillova ta ndjej veten të huaj midis atyre njerëzve. Ata nxitoheshin të ktheshin në atdhe që të merrnin çifligjet që patën lënë, ata nxitonin për ofiqet e humbura, për nderet e pallatet. Një ditë më ardhi radha të via natën në Shqipëri. Por unë nuk pranova. Nuk shkoj natën si hajdut në atdheun tim, u thashë, jo, nuk shkoj. Atëhere nisu ditën, më thanë, nisu se trekëmbëshi të pret në Tira-

në. Dhe frikën e atij trekëmbëshi unë e kisha me të vërtet. Prandaj mora sytë dhe kapërceva një det tjetër. U hodha në Libi. Në një fermë të largët, thellë në shkretëtirë, gjeta një punë të vogël. Vjete e vjete me radhë nëmëronja arka e varela me hurma. Ndënë një diell që zhuriste, ndënë një vapë mbytëse, unë kam vojtur si gjarpëri ndënë gur. Sa herë atij mërgimi shkruaja letra për ju! Por unë kurrë nuk guxoja t'i nis ato letra, sepse kisha frikë mos pësonit gjë juve.

Në Libi, punëdhënësit e mi, ishin italianë. Ata rrojnë mirë, në barangë dërrase të rrëthuara me vello të bardhë. Kish edhe midis tyre njerëz të mirë. Shpesh më ndihnin sa u mundej, më mësonin gjuhën e tyre, më jip-nin **libra**. «**Nostro povero albanese**» më quanin midis **tyre e gjithnjë «povero e povero»**.

Në atë vend të shkretë pasqë vojtje e varfëri të **hatashme**; pasqë vendasit zezakë që **vdisnin urije**, pasqë të **tjerë që vriteshin** ndër luftra fisesh. Atje dëgjova **për «Osmanë e Hasanë arnautë»** që dikur në kohë të Turqisë kishin lënë andej nam e trimëri, emër dhe lëkurë. Kockat e tyre **edhe** nuk ishin tretur ndënë kum. Dhe atje në Libi, duke parë gjithë hatanë e vojtjes dhe të varfërisë, zemra ime filloj të mblidhet shuk. Bukën e hidhur të mërgimit e haja përzjerë me lot. Më vinte mendja ndër ju, në strehën tonë, te Sivaku ynë, te lopa Balashe, pa bija përmbyss e qaja duke i rënë kokës me grushte e thërrisja si i marrë: ku je, o hiri i vatrës sime, ku je, o delja Bejkë, o. parmandë e gjyshit! I mjeri unë lashë grua dhe shtëpi, i flaka tej fëmijët dhe mora arratinë! Në fëjeva le ta gjej me njerzit e mi, u bëra vrasës të më dënojnë. Siskush e mbush vetë kupën e tij, për të mirë a për të keq. Edhe unë e mbusha kupën time plot e me majë dhe duhej që vetë ta pija. Dhe ja tashti jam i sëmurë, kam katanisur një gërmadhë e Hasan Branës, jam një zhele e grisur, që i kthehem atdheut, lashë në mërgim forcën dhe bukurinë e shtatit, lashë faqet e kuqe dhe dhëmbët e para me gjithë aparillëkë, lashë qetësinë e shpirtit e pas

m'u ngjit një krupë e keqë që nuk më ndahet as ditë as ëndratë. Koha që kalonte, në vend që t'i vinte bar plagës sime, ajo e bëri më keq. Më kapte tmeri e më ze akoma kurr kujtoj vrasjen që kam bërë. Sa lot kam derdhur në mërgim, sa lot! Se kush mërgoi e dëshëroi sytë e fëmijave, kush la tokën e pleqve, kush brodhi si qen nëpër rrugët e botës, veç ai e di ç'është boshi në gjoks e dënesa në grykë. Më dukej sikur humba për gjithnjë, si sopata pa bisht. Një vit tërë kaloya aty me ethet e verdha. Ç'kam vojtur atëhere, edhe varrit do t'ja tregoj. Po kur më kaloi ethja m'u ngjit një sëmundje tjetër që e kam akoma. Fillova ta ndjej veten të prerë, të ronitur, të mërzitur, pa gjëzim, pa shpresë. Fillova t'i mbaj sytë në havë, fillova të mbetem si i kthisur pas barangës. I zymtë dhe buzëplasur rrija shpesh e nëmëronja rahjet e zemrës, lidhja duart prapa e ja fshihja diellit, ja fshihja hënës, juat fshija njerëzve. Dhe të tjerët nuk e dinin pse i fshihja ato duar. Më shpunë tek mjeku. Ish një italian i gjatë me sý prej gjykatësi. Ai më pa mir' e mirë, më pyeti gjërt e gjatë, më dëgjoi me nge e pastaj tha: «O shqiptar i mjerë, të paska ligur dëshpërimi e malli, qënke plakur para kohe, po vijove me këtë gjëndje do lësh kockat këtej me siguri. Pajtohu me vendin tënd, o njeri, hiq nga mendja egërsitë dhe mérinë, jepi vetes paqe e qetësi, përndryshe ke mbaruar». Unë e pyeta: Po çfarë kam, o doktor? Vuan nga një farë melankolie, më tha, euh sa ka në botë me këto hallet e tua!

Një prift katolik më këshilloi një ditë: «Bëhu i krishterë, o njeri, e zoti do të të japë ballsam për zemrën tênde.» «E çfarë del nga kjo» i thashë unë. «Muhameti i la dhunën kalifatit, Krishti la shpresën, mirësinë dhe ifjalën eurtë.» «Po unë jam bërë synet o padre.» «S'ka gjë, se ne të pagëzojmë.»

Por as pagëzimi që kreva, as alipsanet që putha, as temjani që dogja, as nuncosja e as bekimet që mora, nuk më shpëtuan dot.

Shpesh herë hapja radion. Kur dëgjoja nga Tirana devollëcen tonë më ngrihet zemra peshë. Më dukej si-

kur bridhja çukave e gërxheve të Moravës, më dukej si-kur shihja lumenjtë tanë duke gurgulluar, më dukej si-kur dëgjoja zërat tuaj.

Ndërkohe pranë barangës sonë ardhni një djalosh i ri. Ai ishte i huaj atje. Ish lëkurëbardhë, por jo italian. Ai m'i nguli sytë mua e më vështronë me ngulm. Dhe m'u duk se syt' e tij më flisnin shkoqur. Unë nuk dija se çishte ai, po kur dëgjova që më foli shqip iu sula sipër dhe e mbështolla në krahët e mi të dobët.

— Ej Hasan Brana, — më tha, — mezi të kam gjetur!

— Hasan Brana? Po ku më njeh ti? Kush je ti?

— Të flas me dorë në zemër, të flet mëmëdheu, Hasan, — ma pat ai. — Ti je ndër të pakët njerëz të gabuar që mbete kötej. O Hasan, i jati i Skënderit dhe Bardhylit, a nuk është kjo fotografia jote?

Një thëngjill tjetër u vu në zemrën time. Pas tetëmbëdhjetë vjetësh unë dëgjova fjalën «atë». Shpejt ktheva sytë prapa. M'u bë sikur aty do shihja doçkat e tua si dikur, kur mundoheshe të më kapje gjunjët. Por djaloshi shqiptar ishte i hollë, i shkathët si dre, i zgjuar si shqiptar. — Mos korit veten, o Hasan, agronom Skënder Brana nuk është më kalaman, ai është burrë si ti e si unë, të flet me gojën time e të kujton se kjo rrugë që ke sot, është rrugë turpi.

— Por ç'do ti nga unë, more bir, përsë ke ardhur gjer këtu?

— Unë kam ardhur që vendi ynë të ketë një armik më pak e një shqiptar më shumë.

Dhe për herë të parë, o bir, mësova se Bardhyli ka rënë dëshmor, nga ai mësova se nëna jote dhe im vëlla, kanë vdekur, nga ai mësova se ti je gjallë e shëndoshë e je bërë agronom i fshatit. Pastaj djaloshi asaj dite nxori një reviste e çfletoi e më tha: Pa lexo këtu. Vura syzet, po ç'te shoh! Gjallë fytyra ime kur isha i ri. Edhe pa e lexuar më poshtë unë të njoha, o biri im.

«Skënder Brana duke marrë diplomën e agronomit».

E ruaj edhe sot këtë revistë, e kam larë me lot atje në Libi.

Që të nesërmen u nisa me djaloshin për në Itali. Ai punonte në legatën tonë në Romë. E pyeta për emerin e tij, e më tha: Quamë me emrin e djalit tënd. Dhe sot e kësaj dite unë e njoh për Skënder atë djalë sqimatar që erdhi gjery thellë në rërën e Libisë për të më hasur mua. Dhe tashti kur rrri e mejtoj këto fjalë, ky djalosh shqiptar është mbërthyer në zënkë me një bez ballist këtu në portin e Barit...»

Hasanit iu duk se bash këtu po i fliste të birit.

Por ngadalë mjekra iu mbështet mbi gjoks dhe nga gryka i doli një rënkim i ngjirur. Mendimet e tij iu ndalën në plagën e shpirtit të vet. «Ah Syrja, Syrja, ç'të bëra unë Syrja. Por a do t'i pajtoj dot gazet që më presin me vrasjen që kam bërë?»

Dhe deti shushurin, e korbat krakarijnë mbi direkë anijesh, e Hasanit zë e i dridhet cipa e lukthit.

Tashti, dy shqipot që ziheshin i janë qasur Hasanit. Të dy nuk e vështrojnë njëri-tjetrin e sytë i kanë gjak të kuqe. Plakoshi e ngriti zérin:

— Ej Hasan Brana, eja në vete, ne do të kthehem i me ndër në atdhe, ti...

Po Hasan nuk i përgjigjet. Ai sjell ndër duar kapellen e tij të bardhë. Pastaj dalengadalë nxjerr nga valixha një gëershërë të vogël, pret me të strehët e kapellës e i hedh në det, dhe ja, Hasan Brana, me takije të bardhë shqiptarë në kokë, është gati.

* * *

Mbrëmje plot zhurmë në portin e Barit. Tej nga mëlat skuqin retë, Hasan Brana pret të niset. Me sy të njomur ai sheh detin që e ndan nga atdheu.

— Ja, tashti po perëndon dielli mbi Moravë, është pranverë, mbi tërfili po hidhen qingjat e njomë, ajri është i vakur dhe qiellidi larë. Qielli i mëmëdheut tim! Ja tek është! Jacku e shoh që këtej, ja si po hiroset!

Përkrah, djaloshi shqiptar i rreh supin dhe i nënë-qesh. Plakoshi po kollitet aty pranë:

— Të futën në thes kuqalashët, Hasan, kaq e pate, nuk durove dot, unë i lava duart, unë...

Por Hasani nuk dëgjon më. Ai ka rënë në krahët e Skënderit, përqafohen sa u kërcasin kockat.

— Po ti, o bir, nuk do të vish në atdhe?

— Ah, jo, unë do të qëndroj edhe më, ma merr mendja se ka edhe Hasan të tjerë nëpër shkretëtirë. Hajt të goftë rruga e mbarë!

Motobarka çan detin drejt lindjes. Për herë të parë pas shumë vjetësh Hasan Brana dëgjon shumë zëra që flasin gjuhën e tij. Po kthehet pas shtatëmbëdhjetë vjetësh por të papriturat që e prisnin në shtëpi, ai nuk i shkonte nér mend kurë.

Dalngadalë, në agim, u duk bregdeti jugor i Shqipërisë. Deti mavi në të gjelbër, shkëmbenjtë e kuq që lëshojnë një dritë të trandafiltë mbi ujrat e kulluara, leshterikët jeshilë i shplan vala e shkumbëzuar në kum, bo-kërimat xixellojnë nëpër valët. Gjelbërojnë ullishtat e Vlorës, qesh Tomori festebardhë.

«Ah, ku je o atdheu im, atdhe i bukur, atdhe i gjelbër, me kurora shkëmbënsh të rreptë, me kreshta pyjesh, i mbetur në dritë!».

Hasan Brana ndjeu t'i mbahet fryma, gjunjët iu prez në, u vais mbi një tufë litarësh dhe ja krisi të qarit.

Se mund të kesh parë botën e tërë, mund të kesh njohur pallate e qytete të ndritur, sot t'i kesh parë dhe nesër t'i kesh harruar; mund të kesh rrojtur shumë mirë a shumë keq në mërgim, gjithçka mund të kesh bërë në dhe të huaj, e prapseprapë të gjitha mund të të shlyhen nga kujtesa. Mundet.

Por... kur të del para syve Shqipëria, mbush gjoksin me ajrin e qiellit tënd, sodit malet e ashpra të shqiponjave, sheh lumenjtë e tu të shkumbëzuar, ndjen erën e tokës ku linde, sheh baltën e hidhur ku njohe jetën dhe urinë!

A e dë si do të të gufojë zemra?

E a do mbahesh dot pa qarë?

Jo! Kurrë! Kurrë në ke lindur shqipëtar!

* * *

Shpinë kërrusur e mendjemarrë, Hasani po i afrohet fshatit të vet që nga ana e korijeve.

«Ja Rëzët e Moravës, ja Rahu, ja Izvori».

Atij iu drodhën gjymtyrët dhe një gulsh avulli i nxeh të sikur ja mbylli grykën. Psherëtiu e bëri përpjetë. Edhe pak rrugë, ndonjë bulë djerse në ballë, një dhëmbje e vogël në këmbë dhe ja, arrijti.

«Minjollat e Rahut qënkan rritur, ja edhe «varri» i Syrjait, trualli është bërë lëndinë, një baloshe qënka rritur mbi të, nuk njihet asnje gjurmë».

Para syve të Hasanit ndehet një si re, pastaj reja zë e lëkundet, zë e dridhet si zheg, pastaj sqarohet fare e Hasani kujton, dhe sikur e sheh ngjarjen ndënë një qiell sapo të larë nga shiu. Por ai nuk do që ta kujtojë «atë», kafshon buzët e përpjek këmbët e kur ndodhia i ngulmon gjithnjë para syve, ai rreh kryet me grushta, gjerr gjoksin e rreh fytyrën, rënkon si një derr i goditur e i duket sikur e kanë shkuar në hell dhe e sjellin përmbi prush.

* * *

Po priste djalin Hasan Brana në oborr të shtëpisë së vet: kurrizin e mbante gërmuq, i dridheshin gjunjët dhe i bëhej se po e shanin gurët e njohur të oborrit, dërrasat e portës, pragu i gurtë. Veç një plep i ri kundrejt hyrjes dukej sikur e shikte ma habi këtë njeri të porsaardhur.

Ish sulur tashti fshati i tërë dhe i uronin ardhjen. Pleq e moshatarë me «qoft e shkuar», të rinj të panjohur pak të shkujdesur, çupa e nuse të reja me «miseardhje», si nuk kish qënë zakon asaj kohe. Shumë vështrime erdhën t'i rëmojnë sytë Hasanit.

Djali i tij, agronomi i fshatit, ndodhej larg në fu-

shë. Me të dëgjuar lajmin, ai shtangu në vend, kafshoi buzën e poshtëme dhe filloi të kutullojë sytë sikur maste diçka në hapësirë. Me këmbët e ngulura në tokën e butë, ai vështroi sy më sy të gjithë bujqërit anë e mb' anë. Trëndafili i kuq që mbante në dorë iu drodh gati t'i rrëzohej. Era e stinës fryu me vrull, hodhi përtokë lule kumbullash, flakëroi tutje driza e gjëmba; përsëri shkundi lule e sërish përshkënditi ferra e driza. E hijet e reve të vogla rendnin mbi ugare e dielli mbulohej e delte prapë, pa fshihej e sërish nxirrte krye.

— Babai! Babai im, qënka gjallë?

Faqet e djalit qenë zverdhur. Atij s'i mbeti pikë gjaku në fytyrë. Një trazi e pështjelloi e iu bë sikur gjaku i mbledhur në gjoks e furia që i lëvrinte në kokë, po mbanin këshillë.

— Qënka gjallë!?

Dhe fytyra e Bardhylit, të nënës, të xhajës, sikur jepnin e merrnin midis tyre dhe vetë atij iu prenë gjunjët dhe iu zu fryma.

Si erë e marrë, agronomi i ri kaloi nëpër fshat, uturr nëpër shkallët e shtëpisë dhe ja, në mes të miqve, i ati.

«Medet si qënka katandisur! Si një div të shëndoshë e shpatullgjerë e mbaj mend unë; dhe nga kjo fytyrë e dashur paskan mbetur veç sytë».

Dhe koka e djaloshit u pështet në parzmin e Hasanit.

— O atë, o atë, të dija të vdekur!

Gjindja heshtën, por mendja e Hasanit punonte si n'ethe:

— «O zot, të qofsha falë, për fajet e mia më dhe arratinë, por djali më qënka bërë burrë, fytyra i ndrit nga shëndeti, me shkollë të madhe djali im, i veshur bukur djali im, burra e pleq ma nderojnë».

Vonë natën, kur miqtë u larguan, mbeti aty vetëm një i huaj. Nga fjalët, Hasan i kuptoi se ai ishte njeri i qeverisë.

— Kabull mikun, shoku Hasan, por këtë shtëpi unë

ë kam pasur si timen. Me Skënderin kemi shkuar si vëllezër. Unë ju përgëzoj për rrugën e re që zgjodhët dhe u ngjatjetoj si një burrë të nderuar. Kohë të turbullta ato të luftës e, si thotë fjala, nëpër mjergull zor se e gjen njeriu rrugën e drejtë. Por ajo kaloi. Ato kohë e faje janë shlyer; bile bile edhe ndonjë që ka kryer vrasje asaj kohe, tashti është falur dhe ligji nuk e ndjek më. Hajde bromp, xha Hasan, të paçim sa malet, të kristë shtëpia në dasmën e djalit!

* * *

Pas kaq vjetësh Hasan Brana ra të flejë nënë strehën e tij. Por gjumi nuk e merrte. E sa mbyllte sytë i bëhej sikur nga skutat, nga dritaret, nga kllaniku, ndihej zëri i Sanijes, hieja e Bardhylit. Pastaj brofte e çelte qerpikët: errësirë, në shtëpi heshtje. Jashtë ndiheshin ujrat e penguara të mullirit përtej, ndihej era që frynte, drurët që tundëshin. Po i dukej nata e gjatë si prej dimri e shtrati i bëhej si të qe lesa me purteka ku rrahin misër.

Në mëngjes u çua herët e doli në dritaren e çardhakut.

«Sa shumë qënka rritur molla e bredhi që mbolla vëtë atij moti! Shtëpisë i qënkan vjetëruar strehët, djali i ka ndrequr bûkur dy odat lart, edhe ndonjë tra do t'i ketë shkuar pullazit. Po, pa dale, kush troket në portë? Ja Skënderi, dolli, po heq llozin, ja, e çeli kanatën. Oj! Ç'është kjo?»

Një vajzë e re, veshur bukur; flasin ngadalë e sikur ajo më shumë rrëmben mendimet e tij. Në llërën e saj të bardhë një orë e vogël ari. Ata hynë ndënë pjergullën, djaloshi ngriti dorën e bëri që Hasani të kafshojë buzën e poshtëme. Ai u spraps, por si duket Skënderi vuri re tymin e cigares që delte nga dritarja dhe i foli:

— U, ngrite, baba?

Tashti të tre janë ulur në stolin e gjatë në kopsht dhe zemra e Hasanit rreh nxituar. Ai më shumë i mori me mend ato që i tregoi i biri. Pas shumë e shumë vje-

tësh, Hasanit ze e i çalet zemra e fytyra, e ndjeu të afërt atë vajzë, iu duk e dhëmbshur, sepse e mallëshme e ëmbël dhe e dashur është ajo ndjenja atërore që gjëzon prindi për nusen e djalit.

— Tashti, baba, jemi të fejuar, por nusja vjen dëndur në shtëpi e më ndihmon; nusen mund ta quash Fatime, por ne e thërresim Fati, kështu e quan edhe mëmë Selvia; Fati ka mbaruar shkollën në qytet, është mësonjëse këtu...

— Mëmë Selvia?

— Pse çuditesh, baba, Fati është vajza e Selvisë, e të ndjerit Syrja.

Tashti Hasani është përmbyssur në fron dhe e ka humbur mëndjen fare.

— Babaj nuk të njohu, Fati, është bërë shumë i ndjeshtëm.

Por fatziut i ushton shtërngata në shpirt, atij i ofshan gjoksi, i duket se një plagë e rë iu hap përbrënda: Ngadalë, ngre kryet, por vajzën nuk e sheh dot në sy.

«Ah ata sy, ata sy janë lutës, ata kërkojnë mëshirë, ata janë vetëm sytë e Syrjait. Ajo mbapse e ka harruar të jatin, në mos fare po këtë çast ajo nuk e mendon, në ballin e saj të bukur nuk duket asnjë hie, në faqet e saj të bardha s'ka asnjë vijë të rreptë. Po unë? Si ta harroj unë? Ah, Syrja, ç'të bëra Syrja; si qënka bërë kjo punë këshfu?»

— Mblidh vehten baba, baba...

Po e thërriste «atë» çupa e të vrarit.

«Po përsë sikur vajza u zbeh në fytyrë? Pa shiko, po i vjen trazi».

Hasani u gjelltit. «Nusja do të jetë e rëndë, medomos kështu do të jetë. Ja, pra, qënka përzjerë gjaku im me atë gjak që e bëra të derdhet».

— U trashëgofshi biro, zoti ju gjësoftë...

Dy të rinjtë vështruan njëri-tjetrin. Ajo kafshoi bëzen dhe u çua.

— Sërisht të ardhi fytyra e parë baba, mua të mëndjesh, më vajti ora e shkollës.

Kalojnë ditë. Hasan Branën po e mposht brengë e zemrës. I duket jeta e hidhur, e pashijë, si uj' i zier. Sëmundja e mbërthen gjith e më dëndur, mbetet i hutuar e i përhumbur. Herë herë mendja i kthjellohet, pa zë e lexon dhe vështron botën përreth. Truri i tij rrëmbe është bën përshest ngjarjet e kohës.

«Vërtet paskan ndruar shumë gjëra, fshati eshtë bashkuar njësh me toka e bagëti, punë të mëdha qënkan kryer, eshtë mbushur vendi plot makina, kanë ardhur zakone të reja, rinia paska ndruar fort. S'ka më mehmurë zyrate, ua kanë zënë vendin djem të hedhur. Por brana e kohës paska shkuan ashpër. Bashkë me diersë aty këtu qënkan derdhur edhe lot. Po mos vallë gjithë këto fabrika janë ngritur si piramidet e Misirit? Disa njerëz rrojnë keq; ndonjëherë u mungon buka. Po ku i gjejnë forcat e vrullit këta njerëz? Që punojnë mbrodh kjo duket sheshit, ka gjëra që më vrasin synë, po ku ta dish! Po pa da le, cili jam unë që bëhem gjykatës. A ka të drejtë vrasësi të gjykojë? Djali im ka mbaruar shkollë të madhe. Qënka mbushur shtëpia ime plot me libra e gazeta. Djali ka blerë radio, gazanikët qënkan zhdukur. Skënderi lot kitarëni, vjen nusja dhe këndojnë të dy. Ata këndojnë për heronj. Flasin me mënyrën e atyre shkollarëve italianë aty në Libi. Edhe mua më pëlqen ajo botë librash, më kënaq të dëgjoj; edhe unë, sado gdhë, por u gdhënda nga shkolla ejeta andej «matanë». Po për ndryshimet në shtëpinë time u desh që djali i im i madh të vritej partizan në mal, që i vëllaj të mos mbetej lopar. Po përse nuk renda unë t'u shtroja sofrën fëmijve të mi? Përse zgjodha një rrugë të pafryt? Përse çalltisa unë? Për kë luftova? Unë renda për bejlerët, për Zogun, renda që këtyre mos u merrnin komunistët ato ç'ka kishin të tepërtë. Si nuk e ndava dot shapin nga sheqeri? Ata që më yshtën mua, bënin orgjira Evropës kur unë dridhesha nga ethet e verdhëa në Libi. Askush nuk pyeti për fatin tim. Vec

-një komunist erdhi në rërën e Libisë të më gjejë ku isha fishehur në strofkën time. E mirë se ato kohëra kaluan, po tashti, po paskëtaj, a mund të rroj i qetë unë? Po vrasja që kam bërë! Gjaku që derdha atëhere nuk m'u zu, po tash-ti ai po më mbyt e nuk më le të qetë as ditë as natë. Ni-për e mbesa do të vijnë pas meje, unë atyre u kam vra-rë gjyshin nga eëma. A mund të tretë gjer në fund ndërgjegja ime atë vrasje që kreva? Është aqik që unë atëherë mora një rrugë të gabuar, por jo se e dija këtë. Po, a vlejnë këto fjalë tashti? Si mundet vallë të lehtësoj fajet e mia? Të vete në gjyq e të thérres: kapmëni, gjykomëni, unë jam vrasës! Por ata nuk do të më kapin. U paskan hedhur gunën punëve të tillë, koha kalon e guri do të rëndonte të tjerët. Djali im do të ishte i pari që do të vuante nga ninosja ime. Nusja kurrë s'do të më shihte në sy. Gabimet janë bërë me kohë, tashti s'mund të ndrezen. Mirë thotë populli: për të prerë njëherë duhet menduar shtatë herë. Unë atëherë u bëra shok me pasanikët dhe, dashur pa dashur, u bëra edhe vrasës. E për t'i ndrejtur fajet sot, nuk është mjaft të pendohem. Unë e dij, e ndjej se jeta s'ka për të më ngushëlluar kurrë. I rraha rrugët e jetës, por nuk dita të jetoj. Po mos vallë rrëfimi im do t'i viente djalit për të ardhmen e tij? Nuk besoj. Nga sa shoh unë ai një rrugë e ka, e shoh të lumtur, të gézuar. Të gjitha sa kam menduar të them do t'ja tregoj një përnjë, por vrasjen jo. Ajo duhet mbajtur si një thëngjill në zemër gjersa të më përvëlojë fare».

Dhe ndërsa Hasani symbyllur mendohet, i bëhet sikur një zë i afrohet te veshi e i flet ngadalë:
— Mos Hasan, mos folë, veri zemrës gur dhe hesht.
Ai çel sytë por askush s'është pranë tij. Pa bie më gjunjë e falet:

«Zot, o zot, kush i dha shkas vrasjes që kreva? Ligësia ime apo koha me zjarre që ti i fale botës ato vjete? O zot, a je ti që mundon zemrën time të cfilitur apo ndërgjegja ime s'i duron dot këto duar të gjakosur!»

I mbushur me mendime të turbullta ai bie në shtrat.

Skënderi vjen vonë, por nusja i ka shtruar rrobet me kohë. Sonte mendon të flerë i qetë poshtë në sobën 1) e vjetër, ku flinte dikur i gjyshi. Mbrëmë i qe ankuar nuses:

— Më pllakosë ija në gjumë e fjeta rëndë.

Por nata që erdhi ishte më e rëndë. Shpirti i fatziut nuk gjen dot qetësi.

Nëpër dritare hëna lëshon një gulsh drite që thyhet pas thekëve të plafit. Sytë e Hasanit mbyllen ngadalë, por thekët zënë e rriten, zënë e zgjaten, ndehen, lëvizin.

I bëhet ndër këmbë Syrjai dhe i kërkon mëshirë:

— Hasan, vëllá, mos më vra! Hasan, kam fëmijë!

Dhe Syrjai nuk flet me gojë, ai flet nga plaga e pasveshit dhe atë «gojë». Hasani kërkon ta mbyllë, i ve dorën, e mbështjell me krahun, i hedh sipër pambuk, e lidh me pëlhirë, por varra flet e vjell gjak gjithnjë. Pastaj ndihet një gjëmim, një potere, dikush qesh si kukudh më një zë tallës, të çjerrë, t'egër. Nëpër fashot e gjakosura plaga e Syrjait flet papushim, lutet,ënjet, kërkon ndihmë; Hasani mundohet, djersin, do që ta zërë atë plagë medoemos, do që ta pushojë atë zë, kur nga reja përtetë këputet një formë njeriu me një shpejtësi të frikëshme. Hieja është veshur më të bardha, me sarëk të gjelbër, në ballë ka një top fildishi. Zëri i saj, si i dalë prej reve, ushton grykave, maledive, sikur e vjell era.

— «O Hasaan! Këtu mundohesh ta fshehësh plagën e Syrjait, por kur të vish para zotit a do ta fshehësh dot?»

Hasani unj kryet, por Syrjai nuk është më në këmbë. Në vend të tij shtrihet në lëndinë një hu i gjakosur prej thane.

Dhe jehona e zërit nga retë këlthet pllajave, majë më majë, breg më breg, me furi t'egër.

— O Hasan, Hasanoo!

I mbytur në djersë, me parzëm të rënduar, i sëmuri zgjohet nga gjumi. Në sobë, pranë stufës, janë dy hie. Është djali me nusen. Dritën nuk e kanë çelur nga frika mos e zgjojnë. Flasin ngadalë, plaku ngulçoi.

— Ndofta tē zgjuam baba.

Përjashta era përplaset pas mureve. Hasani i trembur çohet përgjysëm, sytë i kanë kërcyer dhe gusha i dridhet.

— Era, baba, éshtë era, fryn veriu.

Era éshtë vërtet, por ajo fryn përjashta. Veçse një erë tjetër fshikullon në shpirtin e Hasanit. Një tufan tjetër i pështjellon zemrën e vojtur. Atë e di vetëm ai.

«O zot, ti i shënove nusen Skënderit për tē mbyllur gjakun apo për tē më munduar mua? Si tē mendoj unë? Mos vallë ti, o zot, a je vërtet si thonë, apo unë lojta nga mentë?»

Përjashta shiu bie me stominë, curilat rrabin xhamet si me purtekë. Zë e gjëmon, goreni tund pullazet. Vetëtimat ndjekin njëra-tjetrën, drita e tyre rreh nxituar fajet e kthisave. Jasht, pas gjerdheve, gurgullojnë viret me ujra tē turbullta. Hasanin e ka mbërthyer ankthi nëpër gjumë dhe nuk i ndahet.

I bëhet sikur ngjitet lart me duart e me këmbë kapur pas një konopi me nyje. Lart, shumë lart, na qënka lapidari i Syrjait, gur i bardhë e i gdhëndur. Ngadalë guari ndron formë, bëhet si bust me fytyrën e tē vrarit, me plagën pas veshit.

«Ah, s'më ndahet hieja e tē vrarit. Pra, duhet ikur, duhet zbritur. Po litari ku éshtë? Kush ma hoqi? Duhet hedhur me parashutë, sa mirë që e paskam në shpinë!»

Ai hidhet në humnerë, tërheq gjalmin, parashuta çel, valavitet dhe nga reja përtej, zëri i njohur bërtet duke u tallur:

«Ha, ha po ikën Hasani! Ooo Hasaaan!»

Dhe atë e rreh një erë e marrë, e rrëmbej një veri i tërbuar dhe e sjell vërdallë nëpër një qiell me tym pishe me një furi t'ëthëshme.

Pastaj hap sytë. Djali çel driten dhe ai vështron sobjen përreth, makthi sikur e mban për gryke, pastaj ngul vështrimin në tavan; trarët e vjetër janë tē shtrëmbër, janë tē gërshetuar me hunj.

«Po përsë hunjtë janë tē shkallmuar?»

Ai çakarit sytë dhe sheh i trëmbur përreth:

— Një hu i përgjakur sillet si me magji nëpër dhomë. Pö përse gjithë hunjtë e tavanit janë të gjakosur?»

— Ah po hiqini këta hunj, hiqini!

Po ata sillen nëpër dhomë gjithnjë, sillen si lambadhe të ndezura në një valle të shthurur, kërcejnë, vërtiten, ndizën edhe më, bëhen si pishtarë.

— Bo bo, do të më djegin, ah të shpëtoj, të shpëtoj, Syrja vëlla, Syrja... .

Djali me nusen janë ngritur në këmbë, i qëndrojnë pranë, dëgjojnë përcartin e tij, ngrenë supet, mundohen ta qetësojnë.

Sërisht era fryn me të fortë, në qìell gjëmon rrufeja, në kopsht thyhen degë të thata, bën ftohtë, se veriu vjen nga larg me cikërima dëbore.

Hasani i pikelluar vështron nga dritarja, djali vete e cel. Drita, me një gulsh të bardhë, lan degët e gjelberëra të bredhit. Zjarri bubullon në kllanik.

— Ç'bën kështu?

Era baba, era, është kohë e keqe, fryn veriu.

— Sikur bërtet dikush!

— Jo, baba, mos ki frikë, era utullon nëpër atullat.

Hasani vjen në vete. Ve grushtin e tij mbi ballë dhe mendon:

Duhet marrë kartë e lapës dhe duhet shkruar:

«Unë rrojta, po nuk dita të jetoj, pas fajeve nuk qënka mjaft të pendohesh. E ndjej se fundi po më vjen, nga zoti a nga dora ime, nuk e di, por që po vjen, këtë e shoh mirë. Njérën këmbë sikur e kam në varr».

Jashtë qìelli nxin e gjëmimet tundin botën, te fqinjë përtej një sopatë rreh nxituar, kurse veriu, fryn e fryn e s'ka të pushuar.

TRYEZA E LËNDËS

Faqe

Zëri i mëmëdheut	3
Portokallet	12
Dasmë e çuditëshme	22
Kokëkrisuri	33
Këngë e rinisë së parë	45
Ballë për ballë me errësirën	59
Vani kapedani	110
Ne jemi shokë lufte	116
Frym veriu	126

Lëndët e këngave
Këngat e lëndëve
Një këngë pothuajse
Një këngë që nuk i është e njohur

Përdorimi i këngave
Këngat e lëndëve
Një këngë pothuajse
Një këngë që nuk i është e njohur

JANË NË QARKULLIM
LETËRSI ARTISTIKE SHQIPTARE

	Lekë
G. DARA (I riu)	<i>— Kënga e sprasme e Balës</i> 20
MIGJENI	<i>— Veprat</i> 40
Z. SEREMBE	<i>— Vjersha</i> 30
Q. STAFA	<i>— Qortimet e vjeshtës</i> 15
DH. S. SHUTERIQI	<i>— Këngë</i> 60
LL. SILIQI	<i>— Këngë entuziaste</i> 15
Q. BUXHELI	<i>— Një ndodhi në plazh</i> 40
R. BRAHIMI	<i>— Katër vajza</i> 35
A. ASLLANI	<i>— Shqipëria kryezonjë</i> 20
H. PETRELA	<i>— Të munduarit</i> 50
Autorë të ndryshëm	<i>— Këngë për dritën leniniste</i> 45
XH. BILBILI	<i>— Skena dhe prapaskena</i> 20
Autorë të ndryshëm	<i>— Këngët e rinisë</i> 40
R. NEPRAVISHTA	<i>— Pelikanët ndrojnë folë</i> 40
K. LUSHI	<i>— Kronikë e vëndit tim</i> 30
N. PRIFTI	<i>— Tregime</i> 20
GJ. ZHEJI	<i>— Ngjarje në Çajup</i> 25
A. CERGA	<i>— Njeri i zakonshëm</i> 30